DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 425 • PRILL 2026



NGA RAMAZANI TE NJË SHOQËRI ME VLERA

GRUAJA – SHTYLLË E FAMILJES

ETIKA E KOMUNIKIMIT NË RRJETET SOCIALE NË DRITËN E MËSIMEVE ISLAME

AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË MUAJIT SHEVAL

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e festës së Fitër Bajramit

Fitër Bajrami si mesazh paqeje, uniteti dhe përgjegjësie shoqërore

Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Pas një udhëtimi të gjatë shpirtëror, të mbushur me përkushtim, sakrificë dhe devocion gjatë muajit të bekuar Ramazan, nesër po e presim me gëzim të madh festën e Fitër Bajramit.

Ky muaj i begatë ishte një shkollë e lartë e edukimit shpirtëror dhe moral, ku besimtari u përpoq ta pastrojë zemrën, ta disiplinojë shpirtin dhe të afrohet më shumë me Zotin e Madhërishëm. Në përjetimin e agjërimit, lutjes dhe solidaritetit, ne rikthyem ekuilibrin e brendshëm dhe forcuam lidhjen tonë me Krijuesin dhe me njëri-tjetrin.

Ramazani na mësoi se besimi nuk është vetëm fjalë, por përkushtim i gjallë. Ai na edukoi në durim, në sinqeritet dhe në përgjegjësi, duke na kujtuar se njeriu e arrin madhështinë e tij përmes përulësisë dhe devotshmërisë.

Ky muaj na bëri më të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë ndaj Zotit, ndaj vetvetes dhe ndaj shoqërisë, duke e forcuar ndjenjën e solidaritetit dhe të dhembshurisë për ata që janë në nevojë.

Në përvojën e përbashkët të sofrës së iftarit, ky muaj i bekuar kultivoi ndjenjën e barazisë, forcoi unitetin, thelloi solidaritetin dhe ringjalli shpresën, duke na rikujtuar se dera e mëshirës së Zotit të Madhërishëm mbetet përherë e hapur për zemrat e pastra dhe të sinqerta.

Të dashur besimtarë,

Fitër Bajrami është kurora e këtij rrugëtimi shpirtëror. Ai nuk është vetëm një festë gëzimi, por një manifestim i vlerave më të larta njerëzore dhe hyjnore.

Në këtë ditë, zemrat mbushen me paqe, falje dhe dashuri, ndërsa besimtari e ndien më fuqishëm përgjegjësinë e tij si mëkëmbës i Zotit në tokë, për të përhapur të mirën dhe për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të moralshme.

Në traditën tonë, Fitër Bajrami është festë e bashkimit, e pajtimit dhe e humanizmit. Është dita kur hapen zemrat, kur shtrihen duart e pajtimit dhe kur forcohen lidhjet familjare dhe shoqërore. Sofrat tona mbushen me begati, por mbi të gjitha me dashuri, respekt dhe mirënjohje. Kjo festë na kujton se gëzimi i vërtetë është ai që ndahet me të tjerët.

Kjo është dita kur duhet të jemi më pranë njëri-tjetrit, më të kujdesshëm ndaj të varfërve, jetimëve, të moshuarve dhe të sëmurëve.

Bajrami na mëson se humanizmi nuk është vetëm një ndjenjë, por një detyrim moral dhe shpirtëror, që duhet ta shoqërojë jetën tonë të përditshme.

Mesazhi i Fitër Bajramit është paqja, solidariteti dhe dinjiteti njerëzor. Në një kohë kur bota po përballet me konflikte dhe luftëra që po marrin jetë të pafajshme, kjo festë na fton të lutemi për paqe dhe të angazhohemi për ndërtimin e një bote më të drejtë.

Lutemi që Zoti i Madhërishëm ta udhëzojë njerëzimin, t'u japë fund luftërave, t'i ndalë vuajtjet dhe të sjellë paqe e mirëkuptim në botë.

Fitër Bajrami na rikujton edhe fisnikërinë e njeriut dhe misionin e tij në tokë. Njeriu është i nderuar dhe i ngarkuar me përgjegjësi për të ndërtuar, për t'i ruajtur dhe për t'i përhapur vlerat e mirësisë dhe drejtësisë.

Prandaj, kjo festë është një thirrje që të vazhdojmë rrugën e mirësisë, të drejtësisë dhe të përgjegjësisë edhe pas përfundimit të Ramazanit.

Të nderuar qytetarë,

Në këtë ditë të bekuar, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, t'ju shpreh urimet më të përzemërta për festën e Fitër Bajramit. Le të jetë kjo festë një burim gëzimi, paqeje dhe shprese për të gjithë ju dhe familjet tuaja.

Një urim i veçantë shkon për bashkatdhetarët tanë në mërgatë, të cilët, edhe pse larg atdheut, mbeten të lidhur fort me fenë, traditën dhe identitetin e tyre. Le të jetë kjo festë një urë që i afron zemrat dhe i forcon lidhjet tona shpirtërore.

Gëzuar Fitër Bajramin!

Zoti e pranoftë agjërimin, lutjet dhe sakrificat tona!

Zoti ju dhëntë paqe, begati dhe mirësi në familjet tuaja!

Myftiu Naim ef. Tërnava

Prishtinë, më 19.03.2026

EDITORIAL

4 Arroganca si antivirtyt i fetarisë së vërtetë

FETARE

5 Hytbeja e Myftiut Naim ef. Tërnava për Fitër Bajram:
Nga Ramazani te një shoqëri me vlera

7 Kumtesa e Myftiut Naim ef. Tërnava në Samitin e 10-të të Kryetarëve të Bashkësive Fetare Islame të Shteteve të Ballkanit

11 Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval
Dr. Bali M. Sadiku

13 Efektet e agjërimit në jetën e besimtarit
Mr. Artan Musliu

16 Teshehudi në namaz
Dr. Ejup Haziri

FAMILJE & EDUKIM

20 Gruaja – shtyllë e familjes
Dr. Violetë Smajlaj

22 Etika e komunikimit në rrjetet sociale në dritën e mësimeve islame
Aid Nasufaj

KULTURË

25 Krijimtaria letrare e bejtexhinjve
Arbin Ahmeti

28 Ibën Arabiu ndërmjet admirimit dhe kritikës së ashpër
Mimoza Sinani

32 Ezani – thirje universale në poezitë e Mehmet Akif Ersojit – Pejanit
Dr. Selim Selimi

35 Personalitete të njohura të kohës moderne, të cilët përqafuan Islamin
Jasir Memaj

38 Ndërlidhja ndërmjet hapësirës gjeografike dhe përhapjes së fesë islame – analizë shkencore
Faik Krasniqi

HISTORI DHE CIVILIZIM

42 Adem Jashari në tekstet shkollore të historisë në Kosovë
Dr. Nuridin Ahmeti

45 Çfarë ka ndodhur kur është botuar përkthimi i parë i Kuranit në Evropë?

48 Lufta civile amerikane (1861-1865)
Msc. Drin Aliu

51 Udhëpërshkrimi i Evlija Çelebiut në Kosovë - 1660
Ma. Fatlum Nika

55 “Xhamia në Gjermon të Zgatarit – një gur i ri në mozaikun fetar të Opojës”
Ramadan Shkodra

REPORTAZH

57 Kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus qëndroi për vizitë në Kosovë

AKTIVITETE

68 Në Kosovë u prit dhe u festua festa e Fitër Bajramit



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore

Nr. 425 • viti 39 • Prill 2026
• Shevval 1447
• Çmimi 2 €

Boton
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnava,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
“Printing Press”, Prishtinë.

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë." (Hud, 118)

Arroganca si antivirtyt i fetarisë së vërtetë

Thellë në brendësinë e vet, feja e vërtetë e synon dëlirjen e shpirtit të njeriut dhe përulësinë e tij, apriori para Krijuesit Fuqiplotë, e pastaj në përmasën racionale edhe para njerëzve të tjerë. E, kur njeriu, për cilëndo arsye, braktisë përulësinë dhe krekoset me arrogancë përballë të tjerëve, ai veç ka braktisur një virtyt të pazëvendësueshëm që Islami e ka synuar ta çelikosë në karakterin e secilit njeri. Në konceptin bazik islam, besimtari nuk mund të jetë i përulur në xhami, i devotshëm dhe i përmbajtur në Ramazan, ndërkaq i krekosur e mburravec në jetën e tij civile të rëndomtë. Këtë çarje personaliteti Islami nuk e njeh si të mirëqenë.

Personalitetet më të spikatura të brezave të mëhershëm, me gjithë devocionin e dëshmuar çdoherë, ruanin një modesti të çuditshme dhe vetëpërmbajtje në lavdërim të vetvetes. Njëri prej tyre ishte edhe Ebu Bekri r.a., i cili jepte leksione me peshë lidhur me këtë çështje, kur thoshte: "Të mos e nënçmojë askush askënd prej myslimanëve, sepse ai që shihet te myslimanët si i vogël, tek Allahu mund të jetë njeri i madh." (It'haf es Sade el Muttakiin bi Sherh Ihja Ulum ed Di, Ez Zubejdij, 343). Nëse këtë përshtypje vlerësuese për të tjerët kishte ai që ne s'patëm njeri më të përmbushur e më të sinqertë, pas Pejgamberit tonë, në tërë historinë e lavdishme të Islamit, atëherë çfarë mund të thuhet për të tjerët?!

Po aq interesante është edhe rasti kur Hudhejfetu ibën el Jemani r.a., ishte bashkë me Umerin r.a. në përcjellje të një xhenazeje, dhe Umeri iu kthye Hudhejfes r.a., duke e pyetur nëse emri i tij ishte në listën e hipokritëve, të cilën listë i Dërguari i Allahut ia kishte lënë në besë Hudhejfes. Ai (Umeri) tha: "Të lutem për Allahun, a jam unë prej tyre?" I tha: "Jo (nuk je në listën e hipokritëve), por nuk do të rrëfejë për askënd tjetër pas teje." (Mexhmea' ez Zevaid, El Hejthemi, me citat autentik). Llogarite një gjë, Umeri r.a., si njeri i përgëzuar me Xhenet nga vetë Muhamedi a.s., edhe pyeste nëse ai vetë gjendej i listuar në 'listën e hipokritëve'! Pra, ai nuk pyeste se kush nga të tjerët ishte aty, por e kishte hallin e vetes së tij nëse ishte apo jo në një listë të tillë. Ky devocion i përmbushur me modesti e virtytshmëri, shpërfaq më së miri modelin e besimtarit të vërtetë se si ai duhet t'i shoh të tjerët, e si ta shoh veten e tij në peshojën e fetarisë së vërtetë.

Devocioni i sforcuar e i veshur me petkun e konsekuencës fetare, shpesh bëhet arsye për të shmangur përballjen me dobësitë e brendshme te vetë personi që e pretendon një shkallë të lartë të fetarisë së tillë. Ai i sheh të tjerët më syrin nënvlerësues dhe i mendon ata se janë më pak meritorë për mëshirën dhe ndihmën e Zotit. Të tillët ndiejnë nevojë për t'u dukur të përkushtuar, thjesht sa për ta përmbushur një vetëkënaqësi të stisur e për afirmim personal. Shumë psikologë do ta konsideronin këtë një iluzion të virtytit, dhe alibi për të përçmuar të tjerët, por asnjëherë rrugë për vetëkontroll e përulshmëri fisnike. Është thjesht një lakmi e shthurur për të fituar admirim publik, komente pozitive dhe pëlqime, qoftë edhe spontane, apo eventualisht edhe ndonjë pozitë në një shoqëri, e cila e ka humbur taktin e vlerësimit të vërtetë të njerëzve të vet.

Vetëkrekosja dhe vetëpëlqimi, qoftë edhe në emër të fetarisë, apo si mënyrë e të menduarit, ka babanë e vet ideologjik, Iblisin, i cili që në origjinë refuzoi urdhrin e Zotit për t'i rënë në sexhde Ademit a.s., me alibi vetëvlerësuese. Ai tha: *"(Allahu) tha: "Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?"* Ai (Iblisi) tha: *"Unë jam më i vlershëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!"* (El Araf, 12). Pra, edhe Iblisi mori mundin që t'i justifikohet Zotit të tij për mosnënshtrim ndaj urdhrit të Tij, e për krekosjen mbivlerësuese të tij, i tha se Ti më krijove mua më të mirë, sesa që e ke krijuar atë-njeriun. Andaj, s'është çudi që sot, kushdo që ndihet dhe pretendon vetë-përmbushjen, të gjejë këso lloj alibish djallëzore të rrëfyera në Librin tonë fisnik si tipare djallëzore, për të shkelur në qafë të të tjerëve, pastaj edhe për t'i poshtëruar ata. Vetë Muhamedi a.s., na rrëfeu për një kategori njerëzish, të përsëritur si soj në çdo kohë, që ne "e shohim të pa vlerë e me sy nënçmues namazin tonë karshi namazit të tyre, dhe agjërimin tonë karshi agjërimit të tyre", por që ngushëllimi më i dëlirë mbetet fakti se llogaria finale, do të jetë pranë Gjykatores së Drejtë te Zoti ynë në Ahiret.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e festës së Fitër Bajramit, e mbajtur në Xhaminë "Sulltan Mehmet Fatih" në Prishtinë

Nga Ramazani te një shoqëri me vlera

Të nderuar besimtarë,

Sot është dita e Fitër Bajramit – dita e gëzimit, falënderimit dhe shpërblimit për ata që e përjetuan Ramazanin me besim dhe përkushtim. Është dita kur mëshira e Allahut shfaqet dhe zemrat mbushen me dritë dhe qetësi. Ramazani nuk ishte vetëm një muaj që kaloi, por një shkollë që na mësoi durimin, vetëpërmbajtjen dhe na mundësoi afrimin tek Allahu. Në të mësuam ta kontrollojmë veten, ta shtojmë adhurimin dhe t'i pastrojmë zemrat tona. Bajrami si festë nuk është fundi i ibadetit, por fillimi i qëndrueshmërisë. Prandaj, le ta ruajmë këtë frymë edhe pas Ramazanit, duke forcuar besimin, duke bërë vepra të mira dhe duke përhapur dashuri, falje dhe solidaritet.

Qytetarë të nderuar,

Morali është fryti më i bukur dhe më i vlefshëm i Ramazanit. Agjërimi nuk ishte vetëm për ta ndalur urinë dhe etjen, por për ta pastruar zemrën dhe për ta fisnikëruar shpirtin. Ai erdhi që ne të largohemi nga padrejtësia, nga fjalët e këqija, nga përgojimi e arroganca, dhe të zbukurohemi me sinqeritet, butësi dhe drejtësi. Allahu e lartësoi të Dërguarin e Tij a.s., duke e përshkruar me moral madhështor, për të na treguar se kulmi i besimit është sjellja dhe edukata e mirë. Zoti në Kuran thotë: *"Dhe me të vërtetë, ti je me virtyte të larta të moralit."* (El Kalem, 4).

Të dashur vëllezër,

Kurani fisnik është libër udhërrëfyes besnik që duhet të jetojë në zemrat dhe veprat tona. Nuk zbriti që të vendoset në rafte me respekt formal, por që të ngrihet në jetën tonë si dritë, si drejtim dhe si shpëtim. Prandaj të dashur besimtarë, dijeni mirë se, nuk ka mburojë më të fortë për ne, se Kurani që na udhëzon në vazhdimësi drejt dashurisë për Zotin, për jetën, për njeriun e për vatanin.

Të dashur prindër,

Mos i lini fëmijët në mëshirën e kohës! Mos ia dorëzoni edukimin e tyre ekraneve që nuk njohin moral as turp, as kufi. Mos lejoni që zemrat e tyre të mbeten larg dritës së Kuranit. Afrojini me xhaminë që ta njohin përulësinë dhe devotshmërinë. Afrojini me dijen që ta dallojnë të vërtetën nga e kota. Sepse një shoqëri e shëndoshë ndërtohet me zemra të pastra, me moral të lartë, me edukatë dhe me dashuri për fenë dhe për atdheun.

Të dashur vëllezër dhe motra,

Në kohët e sotme, për ta përballuar krizën morale e sociale që po prek mbarë njerëzimin, kërkohet domosdoshmërisht respekti ndaj pluralizmit dhe pranimi i dallimeve mes individëve, komuniteteve e kombeve, pa asnjë formë dominimi ekonomik, kulturor apo ushtarak. Bashkëjetesa njerëzore nuk është vetëm një nevojë sociale, por një parim i thellë fetar dhe kombëtar, i rrënjosur në historinë dhe identitetin e popujve tanë.

Në realitetin e sotëm, ku egoizmi, urrejtja dhe konflikti shpesh sundojnë marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndërkombëtare, kuptimi i vërtetë i dashurisë dhe paqes duket si

përjashtim nga rregulli. Fetë, megjithatë, erdhën si mesazh paqeje, duke ofruar udhëzime për respekt të ndërsjellë, mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërnjerëzor. Besimet dhe fetë nga njerëz të padijshëm, shpesh akuzohen për përçarje, ndërkohë që thelbi i tyre i vërtetë është nxitja e solidaritetit dhe dialogut.

Sipas Islamit, nuk mund të imagjinohet që njerëzit do të bashkohen në një fe apo kulturë të vetme, ngase krijimi i dallimeve mes njerëzve tregon madhështinë dhe vullnetin e Zotit, i Cili shumë qartë në Kuran na thotë: *"Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë."* (Hud, 118).

Pra, Kurani na dëshmon se diversiteti është një element i pandashëm i natyrës njerëzore, që duhet kuptuar dhe respektuar në mënyrë të përgjegjshme. Nga perspektiva e Islamit, bashkëjetesa nuk është thjesht tolerancë; ajo është një parim i bazuar mbi dashuri, respekt dhe drejtësi.

Në këtë kuadër, përçarjet, urrejtja dhe fyerjet që shpërndahen mes bijve të të njëjtit komb janë jo vetëm kërcënim moral, por edhe shkelje e thelbit të identitetit kombëtar dhe fetar. Bashkëjetesa e bazuar mbi respekt reciprok dhe vlerësim të dallimeve është rruga e vetme për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme që jeton në paqe e në harmoni.

Të dashur vëllezër dhe motra,

S'ka dyshim se edhe shoqëria jonë sot po përballet me sfida të shumta. Shpesh shohim tensione, përçarje dhe vështirësi në zgjidhjen e problemeve edhe politike apo sociale, të cilat direkt prekin jetën e qytetarëve. Duhet ditur se dialogu është më i fortë se përçarja, se urtësia është më e fortë se zemërimi, se përgjegjësia është më e fortë se interesi personal. Nëse këto vlera i kultivojmë në jetën tonë shoqërore dhe publike, shumë probleme do të zgjidheshin më lehtë.

Megjithatë, të mos humbasim shpresën, ngase shpresa është forca që e mban një popull gjallë. Si udhëheqës shpirtëror dhe si përfaqësues i një institucioni që historikisht ka qenë pranë popullit në momentet më të rëndësishme të historisë sonë, ndiej obligim moral dhe qytetar t'i drejtohem me një fjalë të sinqertë ndaj faktorit politik të vendit tonë. Duhet ditur të gjithë pa përjashtim, se shteti dhe institucionet e saj janë amanet i qytetarëve dhe përgjegjësi që iu besohet përfaqësuesve politikë, për të shërbyer me ndershmëri, maturi dhe vizion për të mirën e përbashkët.

Prandaj është e papranueshme që sot, në kohë paqeje dhe në kushte të një sistemi demokratik, vendi ynë të ngecë për shkak të mungesës së vullnetit politik për kompromis, dialog, përgjegjësi, dhe për pasojë zhvillimi i shoqërisë tonë të mbetet peng i krizave politike. Në momente të tilla kërkohet maturi e vetëdije e lartë shtetërore, kërkohet kulturë dialogu dhe mbi të gjitha kërkohet sakrificë për ta vendosur interesin e vendit e të kombit mbi çdo interes tjetër. Shoqëria jonë ka nevojë për më shumë urtësi në politikë, për më shumë kulturë dialogu dhe për më shumë ndjenjë përgjegjësie ndaj interesit publik. Historia do të gjykojë jo vetëm për vendimet që janë marrë, por edhe për momentet kur përgjegjësia është shmangur.

Lusim Zotin që të na bekoj me urtësi e drejtësi, që të jemi në nivel të përgjegjësisë që mbajmë për të ardhmen e vendit e kombit, qoftë si individ apo si shoqëri.

Zoti i Madhërishëm na bëftë prej atyre që ndërtojnë familje të forta, rini të ndershme dhe një shoqëri me besim, moral dhe dashuri për atdheun.

Myftiu Naim ef. Tërnava

Prishtinë, më 20.03.2026

“Roli integrues dhe transformues i bashkësive islame në Ballkan në promovimin e paqes së qëndrueshme, dialogut ndërfetar dhe kohezionit shoqëror”

I nderuari kryetar i Dijanetit të Turqisë, prof. dr. Safi Arpagush, njëherësh edhe kryetar i këtij Forumi Ballkanik,

I nderuari nikoqir i kësaj Konference, h. hafëz Shaqir ef. Fetai, reis i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut,

Të nderuar myfti, reisë, kryetarë të bashkësive islame të Ballkanit,

Të nderuar dijetarë, profesorë, përfaqësues të institucioneve fetare dhe të ftuar të tjerë,

Ju vëllezër e motra,

Më lejoni që, në fillim, t’ju shpreh konsideratën time më të lartë për praninë tuaj në këtë takim me rëndësi të veçantë, i cili bart jo vetëm peshën e përgjegjësisë sonë institucionale, por edhe nderin e një misioni të lartë moral, shpirtëror dhe qytetërues. Zoti xh.sh., thotë: *“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij dhe i di më së miri ata që janë në rrugë të drejtë.”* (En Nahl, 125).

Ky takim, i dhjeti me radhë, i krerëve të bashkësive islame të Ballkanit përbën një moment të rëndësishëm reflektimi dhe veprimi të përbashkët, ku liderët fetarë të rajonit janë të thirrur të japin kontributin e tyre të çmuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve tona dhe institucioneve që ne përfaqësojmë. Ky Forum nuk është vetëm një hapësirë diskutimi, por një platformë strategjike për thellimin e dialogut, për shkëmbimin e përvojave institucionale, dhe për ndërtimin e një vizioni të përbashkët mbi sfidat dhe mundësitë që kemi përpara.

Si pjesëtarë të një historie e të një hapësire dhe trashëgimie kulturore të përbashkët, ky takim paraqet një mundësi për të adresuar me maturi dhe përgjegjësi sfidat tona të përbashkëta; për të ndarë ide dhe praktika të suksesshme, si dhe për të tejkaluar divergjencat apo keqkuptimet, përmes dialogut të sinqertë dhe mirëkuptimit reciprok. Në këtë mënyrë, kjo Konferencë, shërben si një gurthemel për konsolidimin e unitetit dhe për avancimin e rolit të bashkësive islame në Ballkan, në promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Ballkani përfaqëson një hapësirë unike gjeokulturore dhe historike, ku ndër shekuj janë ndërthurur sfida të mëdha, por edhe shumë përvoja të bashkëjetesës, përkundër faktit se Ballkani, në rrjedhën e historisë, ka qenë shpesh një arenë e përplasjeve të shumta, ku janë shënuar konflikte e luftëra të

dhimbshme, derdhje gjaku dhe akte të rënda gjenocidi dhune e mizorie.

Kjo trashëgimi jo e mirë e përleshjeve dhe kontradiktave mes popujve të ndryshëm, nuk mund, dhe nuk do të duhej ta përcaktonte të ardhmen e Ballkanit. Përkundrazi, pikërisht nga kjo përvojë historike e dhimbshme lind nevoja dhe përgjegjësia për të afirmuar epërsinë e arsyes, të dialogut dhe të ndërgjegjes kolektive.

Në këtë kuptim, të nderuar të pranishëm, sfida jonë e përbashkët qëndron në gjetjen dhe fuqizimin e atij potenciali racional e moral, që i tejkalon ndasitë dhe plagët e së kaluarës, duke ndërtuar një vizion të përbashkët për të ardhmen. Një e ardhme ku popujt e shumtë të Ballkanit, me përkatësitë e tyre të ndryshme kulturore dhe fetare, të bashkëjetojnë në frymën e harmonisë, respektit reciprok dhe paqes së qëndrueshme.

Duhet ditur se ky rajon ka qenë dhe mbetet një pikëtakim i qytetërimeve, i gërshetimit të kulturave, gjuhëve dhe besimeve të ndryshme, duke krijuar një mozaik kompleks e të pasur identitetesh. Ballkani nuk mund të kuptohet jashtë larmisë së tij, as të ruhet pa maturinë dhe vizionin e institucioneve, që kultivojnë respektin reciprok, dialogun e qëndrueshëm dhe harmoninë shoqërore.

Në këtë kontekst të gjerë dhe domethënës, bashkësitë islame të Ballkanit kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të veçantë në ndërtimin dhe ruajtjen e këtij ekuilibri delikat, ndërkulturor dhe ndërfetar.

Prania e tyre historike dhe kontributi i vazhdueshëm në jetën fetare, shoqërore, kulturore dhe shpirtërore të rajonit përbëjnë një element thelbësor të këtij realiteti.

Kam bindjen se kjo është edhe arsyeja pse jemi mbledhur sot këtu në Shkup. Në këtë kryeqytet, që përfaqëson në mënyrë shumë të mirë, një model të gjallë të bashkëjetesës ndërmjet kulturave dhe besimeve të ndryshme, nisur nga periudha e pranisë osmane në këto troje, rreth gjashtë shekuj më parë. Shkupi është formësuar si një hapësirë e rëndësishme e ndërveprimit qytetërues, duke ruajtur dhe zhvilluar një trashëgimi të pasur shumë kulturore dhe shpirtërore.

Me këtë rast, më lejoni që, në emrin tim personal dhe besoj edhe në emër të të gjithë juve të pranishmëve, të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim më të sinqertë për nikoqirin e kësaj Konference, haxhi hafëz Shaqir ef. Fetai, reis i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, për mikpritjen e ngrohtë dhe përkushtimin e tij në krijimin e kushteve shumë të mira për mbarëvajtjen e kësaj Konference. Angazhimi i tij dhe i institucionit që ai drejton përbën një shembull të lartë të përgjegjësisë institucionale dhe të përkushtimit ndaj forcimit të dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet nesh.

Të nderuar efendilerë,

Të nderuar të pranishëm,

Ballkani, me gjithë sfidat, dallimet dhe periudhat e tij të ndërlikuara, mbetet një rajon ku kujtesa historike, tradita shpirtërore dhe përvoja e bashkëjetesës kanë krijuar një model të veçantë njerëzor e shoqëror. Në këtë mozaik të ndjeshëm dhe të pasur, bashkësitë islame kanë qenë dhe mbeten pjesë përbërëse e identitetit të tij historik, kulturor, fetar dhe etik.

Prania e Islamit në Ballkan nuk është vetëm prani demografike apo institucionale; ajo është prani qytetëruese, e rrënjosur në traditën e maturisë, në kulturën e respektit dhe në etikën e bashkëjetesës. Për shekuj me radhë, myslimanët e këtij rajoni kanë jetuar krah për krah me besimtarë të feve të tjera, duke ndarë jo vetëm të njëjtat hapësira gjeografike, por edhe të njëjtat sfida, gëzime, kujtime, përgjegjësi dhe aspirata për paqe, dinjitet dhe të ardhme më të mirë për brezat që vijnë.

Pikërisht për këtë arsye, takime si ky që po mbahet sot këtu në Shkup, janë momente shkëmbimi mendimesh, janë hapësira ndërgjegjësimi dhe përgjegjësi e përbashkët. Janë momente kur ne duhet ta pyesim veten me sinqeritet, larg çdo formalizmi, larg çdo retorike të zbrazët, se cili është roli ynë real në kohën që po jetojmë. Cili është kontributi që bashkësitë tona islame mund dhe duhet të japin, në një rajon që ka nevojë për më shumë besim të ndërsjellë, më shumë urtësi, më shumë dialog, më shumë afrim njerëzor dhe më shumë siguri morale?.

Fatkeqësisht, edhe sot, kur ne, të nderuar efendilerë, jemi mbledhur në këtë Konferencë këtu në Shkup, për të reflektuar mbi paqen, dialogun dhe bashkëpunimin, në shumë vende të botës vazhdon të mbizotërojë logjika e dhunës dhe jo ajo e arsyes. Jemi dëshmitarë të vrasjeve të fëmijëve, të civilëve të pafajshëm dhe të të moshuarve, si dhe të shkatërrimit të infrastrukturës, pothuajse të çdo gjëje nëpër vende të ndryshme të konflikteve dhe luftërave, e të ndërtuara me mund e sakrificë nga shoqëri të ndryshme njerëzore. Konfliktet dhe luftërat, për fat të keq, mbeten një realitet i hidhur dhe i përhapur në shumë rajone të globit, e në veçanti në Lindjen e Mesme.

Përballë kësaj gjendjeje tronditëse, është e domosdoshme të riafirmojmë me qartësi të plotë, se tradita jonë fetare islame e dënon në mënyrë të prerë dhe të pa kompromis çdo akt dhune ndaj jetës së pafajshme. Vrasja e fëmijëve dhe e civilëve të pambrojtur, përbën një shkelje të rëndë të parimeve themelore të fesë sonë, e cila e konsideron jetën njerëzore të shenjtë dhe të paprekshme. Ky qëndrim nuk është vetëm një parim teologjik, por një obligim moral dhe njerëzor që na thërret të ngremë zërin kundër padrejtësive dhe të kontribuojmë aktivisht në mbrojtjen e dinjitetit dhe jetës së çdo individi, pa dallim vendi, feje, race a ngjyre.

Fatkeqësisht, si rezultat i kësaj gjendje, shoqëritë njerëzore po përballen me tensione të shumta, polarizime ideologjike, dobësim të lidhjeve shoqërore, rritje të gjuhës së urrejtjes, deformime të identiteteve fetare, instrumentalizim të fesë për interesa të ngushta, si dhe përpjekje të ndryshme për ta larguar fenë nga roli i saj i natyrshëm si forcë paqeje, mëshire dhe ekuilibri. Edhe rajoni ynë, ndonëse me përvojë të çmuar të bashkëjetesës, nuk është i imunizuar nga këto rreziqe.

Të nderuar të pranishëm,

Në frymën e traditës sonë të përbashkët dhe të vlerave islame, besimtarët e besimit islam janë të thirrur ta manifestojnë vëllazërinë e tyre përmes kujdesit të ndërsjellë, vizitave vëllazërore, ndihmës konkrete dhe mbështetjes morale. Duke ndarë kohën, praninë dhe të mirat materiale me ata që janë në nevojë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që forcojmë lidhjet ndërmjet nesh, por edhe ruajmë shpirtin e solidaritetit, humanizmit dhe unitetit, që kanë karakterizuar shoqëritë tona Ballkanike ndër shekuj.

Prandaj, të nderuar të pranishëm, pyetja që shtrohet para nesh sot në këtë Konferencë nuk është vetëm një pyetje teorike, ajo është pyetje e kohës, pyetje e përgjegjësisë, pyetje e misionit dhe e ndërgjegjes sonë institucionale, për mbarë rajonin. Në dritën e diversitetit fetar, kulturor dhe kombëtar, që e karakterizon rajonin e Ballkanit, dhe duke pasur parasysh traditën e gjatë të bashkëjetesës ndërmjet popujve dhe besimeve të ndryshme, pyesim: Si mund të marrin përsipër bashkësitë islame në vendet e Ballkanit një rol më të fuqishëm, më të vetëdijshëm dhe më të organizuar qytetërues, etik dhe shoqëror në forcimin e vlerave të bashkëpunimit, në promovimin e respektit të ndërsjellë ndërmjet pasuesve të feve dhe në ruajtjen e harmonisë e të bashkëjetesës ndërmjet popujve të rajonit?.

Si dhe sa mund të kontribuojnë këto bashkësi, duke u mbështetur në parimet fisnike të Islamit dhe në mendimin e tij të ekuilibruar, të ndërtuar mbi mëshirën, drejtësinë, maturinë, urtësinë, njohjen e ndërsjellë dhe respektimin e dinjitetit njerëzor. Në përhapjen e vëllazërisë njerëzore, në forcimin e kulturës së dialogut, në mbrojtjen e brezave të rinj nga gjuha e urrejtjes, ekstremizmi dhe përçarja, si dhe në parandalimin e shkaqeve që mund të prodhojnë tensione, konflikte apo përplasje të reja edhe në rajonin e Ballkanit.

Të nderuar efendilerë, liderë shpirtërorë të Ballkanit,

Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e besimtarëve islam në Ballkanin Perëndimor i përkasin popullit shqiptar, vlen të theksohet se shqiptarët, historikisht i takojnë tri besimeve kryesore fetare. Në vazhdimësi, shqiptarët pa dallim besimi, kanë ndërtuar dhe ruajtur një traditë të qëndrueshme të bashkëjetesës ndërfetare. Kjo traditë është karakterizuar nga mungesa e konflikteve mbi baza fetare, nga respekti i ndërsjellë për përkatësinë shpirtërore të tjetrit, dhe nga një kulturë e konsoliduar harmonie dhe mirëkuptimi shoqëror.

Megjithatë, në veçanti në dekadën e fundit, vërehen dukuri shqetësuese brenda shoqërisë shqiptare, që cenojnë këtë ekuilibër të ndërtuar me mund e kujdes ndër dekada e shekuj. Disa individë dhe grupe të caktuara e të papërgjegjshme, në kundërshtim me normat e etikës publike dhe të bashkëjetesës qytetare, shfaqin qëndrime fyese ndaj ndjenjave fetare të besimtarëve myslimanë, të cilët përbëjnë shumicën në hapësirat e trojeve tona etnike shqiptare. Këto fyerje, sharje, urrejtje e nxitje, të manifestuara veçanërisht në Kosovë kundër ndjenjës islame, shpesh mundohen të justifikohen si "demokraci dhe liri e shprehjes". Nisur nga përhapja e gjuhës së urrejtjes, kemi të theksuar një islamofobi që askund në rajon nuk është prezente në këtë masë. Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme riafirmimi i vlerave themelore të respektit të ndërsjellë, të përgjegjësisë publike dhe të ruajtjes së harmonisë ndërfetare, si shtylla thelbësore për stabilitetin dhe kohezionin shoqëror në rajon.

Kurrë gjatë historisë nuk është identifikuar kombi shqiptar me dhunë dhe fanatizëm ekstrem mes besimeve që u takojnë. Nisur nga ky prizëm, formimi i një shteti të quajtur shtet bektashian, kinse me premisa evropiane, mendoj se është i panevojshëm dhe shumë i rrezikshëm për të ardhmen dhe harmoninë fetare ndër shqiptarët, por jo vetëm. Të gjithë ne duhet ditur se iniciativa e tillë shkon në dëm të fesë islame, me qëllim të deislamizimit të shqiptarëve, të cilët në shumicë janë syni, dhe futjes së përçarjes në mesin e besimtarëve myslimanë shqiptarë.

Nisja për formimin e këtij mikroshteti bektashian në Shqipëri, thjesht është një nisje nga një skenar ndërkombëtar, i përgatitur me vite dhe kujdes të veçantë. Edhe pse deri tash nuk i dimë qëllimet, prapaskenat, formën etj., e dimë fare mirë se, assesi ky propozim nuk mund të vjen në emër të promovimit të vlerave dhe harmonisë fetare, apo të paqes. Formimi i një shteti bektashian cenon harmoninë fetare, cenon ekuilibrin fetar brenda kombit shqiptar. Pra, është një ide qesharake dhe absurde, ngase Shqipëria nuk është pronë e kryeministrit që të luaj me fatin e saj pa i pyetur shqiptarët fare.

Të nderuar liderë fetarë,

E gjithë kjo nuk kërkon prej nesh vetëm një përgjigje konceptuale. Ajo kërkon vizion, por mbi të gjitha kërkon guxim moral, kërkon kthjelltësi në leximin e kohës. Kërkon aftësi për ta kuptuar se bashkësitë tona islame nuk janë thjesht administruese të jetës fetare, por edhe bartëse të një përgjegjësie më të gjerë. Përgjegjësisë për ta mbrojtur njeriun nga përçarja, shoqërinë nga urrejtja dhe të ardhmen e brezave të rijnë nga pasiguria morale.

Nëse e shohim në thellësi, dhe me syrin e mendjes, roli ynë si Bashkësi Islame në Ballkan nuk duhet të kuptohet si rol i zhurmshëm, as si rol konkurrues, as si rol i lidhur me logjika të pushtetit.

Përkundrazi, forca jonë e vërtetë buron nga diçka shumë më e qëndrueshme dhe më e lartë. Nga autoriteti moral, nga fjala e urtë, nga edukimi i drejtë, nga shembulli i mirë, nga kujdesi për familjen, nga formimi i brezit të ri, nga mbrojtja e dinjitetit njerëzor dhe nga besnikëria ndaj parimeve të larta të fesë sonë të mbështetura në urdhrin hyjnor.

Bashkësitë Islame në Ballkan mund të jenë ura besimi, ura ndërmjet komuniteteve, ura ndërmjet traditës dhe modernitetit, ura ndërmjet identitetit fetar dhe përgjegjësisë qytetare, ura ndërmjet dallimeve-divergjencave dhe harmonisë. Dhe kjo nuk përbën aspak një ambicie të tepruar, përkundrazi është shprehje e drejtpërdrejtë e vazhdimësisë së një misioni historik, të mbështetur mbi urdhrin hyjnor të

Kuranit dhe mbi porositë universale të Pejgamberit tonë të fundit Muhamedit a.s..

Ky mision, i rrënjosur thellë në traditën shpirtërore dhe institucionale, është mishëruar ndër shekuj nga institucionet tona, të cilat me përkushtim kanë kultivuar vlerat e drejtësisë, mëshirës, bashkëjetesës dhe përgjegjësisë shoqërore. Në këtë kuptim, angazhimi ynë i sotëm nuk është thjesht një përgjigje ndaj sfidave bashkëkohore, por një vijimësi organike e një trashëgimie të pasur dhe të qëndrueshme, e cila na obligon të veprojmë me vizion, urtësi dhe përgjegjësi në shërbim të së mirës së përbashkët.

Nëse duam që Ballkani të mos jetë më një hapësirë e kujtesës së përçarjes, por një hapësirë e kujtesës së pajtimit; Nëse duam që feja të mos perceptohet si vijë ndarjeje, por si energji afrimi; Nëse duam që brezat e rinj të mos trashëgojnë frikë, paragjykim dhe dyshim, por besim, respekt dhe siguri shpirtërore, atëherë duhet të investojmë në një kulturë të re të përgjegjësisë fetare dhe shoqërore.

Kjo kulturë, sipas mendimit tim, fillon me edukimin, me predikimin e matur, me gjuhën e përgjegjshme publike, me refuzimin e çdo lloj instrumentalizimi të fesë; me ruajtjen e traditës sonë islame të ekuilibruar ballkanike, me hapjen ndaj dialogut, me ndërtimin e nismave të përbashkëta humane dhe sociale; me kujdesin për njeriun si qenie e nderuar nga Krijuesi, pavarësisht dallimit të tij fetar, etnik apo kulturor.

Qëllimi ynë nuk duhet të jetë vetëm shmangia e konfliktit, ky është minimumi. Qëllimi ynë i vërtetë duhet të jetë më i lartë: Ndërtimi i një kulture të qëndrueshme paqeje. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm mbi mungesën e luftës, por mbi praninë e besimit të ndërsjellë. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm në marrëveshje formale, por në edukim moral. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm në heshtjen e tensioneve, por në shërimin e tyre përmes drejtësisë, respektit dhe urtësisë.

Prandaj, përgjigjja ndaj krejt kësaj duhet të na çojë drejt një horizonti të qartë:

- drejt forcimit të bashkëpunimit ndërmjet bashkësive islame të rajonit;

- drejt koordinimit të përvojave të mira në fushën e edukimit fetar dhe qytetar;

- drejt afirmimit të Islamit si burim mëshire, ekuilibri dhe përgjegjësie shoqërore;

- drejt mbrojtjes së të rinjve nga ekstremizmi, urrejtja dhe manipulimi;

- drejt thellimit të dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor; dhe

- drejt ndërtimit të një zëri të përbashkët moral, që i flet rajonit me gjuhën e paqes, dinjitetit dhe shpresës.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ballkani ka nevojë për institucione fetare të forta në parime, të qeta në gjuhë, të mençura në qasje, dhe të pastra në mision. Ka nevojë për Bashkësi Islame që nuk mbyllen në vetvete, por që ndriçojnë shoqërinë me shembuj, me urtësi dhe me shërbim. Ka nevojë për liderë fetarë, që kuptojnë se në kohë të trazuara, fjala e tyre mund të shuajë zjarrin ose ta ndezë atë, mund të shërojë plagë ose t'i thellojë ato, mund të ndërtojë ura ose të ngrejë mure.

Prandaj, roli i bashkësive islame në Ballkan, sot, në kohën tonë është i madh, ngase rajoni po përballet me sfida të reja, të mëdha e të ndryshme si: Polarizim shoqëror, dobësim të lidhjeve familjare e farefisnore, mos komunikim i mjaftueshëm mes komuniteteve të ndryshme, rritje e gjuhës së urrejtjes në hapësirat publike dhe digjitale, keqinterpretime të mësimeve të fesë nga individ të paautorizuar, rrezik nga ekstremizmi, dhe përpjekje për ta përdorur fenë për qëllime të ngushta, qofshin ato individuale, grupore, klanore etj..

Përballë kësaj, mendoj se bashkësitë islame, nuk duhet të jenë vetëm vëzhguese, ato duhet të jenë udhërrëfyese morale dhe vizionare për të ardhmen e shoqërisë.

Allahu i Madhëruar thotë: *"Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe qoftë!."* (El Furkan, 63).

Le ta shohim këtë takim jo vetëm si një stacion diskutimi, por si një hap drejt një vetëdijeje të re rajonale, ku bashkësitë islame të Ballkanit e kuptojnë veten si bartëse të një amaneti të madh. Amanetin e paqes, të urtësisë, të harmonisë dhe të vëllazërisë njerëzore.

I Dërguari i fundit i Zotit xh.sh., ka thënë: "Nuk do të hyni në Xhenet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të duheni mes vete." (Transmeton Muslimi).

Dhe le të jetë përgjigjja jonë ndaj kësaj, jo vetëm një përgjigje me fjalë, por një përgjigje me vizion, me bashkërendim, me nisma konkrete dhe me vendosmëri morale. Sepse kur feja e ruan njeriun, shoqëria forcohet; kur respektohet tjetri, ruhet edhe vetvetja; dhe kur bashkësitë fetare bëhen zë i paqes, popujt gjejnë rrugën e bashkëjetesës.

Prandaj edhe qëllimi ynë i lartë duhet të jetë: Ndërtimi i një kulture të qëndrueshme paqeje, dhe shndërrimi i Ballkanit në një hapësirë të bashkëjetesës së mençur dhe të solidaritetit njerëzor.

Të nderuar të pranishëm,

Në mënyrë të veçantë, edhe sot vlen të theksohet roli i pa zëvendësueshëm i Dijanetit të Turqisë, dhe i udhëheqjes së saj në krye me kryetarin e Dijanetit, prof. dr. Safi Arpagush, në organizimin dhe jetësimin e këtyre takimeve. Përmes përkushtimit të vazhdueshëm, vizionit të qartë dhe mbështetjes institucionale. Dijaneti ka krijuar një traditë të qëndrueshme bashkëpunimi, duke e shndërruar këtë forum në një mekanizëm të rëndësishëm koordinimi dhe afrimi ndërmjet bashkësive islame të Ballkanit.

Angazhimi i tij ka qenë dhe mbetet një shtyllë e fortë në kultivimin e dialogut ndërfetar, në ruajtjen e vlerave të përbashkëta dhe në fuqizimin e rolit të institucioneve fetare në shoqëritë tona.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Myftiu Naim ef. Tërnava

Shkup, më 31.03.2026

Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval

(URTËSIA E VEÇIMIT TË MUAJIT SHEVAL DHE SQARIMI I DYSHIMEVE RRETH TIJ)

Dr. Bali M. Sadiku

Agjërimi është një nga adhurimet më të rëndësishme në Islam. Ai e ndihmon besimtarin ta forcojë lidhjen me Allahun, ta pastrojë shpirtin dhe ta disiplinojë veten.

Ramazani është muaji në të cilin Allahu e ka bërë obligim agjërimin. Është një mundësi e jashtëzakonshme për shumëfishimin e veprave të mira. Megjithatë, Allahu nuk e ka kufizuar shpërblimin dhe mirësinë vetëm brenda këtij muaji, por i ka lidhur ato me vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë në adhurim edhe pas përfundimit të tij.

Ndër adhurimet vullnetare që vijnë menjëherë pas Ramazanit është agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval, për të cilin ka ardhur premtim i veçantë në hadithet e Pejgamberit a.s.. Ky agjërim është përshkruar si shkak për arritjen e shpërblimit sikur të jetë agjëruar i tërë viti, gjë që ka nxitur diskutime mes dijetarëve rreth urtësisë së veçimit të muajit Sheval dhe natyrës së këtij shpërblimi.

Në këtë trajtim do të sqarohen argumentet përkatëse nga Kurani dhe Suneti, do të paraqiten mendimet e dijetarëve lidhur me këtë çështje dhe do të shqyrtohet nëse muaji Sheval ka një veçori të veçantë në raport me muajt e tjerë, si dhe si duhet kuptuar shpërblimi i përmendur në hadith.

> Allahu nuk e ka kufizuar shpërblimin dhe mirësinë vetëm brenda këtij muaji, por i ka lidhur ato me vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë në adhurim edhe pas përfundimit të tij.

Nga Ebu Ejub el Ensariu r.a., përcillet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush e agjëron Ramazanin dhe pastaj e pason me agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Sheval, është sikur të ketë agjëruar tërë vitin.”[1]

Dihet se veprat e mira shpërblehen dhjetëfish, siç thotë Allahu në Kuran: *“Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në Ditën e Gjykimit) shpërblehet dhjetëfish.”* (El Enam, 160).

Duke e llogaritur muajin Ramazan si dhjetë muaj dhe gjashtë ditët e Shevalit si dy muaj, përfundimi është se ai që i agjëron ato merr shpërblimin e një viti të plotë. Kjo mbështetet në transmetimin e Thevbanit, ku Pejgamberi a.s., ka thënë: “Agjërimi i Ramazanit llogaritet (në shpërblim) si agjërimi i dhjetë muajve, ndërsa agjërimi i gjashtë ditëve llogaritet (në shpërblim) si agjërimi i dy muajve, kështu që është sikur të ketë agjëruar tërë vitin.”[2]

Nga ajeti dhe hadithet e përmendura më lart kuptohet qartë se çdo vepër e mirë shpërblehet dhjetëfish. Kështu lind pyetja: Nëse dikush agjëron gjashtë ditë gjatë muajve të tjerë, si Muharremin, Shabanin, etj., a do të arrijë shpërblimin e një viti të plotë agjërimi apo jo?

Apo, thënë ndryshe: A ka ndonjë shpërblim shtesë për faktin që këto ditë janë specifikuar në muajin Sheval?

Rreth kësaj çështjeje, dijetarët kanë mendime të ndryshme. Disa thonë se kjo është një shtytje për të nxituar në vepra të mira, ndërsa

të tjerë argumentojnë se muaji Sheval nuk ka ndonjë veçori të veçantë dhe se agjërimi i këtyre ditëve në muajt e tjerë do të kishte të njëjtin shpërblim, por personi do ta humbiste vlerën e përshpejtimit të kësaj vepre pas Ramazanit.[3]

A KA SHEVALI NJË VEÇORI TË VEÇANTË?

Mendimi se dikush që i agjëron gjashtë ditë në muajt e tjerë e arrin shpërblimin e përmendur në hadith nuk është i saktë. Fakti që në hadith specifikohet muaji Sheval tregon se ai ka një veçori të veçantë.

Veprat më të mira me të cilat robi i afrohet Allahut janë ato që Ai i ka bërë obligim. Nga Ebu Hurejre r.a., përcillet se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Allahu i Lartësuar thotë: 'Robi im nuk më afrohet me asgjë më të dashur sesa me veprat që ia kam bërë obligim."[4]

Kështu, nga hadithet e Ebu Ejubit dhe Thevbanit, kuptojmë se shpërblimi i përmendur është për agjërimin farz (obligativ). Kjo do të thotë se ai që e agjëron Ramazanin ka shpërblimin e dhjetë muajve agjërim farz, dhe ai që e pason me gjashtë ditët e Shevalit e plotëson shpërblimin e një viti të tërë agjërimi farz.

Abdullah ibën Mubareku ka thënë: "Ky kuptim është përcjellë në disa hadithe, pra, shpërblimi i agjërimit të këtyre ditëve bashkohet me shpërblimin e agjërimit të Ramazanit."[5]

Ai duket se i referohet hadithit të Ummu Selemes, e cila ka thënë: "Kush agjëron ditën pas Fitër Bajramit, është sikur të ketë agjëruar Ramazanin."[6]

Megjithatë, zinxhiri i transmetimit të këtij hadithi është i dobët siç thotë Ibën Rexhel el Hanbelij.[7].

Ibën Rexheb el Hanbeli, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nëse dikush thotë: 'Nëse ndonjëri i agjëron gjashtë ditë jashtë muajit Sheval, a do ta arrijë të njëjtin shpërblim?' – përgjigjja është: 'Agjërimi i ditëve të Shevalit bashkohet me shpërblimin e Ramazanit, duke u llogaritur si agjërim farz i një viti të plotë'."[8]

Është transmetuar se Usame ibn Zejdi i agjëronte muajt e shenjtë, derisa Pejgamberi a.s., e udhëzoi që të agjëronte disa ditë nga muaji Sheval. Pas kësaj, Usameja e la agjërimin e muajve të shenjtë dhe vazhdoi të agjëronte ditët e Shevalit deri në vdekje.[9]

Vargu i transmetimit është i shkëputur, mirëpo ai përforcohet nga rrugë të tjera transmetimi.[10]

Kjo tregon për vlerën e veçantë të ditëve që vijnë menjëherë pas Ramazanit, ashtu siç është e njohur edhe vlera e madhe e muajit Shaban para Ramazanit.

Nga kjo mund të konkludojmë se agjërimi më i mirë vullnetar është ai që është më afër Ramazanit, qoftë para tij apo pas tij, sepse shpërblimi i tij i bashkëngjitet agjërimit farz të Ramazanit për shkak të afërsisë me të. Pozita e këtij agjërimi në raport me Ramazanin është sikur pozita e suneteve të

rregullta para dhe pas farzeve: ato bashkohen me farzet në shpërblim dhe shërbejnë për të plotësuar mangësitë eventuale në to.

Po ashtu, ashtu siç sunetet e rregullta janë më të vlefshme se namazi vullnetar i pakufizuar, po kështu edhe agjërimi para dhe pas Ramazanit është më i vlefshëm se agjërimi që kryhet larg tij.[11]

Për më shumë detaje mbi këtë temë, mund të shihni edhe:

- "*Sherh Mushkili el Athar*" të imam Tahaviut (6/119-130).

- "*Lataif el Ma'arif*" të Ibën Rexhebit (f. 488).

Allahu e di më së miri!

---

1 Transmeton Muslimi, 2/822, nr. 1164.

2 Transmetojnë: Ibën Maxheh, 1/547, nr. 1715; Ahmedi, 37/94, nr. 22412; Ibën Huzejme në Sahihun e tij, ٨٩٢/٣, nr. 21٥١ – teksti është i Ibën Huzejmes. Hadithi është i saktë.

3 Abdurrahman ibën Ahmed ibën Rexheb el Hanbelij ebu el Ferexh, *Lataif el Mearif*, (Riad: Dar ibën Huzejmeh, 1428 h), f. 488.

4 Transmeton Buhariu, 8/105, nr. 6502.

5 Xhamiu' et Tirmidhi, 3/132.

6 *El Xhamië el Kebir*, 23/ 561 nr. 687/39.

7 *Lataif el Mearif*, f. 490.

8 Po aty, f. 493.

9 Transmeton Ibën Maxheh, 1/555, nr. 1755.

10 *Lataif el Me'arif*, f. 308.

11 Po aty, f. 308.



Efektet e agjërimit në jetën e besimtarit

Mr. Artan Musliu

Padyshim se Allahu xh.sh., ka krijuar çdo gjë me urtësi dhe për një qëllim të vetëm. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh., thotë: *"Për ata që Allahun e përmendin me rikujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të Tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!"* (Ali Imran, 191). Po ashtu, edhe kur bëhet fjalë për krijimin e vetë krijesave të Allahut xh.sh., Allahu na tregon se edhe ato janë krijuar për një qëllim të caktuar. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh., thotë: *"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë."* (Edh Dharijat, 56).

Prandaj, edhe kur është fjala për adhurimet dhe obligimet që Allahu xh.sh., i ka bërë për njerëzit, padyshim se ato kanë urtësi dhe qëllim të caktuar. Këtë e shohim kur është fjala te namazi, ku qëllimi kryesor i tij është që të ndalojë njeriun nga veprat e këqija dhe ta ofroj atë më afër Zotit, Krijuesit të tij. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh., thotë: *"Ti lexo atë që po të shpallet nga Libri (Kurani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve). Allahu e di ç'punoni ju."* (El Ankebut, 45). Gjithashtu, Allahu xh.sh., na tregon edhe për agjërimin, se ai ka një qëllim se për çfarë është bërë obligim për besimtarët. E në lidhje me këtë, Allahu xh.sh., thotë: "O ju që besuat, agjërimi (saum) ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." (El Bekare, 183). Ndërsa, një prej transmetimeve të Pejgamberit a.s., thotë: "Agjërimi është mburojë, andaj mos të jetë i turpshëm dhe i paditur, ai që është agjërueshëm. E nëse dikush e lufton ose e shan, le të thotë: "Unë jam agjërueshëm, dy herë." Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, padyshim se aroma e gojës së agjëruesit është më e ëmbël te Zoti i Madhëruar se aroma e miskut. Ai e braktis ushqimin, pijen dhe dëshirën për hirin Tim. Agjërimi është për Mua dhe Unë e shpërblej atë, siç e shpërblejë edhe një vepër të mirë dhjetëfish më shumë."[1].



Por, a thua vallë këto efekte të këtyre adhurimeve janë efekte momentale? Pra, a mund të themi se janë efekte që ndikojnë vetëm përgjatë kohës sa janë duke ndodhur ato, apo duhet që të kenë efekt përgjatë gjithë jetës së besimtarit?

Padyshim se efekti i këtyre adhurimeve duhet që të ndikojë në jetën dhe përditshmërinë e besimtarit. Kjo ngase, kushdo që ka agjëruar për një muaj të tërë, kushdo që ka arritur të heq dorë nga gjërat e lejuara, si ushqimi dhe marrëdhëniet intime, për një muaj të tërë dhe ka arritur të përmbajë vetveten e tij përgjatë agjërimit, si mund të arsyetohet pas përfundimit të agjërimit? Besimtari nuk ka asnjë arsye as para vetvetes së tij, as para shoqërisë ku jeton, e aq më pak para Allahut xh.sh. që të pretendojë se nuk ka pas mundësi ta përmbajë vetveten e tij. E sidomos pasi që këtë e ka testuar për një muaj të plotë. Prandaj, jo më kot është thënë se, prej shenjave të pranimit të agjërimit është edhe efekti dhe ndikimi apo ndryshimi që ai ka sjellë në jetën e besimtarit.

Por, a thua vallë cilat duhet që të jenë këto efekte, të cilat duhet t'i ndiejë çdo besimtar pas agjërimit?

Efekti dhe ndikimi që duhen të kenë adhurimet në jetën tonë, duhet që të jenë në tri dimensione apo rrafshe kryesore. Ndikimi i tyre duhet që të jetë së pari në vetveten tonë, pastaj në raport me të tjerët, si dhe në raport me Vetë Allahun xh.sh..

Prej shenjave të pranimit të agjërimit është edhe efekti dhe ndikimi apo ndryshimi që ai ka sjellë në jetën e besimtarit.

EFEKTI I PARË – PËRMIRËSIMI I RAPORTIT NDËRMJET NJERIUT DHE ZOTIT

Pra, efekti dhe ndikimi kryesor i agjërimit është përmirësimi i raportit ndërmjet njeriut dhe Zotit të tij, duke u përafruar më afër Tij, duke udhëtuar drejt Tij me vepra të mira, duke dëshmuar dashurinë ndaj Tij, duke mposhtur unin tënd për hir të Allahut xh.sh., duke dëshmuar bindjen tënde ndaj Tij, duke hapëruar drejt devotshmërisë së Zotit xh.sh., duke hapëruar drejt kënaqësisë së Zotit xh.sh., drejt Xhenetit, drejt faljes dhe mëshirës së Zotit xh.sh., duke qenë falënderues ndaj Allahut xh.sh. për mirësinë e shëndetit tënd, duke e listuar veten si kandidat potencial për të merituar faljen e Allahut xh.sh., duke qenë potencialisht i denjë për të qenë prej banorëve të Xhenetit, si dhe të jesh i denjë për ta fituar kënaqësinë e Allahut xh.sh..

Padyshim se nëse ke arritur që të bësh këtë përgjatë një muaji të tërë, atëherë çfarë të pengon që të vazhdosh atë përgjatë tërë jetës tënde? Asgjë, përveç shkujdesjes dhe neglizhencës tënde në raport me Allahun xh.sh..

EFEKTI I DYTË – PËRMIRËSIMI I RAPORTIT NDËRNJERËZOR

Pra, përmirësimi i raporteve ndërmjet njerëzve duke dal prej vetvetes dhe duke u tjetërsuar në shërbim të tjerëve, të dalësh përtej sferës tënde njerëzore duke u solidarizuar me të tjerët, të dëshmosh përkushtimin tënd ndaj shoqërisë njerëzore, të bashkëndiesh me familjet e uritura dhe skamnore. E nëse këtë e ke arritur për një muaj të tërë dhe nëse këtë e ke arritur duke ia kujtuar vetvetes tënde dhe të tjerëve se je agjërueshëm, atëherë përse nuk mund ta arrish duke ia kujtuar vetvetes tënde dhe të tjerëve se je një besimtar që i je nënshtruar Allahut xh.sh.?!

EFEKTI I TRETË – PËRMIRËSIMI I RAPORTIT ME VETVETEN E TIJ

Njeriu, përmes agjërimit, arrin që të përmirësojë raportin me vetveten e tij. Kjo bëhet duke bërë ekuilibrimin mes anës shpirtërore dhe asaj fizike, të triumfosh mbi vetveten, të dalësh jashtë vetvetes tënde, të kesh kontroll

mbi vetveten tënde, t'i japësh përparësi anës shpirtërore më shumë sesa anës fizike, të pastrosh shpirtin tënd para trupit tënd, të jetosh për shpirtin tënd para trupit tënd, të mbash ekuilibrim dhe balancim në mes të anës shpirtërore dhe fizike.

Prandaj, nëse besimtari për një muaj të plotë ka arritur që të ndryshojë sjelljet e tij, të ndryshojë rutinën e jetës së tij, të ndryshojë veset e tij qoftë në raport me vetveten, me të tjerët, apo edhe ndaj Vetë Allahut xh.sh atëherë, si do t'i arsyetoj sjelljet dhe vetitë e tij të ulëta pas agjërimit?!

Padyshim se nuk mbetet më asnjë arsye që pas agjërimit, besimtari të rikthehet në gjendjen e mëhershme dhe të vazhdojë me sjelljet e tij të papranuara. Por, ai duhet që të vazhdojë me sjelljen e tij që kishte gjatë agjërimit. E ashtu, siç e ka përdorur agjërimin, si mburojë, për të shmangur fyerjet, sharjet, ofendimet e të tjera, duhet që të përdorë besimin e tij për ta mbrojtur vetveten e tij nga sjelljet e liga.

Kjo është edhe arsyeja kryesore se përse Allahu xh.sh. e ka konsideruar agjërimin si diçka që bëhet në mënyrë eksplicite vetëm për Të. Pra, është i vetmi adhurim që Allahu xh.sh., në mënyrë direkte, ia ka atribuuar vetvetes së Tij dhe shpërblimin për të e ka lënë të fshehtë. Padyshim se kjo ka ndodhur për shkak të asaj se agjërimi është edhe sprova dhe testimi më i madh që i është bërë besimtarit. Pra, nëse ne jemi në gjendje që për një muaj të ndryshojmë ritmin e jetës tonë, të ushqimit, të gjumit, të marrëdhënieve intime, si elemente bazike për jetën e njeriut, atëherë, si do të mund të arsyetohemi se nuk mund të heqim dorë nga veset e këqija në përditshmërinë tonë, jashtë agjërimit?!

> Prandaj, nëse besimtari për një muaj të plotë ka arritur që të ndryshojë sjelljet e tij, të ndryshojë rutinën e jetës së tij, të ndryshojë veset e tij qoftë në raport me vetveten, me të tjerët, apo edhe ndaj Vetë Allahut xh.sh atëherë, si do t'i arsyetoj sjelljet dhe vetitë e tij të ulëta pas agjërimit?!

Këto janë vetëm disa nga mësimet dhe kuptimet e shumta që mund t'i nxjerrim nga agjërimi, në veçanti, dhe nga të gjitha adhurimet e tjera që bëhen për Allahun xh.sh.. Dhe, krejt në fund, nuk na mbetët gjë tjetër veçse të shpresojmë tek Allahu xh.sh. që të kemi arritur t'i realizojmë praktikisht këto mësime dhe urtësi. E po ashtu, t'i thërrasim mendjes, ndërgjegjes dhe unit tonë, e të fillojmë me përjetimin e efekteve të agjërimit edhe pas përfundimit të muajit Ramazan. Padyshim se e tërë kjo duhet që të bëhet vetëm me një qëllim. Pra, vetëm e vetëm që të jemi sa më të përkushtuar, me të devotshëm dhe më të përafruar ndaj Zotit xh.sh.. E një gjë e tillë nuk mund të arrihet nëse nuk kemi raporte të shëndosha me vetveten tonë, në radhë të parë, e pastaj edhe me shoqërinë dhe njerëzit që na rrethojnë.

---

1 Ky transmetim vjen nga Ebu Hurejre r.a. dhe e shënon Imam Buhariu në Sahihun e tij. Shih transmetimin me numër 1894.



Teshehudi në namaz

Dr. Ejup Haziri

ÇKA ËSHTË TESHEHUDI?

Nocioni *"teshehud"* është i njohur në jurisprudencën islame dhe me këtë term nënkuptohen fjalët që çdo namazfalës i thotë posa të fillojë uljen në namaz, pasi t'i ketë plotësuar dy sexhde, e ato fjalë janë: "Et-tehijjãtu lilãhi ves-salavãtu vet-tajjibãtu, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullãhi ve berekãtuhu, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve resûluhu."[1] Që në shqip ka këtë kuptim: *"Nderimet, lutjet dhe fjalët e bukura (dëlira) qofshin vetëm për Allahun! Paqja (Paqedhënësi) qoftë me ty, o ti i Dërguar, dhe gjithashtu mëshira dhe begatimet e Tij! Paqja qoftë me ne dhe me robërit e drejtë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka zot (që meriton të adhurohet) përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij!"*

Pra, teshehudi nënkupton atë që te ne njihet si "tehijati dhe shehadeti", dhe se shtimi apo pakësimi nga forma e ardhur, sipas medhhebit hanefi konsiderohet si veprim i qortuar (2,(مكروه ngase siç do ta shohim edhe në vijim, mësimi i teshehudit ishte gati sikurse mësimi i ndonjë kaptineje të Kuranit.

Pra, teshehudi nënkupton atë që te ne njihet si "tehijati dhe shehadeti", dhe se shtimi apo pakësimi nga forma e ardhur, sipas medhhebit hanefi konsiderohet si veprim i qortuar (مكروه)

NORMA E TESHEHUDIT

Ka namaze me një ulje dhe me dy, prandaj do të flasim për normën e *teshehudit* në uljen e parë dhe në uljen e dytë, gjegjësisht të fundit.

TESHEHUDI NË ULJEN E PARË

Teshehudi në uljen e parë është sunet sipas pjesës dërmuese të dijetarëve, me theks të veçantë nga dijetarët e mëvonshëm hanefitë dhe nga Tahaviu,[3] por ka mendime se është *vaxhib*.[4] Madje autori i *"Ihtijar-it"* e favorizon mendimin e fundit, ngase Muhamedi kishte paraparë sexhden e harresës në rast të lënies së teshehudit paqëllimshëm.[5] Por, krejtësisht ndryshe mendon autori i librit të njohur *"El Hidajeh"*, i cili është i mendimit se *teshehudi* është *sunet*, ndonëse ai përmend edhe mendimin tjetër të atyre që mendojnë se teshehudi është *vaxhib*.[6]

Në uljen e parë, sipas hanefive, nuk lexohet asgjë më tepër se teshehudi, as salavatet dhe as duatë.7 Madje, sipas Ebu Hanifes, nëse shtohet diç më tepër se teshehudi,8 duhet bërë sexhde në fund të namazit dhe se një gjë e tillë është e qortueshme (9,(مكروه ndërsa sipas Ebu Jusufit dhe Muhamedit, nuk ka nevojë për sexhde edhe nëse lexohet salavati apo ndonjë dua.10 Madje, shumica e dijetarëve hanefitë janë të mendimit se edhe nëse shtohet diç, si fjala vjen: "Allahumme sali ala Muhamed", nuk ka nevojë për sexhde, sepse nuk është shtuar ndonjë rukn që mund ta çorientojë rrjedhën e namazit. Pakica e tyre e mendojnë të kundërtën, që për bazë marrin një mendim të Ebu Hanifes, ku mjafton të shtohet edhe një fjalë e vetme dhe të obligohet sexhdeja e harresës.11 Këtë e ndërlidhin me

faktin se shtimi diç tjetër përveç teshehudit, realisht e vonon qëndrimin në këmbë, që është rukn (pjesë përbërëse e namazit).[12]

E, nëse ndodh e kundërta, të lihet ndonjë pjesë nga *teshehudi*, atëherë si të veprohet? Ata që mendojnë se *teshehudi* është *sunet*, nuk ka nevojë për sexhde përmirësimi për shkak të harresës, mirëpo sipas atyre që mendojnë se *teshehudi* është *vaxhib*, atëherë lënia e *teshehudit* e obligon sexhden e përmirësimit për shkak të harresës, madje këtu nuk ka ndonjë dallim mes harresës së një fjale të vetme apo shumë fjalëve, ngase nuk është për qëllim sasia e harresës (pak apo shumë).

E, nëse namazfalësi e kujton pas selamit se ka harruar një pjesë të teshehudit, atëherë si të veprohet? Këtu kemi dy mendime nga dy nxënësit e njohur të Ebu Hanifes, ku Muhamedi mendon se ai duhet të bëjë sexhde për shkak të harresës, përderisa Ebu Jusufi është i mendimit se nuk është e detyrueshme një gjë e tillë dhe realisht e panevojshme. Nga këto premisa, ulemaja e mëvonshëm hanefitë kanë zhvilluar diskursin e meseleve të tjera, që nuk janë përmendur në librat bazike të njohura si "dhahiru-rr rrivajeh", siç mund të jetë meseleja e faljes së namazit me imam dhe nëse pas namazit i kujtohet se ka harruar një pjesë nga teshehudi. Në raste të tilla, kur namazi falet me imam, ulemaja hanefitë përzgjedhin mendimin e Ebu Jusufit, që praktikisht nuk parasheh sexhde për shkak të harresës (سجدة السهو), ndërsa nëse namazi falet i vetëm, pa imam, atëherë bëjnë përzgjedhjen e mendimit të Muhamedit, që nënkupton se nevojiten sexhdet për shkak të harresës.

Ndoshta përzgjedhja e mendimit të Ebu Jusufit është më i lehtë në aplikim, më i arsyeshëm dhe më i drejtë, ngase mund të ndodhë që menjëherë pas selamit disa namazfalës të ngritën, e në anën tjetër mund të krijohen situata jo të këndshme, sepse jo të gjithë i kuptojnë këto dispozita, dhe si rrjedhojë mund të krijohen edhe përçarje dhe ndasi.[13]

TESHEHUDI NË ULJEN E FUNDIT

Sa i përket normës së leximit të *teshehudit* në uljen e fundit, në medhhebin hanefi është *vaxhib*, jo *farz*.[14]

Me fjalë të përgjithshme mund të konkludojmë se ulja e parë është *vaxhib*, e leximi në të, gjegjësisht *teshehudi* është *sunet* sipas mendimit popullarizues, ndërsa *vaxhib* sipas disa dijetarëve. Ndërsa ulja e dytë është *farz*, e leximi në të është *vaxhib*.[15]

FORMAT E TESHEHUDIT

Në bazë të transmetimeve të ardhura veçojmë katër lloje të përafërta të *teshehudit*, të cilat transmetohen nga katër sahabë të ndryshëm, ku dallimi mes tyre është shumë simbolik. Transmetimi i parë rreth formës së *teshehudit* vjen nga sahabiu i njohur Abdullah ibën Mesudi dhe ky është



transmetimi më i fuqishëm dhe në bazë të tij kanë vepruar pjesa dërmuese e dijetarëve. Hanefitë[16] marrin për bazë pikërisht transmetimin e Abdullah ibën Mesudit dhe forma e përcjellë është si në vijim: "Ka thënë Abdullahu: "Kur ne faleshim pas të Dërguarit të Allahut, thoshim: "Es-selamu ala Xhibrile, ve Mikaile, es-selamu ala fulanin ve fulanin", e i Dërguari i Allahut kur u kthye nga ne tha: "Me të vërtetë Allahu është Paqësor, e kur ndokush prej jush të falet, le të thotë: "Et-tehijjãtu lilãhi ves-salavãtu vet-tajjibãtu, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullãhi ve berekãtuhu, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn." Kur ju e thuani këtë, secili rob i Allahut do të fiton mirësi nga qielli e toka.[17] Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve resûluhu."[18]

Në transmetimin tjetër në fund, pas shehadetit, përmendet edhe kjo shtojcë: "Më pas (pas shehadetit) përzgjedh ndonjë dua (lutje) që i pëlqen më tepër dhe me të lutet."[19]

Në transmetimin tjetër, që është po ashtu autentik, gjithashtu i përcjellë nga Abdullah ibën Mesudi sqarohet se i Dërguari i Allahut ua kishte mësuar atyre teshehudin, ashtu siç ua kishte mësuar kaptinat e Kuranit.

"I Dërguari i Allahut ma mësoi teshehudin dhe dora ime mes dorës së tij, ashtu siç na mësonte kaptinat nga Kurani: "Et-tehijjãtu lilãhi ves-salavãtu vet-tajjibãtu, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekãtuhu, es-selãmu

alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve resûluhu."[20]

Transmetohet se Hamadi e mori për dore Ebu Hanifen dhe ia mësoi *teshehudin*, dhe tha: "Ibrahim Nehaiu më mori për dore mua dhe ma mësoi teshehudin, Alkamja e mori për dore Ibrahimin dhe ia mësoi teshehudin, Abdullah ibën Mesudi e mori për dore Alkamen dhe ia mësoi teshehudin, e i Dërguari i Allahut e mori për dore Abdullah ibën Mesudin dhe ia mësoi teshehudin.[21]

Në lidhje me versionin e Abdullah ibën Mesudit rreth *teshehudit*, Tirmidhiu në Sunenin e tij, shprehet: "Hadithi i përcjellë nga Ibën Mesudi, e që transmetohet në më shumë se një mënyrë, është transmetimi më autentik nga i Dërguari i Allahut rreth teshehudit. Sipas tij vepruan shumica e dijetarëve nga shokët e të Dërguarit të Allahut, e më pas tabiinët, dhe gjithashtu njëherësh ky është edhe opinioni i përzgjedhur i Sufjan Thevriut, Ibën Mubarekut, Ahmedit dhe Is'hakut."[22]

Shafiu e mori për bazë transmetimin e Ibën Abasit dhe forma e përcjellë është si në vijim:

"I Dërguari i Allahut na mësonte teshehudin, ashtu siç na mësonte kaptinën nga Kurani, ai thoshte: "Et-tehijjãtu-l mubãrekãt, es-salavãtu-t-tajjibãtu lilah, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullãhi ve berekãtuhu, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden resûlullah."[23]

Në transmetimin e Ibën Maxhes vjen me një ndryshim në fund: "ve esh'hedu enne Muhammeden ‘abduhu ve resûluhu."[24]

Shafiu është i mendimit që Ibën Abasi ishte prej sahabëve të rinj dhe përcjellja e tij vjen nga fundi i jetës së Pejgamberit, gjegjësisht në kohën kur gjërat kishin marrë qëndrueshmërinë përfundimtare, gjersa transmetimi i Ibën Mesudit, sipas Shafiut, vjen në kohën fillestare kur gjërat kishin pësuar ndryshime. Sipas Shafiut, versioni i Ibën Abasit rreth teshehudit është më afër Kuranit (shih: Kaptina Nur, ajeti 61 dhe Zumer, ajeti 73).[25]

Maliku e mori për bazë transmetimin e Omerit dhe forma e përcjellë është si në vijim: Abdurrahman ibën Abdulkarij e kishte dëgjuar Omer ibën Hatabin, gjersa ishte në minber, ua mësonte njerëzve teshehudin dhe thoshte: "Thoni: "Et-tehijjãtu lilahi, ez-zãkijãtu lilahi, et-tajjibãtu-s-salevãtu lilah, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullãhi, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden Abdullahi ve resûluhu."[26]

Sipas tij, Omeri ua mësoi *teshehudin* nga hytbeja dhe se askush nuk e kundërshtoi dhe moskundërshtimi i tyre praktikisht është një lloj konsensusi (ixhma).

Përveç këtyre transmetimeve që i kam sjellë e që janë më të njohurat, kemi edhe transmetimin e Ebu Musa el Eshariut: I Dërguari i Allahut na mbajti një hytbe, ku sqaroi sunetet dhe na mësoi namazin, e mes të tjerash tha: "Kur faleni dhe jeni në pozitën ulur, le të jenë fjalët tuaja të para: "Et-tehijjãtu -t-tajjibãtu, es-salevãtu lilah, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden Abdullahi ve resûluhu."[27]

Gjithashtu kemi transmetimin e Xhabir ibën Abdullahut i cili ka thënë: "I Dërguari i Allahut na mësonte teshehudin ashtu siç na mësonte ne kaptinën nga Kurani."Bismilah ve bil-lah! Et-tehijjãtu lilahi ves-salavãtu vet-tajjibãtu, es-selãmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekãtuhu, es-selãmu alejnã ve alã ibãdilãhis-sãlihîn. Esh'heduen lã Ilãhe il-lAllahu ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve resûluhu. Es'elullahe-l Xhennete ve eudhu bil-lahi mine-n nar." E lus Allahun për Xhenet dhe kërkoj mbrojtjen e Tij nga zjarri i Xhehenemit"[28]

Transmetimi i fundit nga transmetimi i Xhabiri ka vetëm dy dallime, gjegjësisht dy shtojca: Shtojca e parë "bismilah ve bil-lah (në emër të Allahut)", dhe e dyta: "Es'elullahe-l Xhennete ve eudhu bil-lahi mine-n nar (E lus Allahun për Xhenet dhe kërkoj mbrojtjen e Tij nga zjarri i Xhehenemit)."

ANALIZË

Nuk ka dyshim se forma e *teshehudit* e përcjellë nga Abdullah ibën Mesudi, ashtu edhe siç praktikohet te ne, është versioni më i argumentuar, në praktikë më i realizuari që nga koha e sahabëve e gjer në kohën tonë dhe se shumica e dijetarëve e kishin praktikuar këtë formë, siç përmend Tirmidhiu në Sunen. Madje Alij ibën el Medini kategorikisht shprehet se asgjë tjetër nuk është autentike, përveç transmetimit të Abdullah ibën Mesudit që përcillet nga

banorët e Kufes dhe transmetimit të Ebu Musa el Eshariut që përcillet nga banorët e Basrës.

Në këtë kontekst, Shejbani thotë: “Kanë polemizuar njerëzit rreth (formave të) *teshehudit*, mirëpo nuk ka më të sigurt (saktë) se forma e *teshehudit* përcjellë nga Abdullah ibën Mesudi, ngase ai e transmetoi atë nga vetë i Dërguari i Allahut, e ai urrente të shtonte në të një shkronjë të vetme (apo të pakësonte). Ai ua mësonte atyre *teshehudin*, ashtu siç ua mësonte atyre ndonjë kaptinë nga Kurani.”[29]

Falënderimi dhe madhërimi që përdorët në transmetimin e Ibën Mesudit është më i veçantë se në transmetimet e tjera të ndryshme, që përcillen në këtë çështje. Është përdorur nyja shquese (ال) te fjalët me qëllim që mesazhi të jetë më i fuqishëm dhe gjithëpërfshirës. Gjithashtu është përdorur lidhëza (و) mes fjalëve për t'u dhënë akoma kuptim më të fuqishëm dhe domethënës, ngase me lidhëzën secila fjalë është falënderim në vete, për dallim nga disa versione të tjera që nuk e kanë një tretman të tillë. Ndërsa pretendimi i Shafiut nuk mund të jetë i fuqishëm, ngase kjo ndikon që t'u jepet përparësi sahabëve të mëvonshëm ndaj muhaxhirëve të hershëm. E këtë askush nuk e thotë.[30]

Nga Hasifi transmetohet se ai e kishte parë në ëndërr të Dërguarin e Allahut dhe e kishte pyetur: “Njerëzit po përcjellin transmetime të ndryshme rreth teshehudit!” I Dërguari i Allahut ia ktheu: “Vepro sipas (transmetimit të) Ibën Mesudit!”[31]

Edhe pretendimi i Malikut se Omeri ua kishte mësuar njerëzve *teshehudin* nga hytbeja dhe se askush nuk e kishte kundërshtuar, për çka e kishte llogaritur si konsensus, nuk mund të jetë shumë i fuqishëm, sepse ka mundësi që transmetuesi të ketë harruar ndonjë fjalë, pra përderisa hadithi është bartur me shumicë në bazë të kuptimit, ekziston mundësia e harresës apo ndryshimit të ndonjë fjale, jo qëllimshëm. Përveç kësaj, veprimi i Omerit kundërshtohet nga Ebu Bekri, Aliu e Aisheja, të cilët në transmetimet e tyre përcjellin teshehudin ashtu sikurse Ibën Mesudi. Ibën Omeri kishte treguar se kalifi i parë i myslimanëve, Ebu Bekri, i mësonte njerëzit dhe se mësimi i tij rreth *teshehudit* ishte i njëjtë me atë që përcjell Ibën Mesudi. Madje, është transmetuar se shumë sahabë kishin përcjellë një version të tillë si të Ibën Mesudit, si: Muavije, Selman el Farisiu, Aisheja dhe të tjerë.[32]

Përfundimisht themi se dallimet në versionet e teshehudit janë dallime të vogla, përkundër që ekzistojnë versione të ndryshme, madje disa kanë llogaritur deri në 15 versione të *teshehudit*, ku dallimi mes njëri-tjetrit ndonjëherë është një fjalë e vetme. Mirëpo, versioni autentik i Abdullah ibën Mesudit, ashtu siç e praktikojmë ne, është versioni më autentik i mundshëm dhe njëherësh është versioni më i pranuar në mesin e dijetarëve që nga gjeneratat e hershme e deri në ditët tona.

---

1 Buhariu në Sahih, nr.831.
2 Kasani, *Bedaiu-s Sanaiu...* v. I, f. 212.
3 Bedrudin el Ajni, *El Benajetu Sherhi-l Hidajeh*, v. II, f.162.
4 El Hadadiu, Ebu Bekër ibën Alij ibën Muhamed, *El Xhevheretu-n Nejjireh*, bot. I-rë, El Matbeatu-l Hajrijeh, 1322, v.I, f. 54-55.
5 El Mevsilij, *El Ihtijar lita'li-l Muhtar*, v.I, f.184.
6 Bedrudin el Ajni, *El-Benajetu Sherhi-l Hidajeh*, v.II, f.613.
7 Kasani, *Bedaiu-s Sanaiu...* v.I, f.212. Përjashtim bëjnë namazet vullnetare, ku shtimi diç përveç *teshehudit*, është gjë e lejuar. Ndalesa ka të bëjë me namazet farze. Shejhi Zadeh, Abdurrahman ibën Muhamed ibën Sulejman, *Mexhmeu-l enhur fi sherh multeka-l ebhur*, Dar ihjau-t turath, pa vend dhe vit botimi, v. I, f.100.
8 Disa kanë thënë se duhet bërë sexhde përmirësimi për shkak të harresës nëse namazfalësi bën përsëritjen e *teshehudit*, jo se ka harruar, por pse e ka vonuar procedurën tjetër, gjegjësisht vonimin e qëndrimit në këmbë. Shih më tepër për këtë çështje: Ibën Nuxhejmi, *El Bahru-rr rraik sherh Kenzu-d Dekaik*, v.II, f.105; Ibën Abidin, *Redul Muhtar*, v.I, f. 460. Në realitet një gjë e tillë ndodh nëpër xhamitë e ndryshme, ku disa namazfalës, ndoshta nga moskoncentrimi apo edhe nga ngacmimet (vesveset), përsëritin një kaptinë apo lutje, disa herë radhazi.
9 Ibën Abidin, *Redul Muhtar*, v.I, f.510.
10 Ebu-l Mealij, *El Muhitu-l Burhanij fil Fikhi-n Nu'manij*, v.I, f.366.
11 Ebu-l Mealij, *El Muhitu-l Burhanij fil Fikhi-n Nu'manij*, v.I, f.505.
12 Ibën Nuxhejmi, *El Bahru-rr rraik sherh Kenzu-d Dekaik*, v.II, f.101.
13 Ibën Nuxhejmi, *El Bahru-rr rraik sherh Kenzu-d Dekaik*, v.II, f.101-102.
14 Alaudin Samerkandi, *Tuhfetu-l Fukaha*, v.I, f.137. Shafiu mendon se është farz.
15 Kasani, *Bedaiu-s Sanaiu...* v.I, f.312.
16 Shejbani, *Kitabu-l Asl (*i njohur si *El Mebsut)*, v.I, f.9.
17 Sipas një transmetimi tjetër: “Kur ju e thoni këtë, veç keni përshëndetur çdo rob të mirë në qiell dhe tokë.” Buhariu në Sahih, nr.1202.
18 Buhariu në Sahih, nr.831; Ibën Maxheh në Sunen, nr.899. Hadithi është autentik.
19 Buhariu në Sahih, nr.835; Ebu Davudi në Sunen, nr.968. Hadithi është autentik.
20 Buhariu në Sahih, nr.6265; Ibën Maxheh në Sunen, nr.902. Hadithi është autentik.
21 El Mevsilij, *El Ihtijar lita'li-l Muhtar*, v.I, f.183.
22 Tirmidhiu në Sunen, nr. 289, v.II, f.81.
23 Muslimi në Sahih, nr. 60 (403); Ebu Davudi në Sunen, nr. 974; Tirmidhiu në Sunen, nr. 290; Ibën Huzejme në Sahih, nr. 705. Transmetojnë të gjithë përveç Buhariut dhe hadithi është autentik.
24 Ibën Maxheh në Sunen, nr. 900.
25 Serhasij, *El Mebsut*, v.I, f.30.
26 Maliku në Muvetta, nr.300,
27 Ibën Maxheh në Sunen, nr.901; Muslimi në Sahih, nr.62 (404); Ebu Davudi në Sunen, nr.972. Hadithi te Muslimi dhe Ebu Davudi është i gjatë.
28 Ibën Maxheh në Sunen, nr.902.
29 Muhamed ibën Hasen esh Shejbani, *El Huxhxhetu ala ehli-l Medineh*, v.I, f.130.
30 Serhasij, *El Mebsut*, v.I, f.31.
31 Bedrudin el Ajni, *El Benajetu Sherhi-l Hidajeh*, v. II, f.266.
32 Zejlei, *Nasbu-rr Rrajeh Liehadithi-l Hidajeh*, v. I, f.548.

Gruaja – shtyllë e familjes

Dr. Violetë Smajlaj

(Tryeza shkencore, 8 mars 2026)

Kur mendojmë për “shtyllën e familjes”, imagjinojmë një strukturë të fortë. Por nëse ndalemi pak, shohim se kjo shtyllë nuk është prej betoni. Është prej dashurie, durimi dhe një pune të heshtur, që nuk ndalet asnjëherë. Është gruaja që, me një instinkt të lindur, e shndërron një vendbanim të thjeshtë në atë që ne e quajmë “shtëpi”.

Kur flasim për gruan si shtyllë, nuk i referohemi një roli të kufizuar në privatësi, por një faktori që ndikon drejtpërdrejt në vazhdimësinë e qytetërimit. Çdo shoqëri është pasqyrim i familjeve të saj, e çdo familje mbartë ndikimin e gruas.

Ajo është mësuesja e parë, busulla morale dhe spiranca emocionale. Duke rrënjosur empatinë dhe integritetin, ajo i shndërron shtëpitë në hapësira sigurie. Ky përkushtim nuk është thjesht virtyt familjar, por aset kombëtar, ashtu siç thoshte Sami Frashëri: “Gruaja është themeli i shoqërisë njerëzore, është shtylla e moralit të përgjithshëm; ajo është lulishtja e njerëzimit dhe, duke hyrë në lidhjen e shenjtë që ndërton familjen, e ka shpëtuar njeriun nga egërsia, duke e çuar në udhën e qytetërimit.”

“Gruaja është themeli i shoqërisë njerëzore, është shtylla e moralit të përgjithshëm; ajo është lulishtja e njerëzimit dhe, duke hyrë në lidhjen e shenjtë që ndërton familjen, e ka shpëtuar njeriun nga egërsia, duke e çuar në udhën e qytetërimit.”

ÇFARË BËN AJO NË TË VËRTETË?

Ajo sjellë jetë dhe menaxhon jetën. Është ajo që dëgjon të qarat e para të një fëmije dhe mban dorën e një prindi kur ai plaket. Ajo është mësuesja e parë që nuk jep vetëm njohuri, por mëson se si të jesh njeri.

GRUAJA SI MENAXHERE E KAPITALIT SOCIAL

Shpesh flitet për gruan përmes prizmit të “sakrificës së heshtur”. Megjithatë, le ta analizojmë këtë rol si një funksion menaxherial:

- Logjistikë e integruar – Gruaja është koordinatore e orareve, shëndetit dhe edukimit, duke mbajtur gjallë “infrastrukturën” familjare;
- Menaxhim ekonomik – Administrimi i buxhetit familjar është një akt strategjik që siguron stabilitetin mikroekonomik;
- Transmetim kulturor – Ajo është gardiane e vlerave, duke siguruar që kohezioni familjar të mos cenohet nga tranzicionet sociale.
- Dëshmia historike – nga rezistenca te shtetndërtimi.

Nuk mund të flasim për historinë tonë pa folur për gruan shqiptare. Në kohërat kur shkollat ishin të mbyllura dhe liria ishte ëndërr, ajo ishte transmetuesja e gjuhës, ruajtësja e zakoneve dhe ajo që i ushqeu brezat me dinjitet, duke mbajtur gjallë identitetin tonë kur institucionet nuk ekzistonin. Nëpërmjet ninullave, tregimeve dhe edukimit familjar,

ajo nuk përcillte vetëm dashuri, por edhe vlera kulturore, kujtesë historike dhe vetëdije kombëtare.

Gjatë Rilindjes Kombëtare, ajo ishte promotore e arsimit, duke e kuptuar se nëna e arsimuar është garancia e një kombi të ndërgjegjshëm.

Gjatë luftës së fundit, një aktore e mbijetesës dhe rezistencës civile. Ajo ishte organizatore e përballimit familjare në kushte të mungesës ekstreme, kujdestare e të plagosurve dhe mbështetje psikologjike për familjen në bodrume, male dhe zona të izoluara. Dalja për të siguruar ushqim ose ujë, shpesh nënkuptonte përballje direkte me rrezikun. Në shumë raste, gratë dilnin për furnizim jo vetëm për nevojë materiale, por edhe për të vëzhguar situatën, për të vlerësuar lëvizjet e forcave ushtarake dhe për të informuar familjarët për rrezikun e mundshëm. Kjo formë e "vrojtimeve civile" përbënte një akt të heshtur rezistence dhe mbrojtjeje.

Pas luftës, ishte sërish ajo që mori mbi vete rirregullimin e jetës familjare dhe procesin e shërimit të plagëve e traumave të shoqërisë, e plagosur në shpirt, por e palëkundur në qëndresë. Ky nuk është thjesht heroizëm i së shkuarës, por një dëshmi e aftësisë së saj për t'u shndërruar në spirancë në kohë krizash të mëdha.

PARADOKSI QË DUHET NDRYSHUAR

Megjithatë, le të jemi të sinqertë mes nesh. Ne shpesh e kemi glorifikuar gruan nëpër festa, duke e quajtur "nëna heroike", vetëm që t'i ngarkojmë asaj një tjetër barrë, duke ia mohuar hapësirën për të qenë ajo që dëshiron.

Drejtësia nuk është mohim i dallimeve, por barazim i mundësive.

Është e padrejtë, që ajo të jetë "shtylla e familjes" dhe njëkohësisht të mos ketë të drejtë mbi pronën, të mos dëgjohet në vendimmarrje, apo të paguhet më pak për të njëjtën punë. Të nderuar lexues, dashuria për gruan nuk shprehet me lule një ditë në vit; ajo shprehet duke i dhënë mundësinë të jetë e lirë, e pavarur dhe e barabartë. Vetëm përmes një qasjeje të drejtë dhe të balancuar mund të ruhet dinjiteti i figurës së saj, pa e mitizuar dhe pa e instrumentalizuar.

PËR FUND

E ardhmja jonë nuk do të ndërtohet nga ndërtesat e larta, por nga fuqia që ne u japim vajzave dhe grave tona. Kur një grua arsimohet, ne nuk po edukojmë një individ; ne po ndriçojmë një brez të tërë.

Le të mos mjaftohemi vetëm me fjalë, por të marrim një zotim: që gruaja të mos jetë më "shtylla e heshtur", që mban çdo gjë mbi shpinë, por të jetë partnere e plotë, e dëgjuar dhe e vlerësuar në çdo tavolinë ku merren vendime për fatin tonë.

Drejtësia nuk është mohim i dallimeve, por barazim i mundësive. Shoqëria ka nevojë për gra në pozita udhëheqëse, që sjellin jo vetëm kompetencë, por edhe inteligjencë emocionale.

Sfidë mbetet kalimi nga glorifikimi simbolik te vlerësimi konkret: politika të prekshme për balancimin e roleve dhe barazi mundësish. Aty ku lulëzon drejtësia për gruan, lulëzon e ardhmja për të gjithë ne.

Etika e komunikimit në rrjetet sociale në dritën e mësimeve islame

Aid Nasufaj

Nga perspektiva islame, komunikimi nuk është thjesht akt teknik apo social, por akt moral dhe fetar, për të cilin njeriu mban përgjegjësi para Allahut.

HYRJE

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përhapja masive e rrjeteve sociale kanë sjellë ndryshime të thella në mënyrën se si individët komunikojnë, ndërtojnë marrëdhënie shoqërore dhe formësojnë opinionin publik. Komunikimi, i cili dikur ishte i kufizuar në hapësira të ngushta shoqërore, sot është shndërruar në një veprim publik, të përhershëm dhe me ndikim të gjerë. Ky realitet i ri ngre pyetje serioze etike, veçanërisht në lidhje me përgjegjësinë morale të fjalës, vërtetësinë e informacionit dhe respektimin e dinjitetit njerëzor.

Nga perspektiva islame, komunikimi nuk është thjesht akt teknik apo social, por akt moral dhe fetar, për të cilin njeriu mban përgjegjësi para Allahut. Kurani dhe Suneti i Pejgamberit Muhamed a.s. vendosin parime të qarta mbi etikën e të folurit, ndalimin e gënjeshtrës, përgojimit, shpifjes dhe cenimit të privatësisë. Këto parime, ndonëse të formuluara shekuj më parë, ruajnë aktualitet të jashtëzakonshëm në epokën digjitale.

PROFILI ETIK I BESIMTARIT NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Modeli islam i komunikimit etik në rrjetet sociale nis nga ndërtimi i profilit moral të besimtarit, i cili nuk ndryshon sipas hapësirës

(fizike apo digjitale), por mbetet i njëjtë në parim dhe përgjegjësi. Islami nuk e ndan identitetin fetar nga praktika e përditshme; për rrjedhojë, sjellja online është vazhdimësi e akhlakut islam.[1]

Kurani e përshkruan qartë karakterin etik të besimtarit në komunikim: *"Robërit e Mëshiruesit janë ata që ecin në tokë me përulësi dhe kur u drejtohen injorantët, ata thonë: 'Paqe!"* (El Furkan, 63).

Sipas Ibën Kethirit, ky ajet përfshin edhe mënyrën e reagimit verbal ndaj provokimeve, duke kërkuar përmbajtje, maturi dhe shmangie të konfliktit. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm në rrjetet sociale, ku provokimi dhe polarizimi janë të shpeshta.[2]

Pejgamberi Muhamed a.s. e ka përmbledhur profilin etik të besimtarit në një standard të qartë sjelljeje: "Besimtarët me besimin më të plotë janë ata me moralin më të bukur."

Dijetarët theksojnë se morali i bukur nuk kufizohet vetëm në marrëdhënie private, por manifestohet edhe në hapësira publike, përfshirë platformat digjitale.[3]

E VËRTETA, SINQERITETI DHE VERIFIKIMI I INFORMACIONIT

Një nga parimet themelore të etikës së komunikimit në Islam është detyrimi për ta thënë të vërtetën dhe për ta verifikuar informacionin para se ai të përcillet. Islami nuk e pranon komunikimin e bazuar në hamendësime, thashetheme apo emocione momentale, por kërkon që fjala të mbështetet në dije të sigurt dhe përgjegjësi morale. Ky parim njihet në terminologjinë islame si tabajjun (verifikim i kujdesshëm).[4]

Kurani e formulon këtë parim në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe normative: *"O ju që besuat! Nëse ndonjë njeri i pabesë ju sjell ndonjë lajm, verifikojeni, që të mos i bëni dëm ndokujt nga padija e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë."* (El Huxhurat, 6).

Sipas mufesirëve klasikë, ky ajet vendos një rregull universal komunikimi, i cili nuk kufizohet vetëm në rrethanat e zbritjes së tij, por shtrihet në çdo kohë dhe kontekst shoqëror. Në epokën e rrjeteve sociale, ku lajmet përhapen me shpejtësi ekstreme, ky parim bëhet thelbësor për ruajtjen e drejtësisë dhe paqes shoqërore.[5]

Pejgamberi Muhamed a.s., e ka përforcuar këtë parim përmes një paralajmërimi të qartë etik: "Mjafton për njeriun të jetë gënjeshtar, nëse flet çdo gjë që dëgjon."

Ky hadith tregon se mungesa e filtrimit dhe verifikimit është vetë formë e gënjeshtrës morale, edhe nëse individi nuk synon të gënjejë. Dijetarët theksojnë se ky parim është plotësisht i aplikueshëm në komunikimin online, ku "share-i" i pamenduar bëhet burim dëmi.[6]

RUAJTJA E DINJITETIT, NDERIT DHE PRIVATËSISË SË INDIVIDIT

Një tjetër shtyllë themelore e etikës islame të komunikimit është ruajtja e privatësisë dhe dinjitetit njerëzor. Islami e konsideron njeriun të shenjtë në jetën, nderin dhe intimitetin e tij, dhe çdo shkelje e këtyre kufijve përmes fjalës apo publikimit është moralisht e ndaluar.[7]

Kurani e ndalon qartë ndërhyrjen në privatësinë e tjetrit: *"Dhe mos spiunoni (mos përgjoni)."* (El Huxhurat, 12).

Sipas komentatorëve, ky ndalim përfshin çdo formë kërkimi të gabimeve, ekspozimi të jetës private dhe publikimi të asaj që individi dëshiron ta mbajë të fshehtë. Në rrjetet sociale, ky parim shkelet shpesh përmes publikimit të fotove, videove apo informacioneve personale pa leje.[8]

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: "Çdo mysliman është i shenjtë për myslimanin tjetër: gjaku i tij, pasuria e tij dhe nderi i tij."

Dijetarët bashkëkohorë theksojnë se "nderi" sot përfshin edhe identitetin digjital, reputacionin online dhe privatësinë virtuale, duke e bërë këtë hadith plotësisht të aplikueshëm në realitetin bashkëkohor.[9]

GJUHA FYESE, URREJTJA DHE POLARIZIMI NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Gjuha fyese dhe nxitja e urrejtjes janë bërë elemente të zakonshme të komunikimit online, duke krijuar polarizim të thellë shoqëror. Këto forma komunikimi bien ndesh drejt-

përdrejt me etikën islame, e cila synon paqen, butësinë dhe drejtësinë në shprehje.[10]

Kurani e ndalon fyerjen dhe përçmimin: *"O ju që besuat! Le të mos tallet një popull me një popull tjetër."* (El Huxhurat, 11).

Sipas Ibën Kethirit, ky ajet përfshin çdo formë talljeje, etiketimi dhe përçmimi, pavarësisht mjetit të komunikimit.[11] Në rrjetet sociale, kjo ndalesë shkelet shpesh përmes komenteve fyese dhe gjuhës së urrejtjes.

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: "Besimtari nuk është sharës, as mallkues, as fyes dhe as i pahijshëm."

Ky hadith përkufizon qartë profilin etik të besimtarit dhe e bën të papajtueshme urrejtjen verbale me identitetin islam. Në komunikimin digjital, kjo kërkon disiplinë morale dhe vetëkontroll të vazhdueshëm.[12]

PËRHAPJA E LAJMEVE TË RREME DHE MANIPULIMI I OPINIONIT

Një nga devijimet më serioze etike në komunikimin digjital është përhapja e lajmeve të rreme (fake news) dhe manipulimi i opinionit publik. Rrjetet sociale, për shkak të shpejtësisë dhe mungesës së filtrave profesionistë, janë shndërruar në terren të favorshëm për dezinformim, thashetheme dhe propagandë, duke prodhuar konfuzion moral dhe destabilizim shoqëror.[13]

Nga perspektiva islame, përhapja e informacionit të pavërtetë apo të pa verifikuar përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të *sidk-ut* (sinqeritetit) dhe *amanetit* (besueshmërisë). Kurani e ndalon qartë ndjekjen e asaj për të cilën nuk ka dije: *"Dhe mos ndiq atë për të cilën nuk ke dije; vërtet dëgjimi, shikimi dhe zemra – për të gjitha këto do të pyetet njeriu."* (El Isra, 36).

Sipas Taberiut, ky ajet përfshin ndalimin e transmetimit të informacionit pa siguri, pasi pasojat e tij bien mbi individin dhe shoqërinë.[14] Në rrjetet sociale, kjo përgjegjësi shtrihet edhe mbi "shpërndarjen" (share), jo vetëm mbi krijimin e përmbajtjes.

Pejgamberi Muhamed a.s., ka paralajmëruar rreptë kundër mashtrimit informativ: "Kush mashtron, nuk është prej nesh."

> "Besimtari nuk është sharës, as mallkues, as fyes dhe as i pahijshëm."
>
> Ky hadith përkufizon qartë profilin etik të besimtarit dhe e bën të papajtueshme urrejtjen verbale me identitetin islam. Në komunikimin digjital, kjo kërkon disiplinë morale dhe vetëkontroll të vazhdueshëm.

Dijetarët bashkëkohorë theksojnë se mashtrimi sot përfshin edhe manipulimin informativ, titujt mashtrues dhe shtrembërimin e fakteve për klikime apo ndikim politik.[15]

PËRFUNDIMI

Parimet islame të etikës së komunikimit – si e vërteta (sidku), verifikimi i informacionit (tebajjun), ndalimi i përgojimit dhe shpifjes, ruajtja e dinjitetit dhe privatësisë – ofrojnë një kornizë të plotë normative për rregullimin e komunikimit online. Devijimet etike të përhapura në rrjetet sociale, si lajmet e rreme, linçimi virtual dhe gjuha e urrejtjes, bien ndesh drejtpërdrejt me këto parime dhe prodhojnë pasoja të rënda morale dhe shoqërore.

Modeli islam i komunikimit etik nuk synon izolimin nga hapësira digjitale, por angazhim të vetëdijshëm, të matur dhe edukativ. Besimtari mysliman është i thirrur të jetë shembull i moralit të lartë edhe në komunikimin online, duke reflektuar vlerat e Islamit përmes fjalës së drejtë, sjelljes së butë dhe përgjegjësisë ndaj tjetrit.

---

1 Jusuf el Karadavi, El Akhlak el Islamijje, Mektebet Vehbe, Kajro, 2001, f. 33–36.

2 Ibën Kethir, Tefsir el Kuran el 'Adhim, Dar Taiba, Riad, 1999, vëll. 6, f. 130–132.

3 Tirmidhi, Sunen, Dar el Gharb el Islami, Bejrut, 1998, hadithi nr. 1162.

4 Muhamed Abdullah Draz, *Dustur el Akhlak fil Kuran*, Dar el Kalem, Kuvajt, 2008, f. 121–124.

5 Fahruddin er Razi, *Tefsir el Kebir*, Dar Ihja et Turath el Arabi, Bejrut, 2004, vëll. 28, f. 90–92.

6 Nevevi, *Sherh Sahih Muslim*, Dar el Minhaxh, Xhide, 2003, vëll. 1, f. 75–76.

7 Taha Xhabir el Alvani, *Etika islame dhe shoqëria*, III T, Kajro, 2011, f. 67–70.

8 Ibën Ashur, *Et Tahrir vet Tenvir*, Dar et Tunusijje, Tunis, 1984, vëll. 26, f. 246.

9 Abdullah bin Bejjah, *Sina'at el Fetva*, Dar el Minhaxh, Xhide, 2015, f. 301–304.

10 Taha Xhabir el Alvani, *Etika e mospërçarjes në Islam*, III T, Kajro, 2012, f. 91–95.

11 Ibën Kethir, *Tefsir el Kur'an el 'Adhim*, Dar Taiba, Riad, 1999, vëll. 7, f. 371.

12 Tirmidhi, Sunen, Dar el Gharb el Islami, Bejrut, 1998, hadithi nr. 1977.

13 Claire Wardle & Hossein Derakhshan, Information Disorder, Council of Europe, Strasbourg, 2017, f. 20–25.

14 Muhamed ibën Xherir et Taberi, *Xhami'ul bejan*, Dar el Fikr, Bejrut, 1999, vëll. 15, f. 88.

15 Jusuf el Kardavi, *El Amanetu fil Ilam*, Mektebet Vehbe, Kajro, 2005, f. 63–66.

Krijimtaria letrare e bejtexhinjve

Arbin Ahmeti

Duhet theksuar se më herët, letërsia e vjetër shqipe ishte shkruar me alfabet latin nga filobiblikët, por pa mundur të përhapej gjerësisht në tërë etninë shqiptare. Edhe ajo letërsi, ashtu sikundër edhe letërsia fisnore para saj, nuk arriti të bëhej letërsi kombëtare.[1]

Për më tepër, orvatjet e para në fillim të shek. XVIII nga këta shkrimtarë të formuar në një kulturë islame, për t'u shprehur jo në gjuhët orientale, por në gjuhën shqipe, ishin aq vendimtare sa edhe qenë një kalim nga latinishtja në shqipe, për krijimin e letërsisë së hershme shqipe në shek. XVI-XVII.[2]

Letërsia shqiptare e proveniencës islame, e njohur me emërtimin letërsi e bejtexhinjve, me të drejtë integrohet në rrjedhat e letërsisë kombëtare si një segment i rëndësishëm, si një dukuri që shoqëroi dhe pasqyroi gjendjen e vështirë nëpër të cilën kaloi tërë kultura kombëtare prej shek. XVII e këtej, por edhe si dukuri që i dha kontribut tematiko-motivor, stilistik-tipologjik, metriko-ritmik pikërisht kësaj letërsie. Pavarësisht se shumë studiues për këtë segment të kësaj tërësie flasin me



Letërsia shqiptare e proveniencës islame, e njohur me emërtimin letërsi e bejtexhinjve, me të drejtë integrohet në rrjedhat e letërsisë kombëtare si një segment i rëndësishëm, si një dukuri që shoqëroi dhe pasqyroi gjendjen e vështirë nëpër të cilën kaloi tërë kultura kombëtare prej shek. XVII e këtej.

paragjykime, me një dozë përçmimi dhe nënvlerësimi, gjithë kjo për shkak të metodologjisë marksiste të studimit të letërsisë, metodë e cila apriori përjashtonte çdo vepër me tematikë fetare. Ne mund të themi se kjo letërsi, me një dimension, vazhdon rrugën e traditës letrare, të ruhet gjuha shqipe përmes përkthimit dhe të veprave të reja e origjinale fetare, por me një dimension tjetër, me atë tematik-motivor jashtëfetar, e zgjeron dhe e thellon, e pasuron dhe e formëson këtë letërsi me krijimet e njëmendta artistike, për të shërbyer si urë kaluese drejt letërsisë së Rilindjes Kombëtare, madje duke shërbyer si model për shumë shkrimtarë të Rilindjes, si: Naimi, Samiu, Jubani, Vretoja, që i kanë njohur ata autorë dhe i kanë çmuar për vlerat e pamohueshme.[3]

Krijimtaria e bejtexhinjve u shfaq si një rrymë e gjerë poetike, që u shtri në të gjitha trevat shqiptare dhe mbijetoi përtej shekujve XVII e XVIII që e lindën, madje dhe përtej shekullit pasardhës, e shkruar me alfabetin arab, por e pabotuar, e përcjellë kryesisht me përshkrime dhe si traditë gojore. Nga ky aspekt ajo është tipikisht një variant i poezisë popularexhante, si dukuri edhe e qarkut poetik ballkanik. Ajo përfaqëson një formë të poezisë qytetare të asaj kohe dhe është rezultat i zhvillimit të jetës intelektuale në disa qytete e qendra të mëdha shqiptare, si: Berati, Elbasani, Prishtina, Shkodra, Prizreni, Vushtrria, Peja, Gjakova, Tetova, Gjirokastra, Kolonja, Frashëri, Konispoli etj., dhe i ndikimit oriental në të.[4]

Duhet pohuar se hera-herës, krijimtaria e bejtexhinjve është vështruar me një lloj skepticizmi, i cili ka ardhur së paku për tri arsye: E para, mosnjohja; e dyta, shijet personale të atyre që kanë pasur kontakte sado të pakta me krijimtarinë e bejtexhinjve; e treta, shtrëngesat e herëpashershme të karakterit ideologjik, që kanë bërë padyshim punën e tyre për këtë ftohtësi për të cilën po bëhet fjalë. Megjithatë nuk kanë munguar përpjekjet serioze për vlerësimin tërësor të letërsisë së bejtexhinjve, monografia e Osman Myderrizit "*Letërsia me shkronja arabe*", e hartuar në vitin 1954, që gjendet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, është padyshim punimi më i plotë studimor mbi krijimtarinë e Nezim Frakullës me shokë.

Kapitujt që i kushtohen kësaj krijimtarie në tekstin "Historia e letërsisë shqiptare nga fillimet deri në vitin 1939", botuar nga Akademia e Shkencave më 1983 në Tiranë (kapituj që janë hartuar prej Shaban Çollakut), duhen vështruar gjithashtu si një kontribut për njohjen dhe përgjithësimin e mendimit shkencor shqiptar mbi të. Për shkak të mungesave të mëdha në këmbimin e literaturës, mund të na kenë shpëtuar pa zënë në gojë edhe punime të tjera që meritojnë të përmenden si ndihmesa të çmueshme për studimet mbi letërsinë e bejtexhinjve.[5]

Ne historiografinë tonë, letërsia e bejtexhinjve shpesh është marrë e është parë me paragjykime nga mungesa e njohjes së plotë, ose nga një kompleks eurocentrik i shprehur a i nënkuptuar.

Vetëm një studim i veçantë, pa paragjykime dhe pa neglizhencë, do ta nxirrte në shesh kontributin tejet të madh të alamiadistëve shqiptarë. Megjithatë, kur e trajtojmë këtë temë duhet të jemi edhe objektivë për atë që ka konstatuar ndër të parët edhe Naim Frashëri, se disa prej tyre, si: Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Zenel Bastari, Muhamed Kyçyku e ndonjë tjetër i shekullit XVIII-XIX, e kanë mbushur fondin leksikor të gjuhës shqipe me fjalë të huaja, kështu që sot tekstet e tyre janë të pakuptueshme nëse nuk përdorim ndonjë fjalor, apo nëse nuk përdorim shpjegime kuptimore në fund të tekstit, megjithëse është edhe një Sulejman Naibi i shek. XVIII, që jo vetëm se e shkruan gjuhën e pastër shqipe, por edhe polemizon me Nezimin për pastërtinë e gjuhës shqipe, dhe ky bashkë me Theodor Haxhifilipin dhe Grigor Bogumilin, janë puristët e parë të gjuhës shqipe. Megjithatë, nëse leksiku i veprave të shek. XVIII e i fillimit të shek. XIX është paksa jo i kursyer nga fjalët e huaja, ai i gjysmës së dytë të shek. XIX dhe i fillimit të shek. XX është shumë më i pastër dhe bëhen përpjekje që të flitet dhe të shkruhet me nocione leksikore shqipe, madje lutjet të thuhen edhe në këtë gjuhë, të përkthehet libri i shenjtë, Kurani dhe hadithet edhe në gjuhën shqipe.[6]

Letërsi e cila e ushtroi mistikën ishte edhe Alamiado, ose letërsia e bukur e bejtexhinjve, ku thelbi i tyre anonte herë-herë edhe nga fetarja. Divanet, si i Nezim Frakullës, i cili, si një pjesë e mirë e bejtexhinjve, u frymëzua nga autorët e lindjes nga të cilët edhe u huazua prej poetëve persianë, turq e orientalistë dhe kanë të përzier në të, jo vetëm bukurinë e jetës dhe të vashës, por edhe mistikën dhe kënaqësinë me dhuratat e Zotit.

Bismil-lahi nisa divane,

Për sevda tënde ja Mevla,

Për Muhammed Mustafanë,

Zemra rrate ja Mevla.[7]

Në kontekst të temës sociale, mund të themi se bartësit kryesorë janë shkrimtarët që dallohen si për larminë e temave me të cilat e pasurojnë tipologjinë e poezisë shqipe, ashtu edhe me vlerat artistike, me strukturën e vargut, me gjuhën e pasur poetike, me figuracionin e ri e të freskët. Me disa poezi sociale na paraqitet Nezim Frakulla, me poentën kryesore sociale Hasan Z. Kamberi dhe sidomos Zenel Bastari, me tematikën e

gjerë sociale Muhamed Kyçyku e më vonë me tema të gërshetuara Mulla Beqiri, Tahir efendi Boshnjaku, Shejh Elmazi, Shejh Jonuzi, Shejh Mala etj.. Nëse Hasan Z. Kamberi shtroi vetëm disa probleme sekondare të varfanjakëve, Zenel Bastari zhytet shumë më thellë në tërësinë e jetës së tyre:

Bukë pa bukë po rrojnë fakirat,

Pa opinga, zbath e zhvesh;

Si ushujzat na pinë gjakun,

Miletin po marrin për kamë;

Mjellin zi e mjellin gjamë.

Madje këtë e vështron edhe nga aspekti psikik, fukarenjtë s'quhen njerëz pse s'kanë para, për ta është vetëm kërbaçi, për ta askush nuk mendon, ata shtrydhen posi rrushi, fatkeqësia e tyre ngjall kënaqësi shpirtërore te dikush; ata s'kanë individualitet, sepse fjala e puna e tyre merret nëpër këmbë.[8]

Ne historiografinë tonë, letërsia e bejtexhinjve shpesh është marrë e është parë me paragjykime nga mungesa e njohjes së plotë, ose nga një kompleks eurocentrik i shprehur a i nënkuptuar. Së këndejmi, kjo trashëgimi letrare shqiptare duhet të publikohet dhe studiohet shkencërisht në tërësinë e saj, si një dukuri komplekse. Aq sa njihet, është meritë e studiuesve, si: Osman Myderrizi, Idriz Ajeti, Mark Krasniqi, Muhamet Pirraku, Hajdar Salihu e të tjerë, të cilët kanë gjurmuar tekste e kanë botuar punime të shumta. Ajo meriton të bëhet objekt i një shqyrtimi tërësor e të gjithanshëm, si një hallkë me rëndësi e procesit letrar shqiptar dhe si një krijimtari, që me lidhjet e saj të brendshme me kulturat e Orientit e me filozofinë islame i dha një dimension të ri letërsisë e kulturës shqiptare.[9]

---

1 Qazim Qazimi, Historia e qytetërimit islam, shtëpia botuese: "Dituria Islame", Prishtinë, 2018, f. 564.

2 Robert Elise, *Historia e letërsisë shqiptare,* botoi: Dukagjini, Tiranë – Pejë, 1997, f.71.

3 Mahmud Hysa, *Tema sociale në letërsinë islame shqiptare të shek. XVIII-XIX,* Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, redaksia e botimeve historike (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 249.

4 Jorgo Bulo, *Një aspekt i ndikimit të kulturës islame në letërsinë shqipe-poezia e bejtexhinjve,* Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, redaksia e botimeve historike (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 244.

5 Ali Xhiku, *Feja islame dhe letërsia e bejtexhinjve*, Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, redaksia e botimeve historike (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 233.

6 Mahmud Hysa, *Alamiada Shqiptare II, Studime dhe Recensione,* https://dokumen.tips/documents/alamiada-shqiptare-ii-dr-mahmud-hysa-alamiada-shqiptare-ii-studime-dhe-recensione.html, libri pdf, f. 8., ora: 13:6, data: 4.12.2023.

7 Entela Hidri, *Aspekti fetar (islam) në poezi*, https://www.zaninalte.al/2016/12/aspekti-fetar-islam-ne-poezi/, data: 5.12.2023.

8 Mahmud Hysa, *Tema sociale në letërsinë islame shqiptare të shek. XVIII-XIX,* Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, redaksia e botimeve historike (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 251, 254.

9 Jorgo Bulo, *Një aspekt i ndikimit të kulturës islame në letërsinë shqipe-poezia e bejtexhinjve,* Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, redaksia e botimeve historike (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 246.

Ibën Arabiu ndërmjet admirimit dhe kritikës së ashpër

Mimoza Sinani

Myslimanët janë të ndarë në mendime lidhur me Ibën Arabiun (1165-1240), i njohur si "Shejhu i Madh" (*esh Shejh el Ekber*) nga ndjekësit e tij. Kjo ndarje lidhet kryesisht me idetë e tij mistike, veçanërisht me konceptin e "*Vahdetu'l-Vuxhud*" (Njësia e Ekzistencës). Ibën Arabiu përdori një gjuhë simbolike dhe metaforike. Ai shkruante shpesh me shprehje të fshehta, që sufitë i kuptojnë si simbole, por të tjerët i lexojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Konceptin "*Vahdetu'l-Vuxhud*" (Njësia e Ekzistencës) disa e kuptuan si mësim që Zoti dhe bota janë një, gjë që është në kundërshtim me akiden islame tradicionale. Sufitë thonë se ai donte të shpjegonte se vetëm Allahu ka ekzistencë të vërtetë, ndërsa krijesat ekzistojnë vetëm në saje të Tij.

Një pjesë e myslimanëve e nderojnë si një prej figurave më të mëdha shpirtërore në histori. Një pjesë tjetër e kritikojnë si rrezik për besimin e pastër. Një grup i tretë ruan rezervë dhe e sheh si mendimtar të ndërlikuar që nuk duhet gjykuar lehtë.

ÇFARË DO TË THOTË KONCEPTI "*VAHDETU'L-VUXHUD*" (NJËSIA E EKZISTENCËS)?

Koncepti "*Vahdetu'l-Vuxhud*" (Njësia e Ekzistencës) është në qendër të debatit për Ibën Arabiun. Fjala vjen nga "*vahdet*" (njësi) dhe "*vuxhud*" (ekzistencë). Ibën Arabiu thotë se ekzistencë të vërtetë ka vetëm Allahu. Çdo gjë tjetër (njeriu, natyra, universi) nuk ka ekzistencë më vete, por është si një pasqyrim apo shfaqje e emrave dhe e cilësive të Allahut.

Ndjekësit e tij (sufitë) thonë se kjo është mënyrë për të shpjeguar madhështinë e Allahut: çdo gjë në univers dëshmon për Të. Nuk është panteizëm, por një gjuhë poetike dhe metafizike për ta treguar varësinë absolute të gjithësisë prej Allahut.

Kundërshtarët (disa dijetarë të Sheriatit) e kuptuan si barazim i Zotit me krijesat, pra sikur "Zoti është gjithçka dhe gjithçka është Zoti". Kjo bie ndesh me teuhidin (njësimin e Allahut), i cili dallon qartë Krijuesin nga krijesat.

Shumë dijetarë të kujdesshëm thonë se "*Vahdetu'l-Vuxhud*" është një ide e thellë filozofike-mistike, që nuk duhet t'u shpjegohet masave, por vetëm atyre që kanë bazë të fortë në Kuran dhe Sunet.

ADMIRUESIT DHE MBROJTËSIT

Sufitë, urtarë të tasavufit dhe shumë dijetarë të botës shpirtërore e shohin si një gjenial të shpirtërisë islame dhe një ndër interpretuesit më të thellë të realitetit hyjnor.

Imam Sujuti (v. 1505) – Për Ibën Arabiun ka thënë: "Ai është një imam, një dijetar i madh dhe mistik i njohur. Librat e tij janë plot urtësi e dritë, por nuk janë për çdo njeri." Komentet e tij mbi Ibën Arabiun përmenden në librin e tij "*Tanbih al Ghabij bi-Tabri'at Ibn 'Arabi*". Në këtë libër, Sujuti e mbron Ibën Arabiun nga akuzat e kufrit dhe e përshkruan si imam dhe mistik i njohur.[1]

Abd el Kerim el Xhili (v. 1424) – E quajti Ibën Arabiun "Shejhu i Madh", në veprën e tij të famshme "*Al Insan al Kamil fi Ma'rifat al-Awakhir wa al-Awa'il*", dhe e mori si udhëheqës shpirtëror në shpjegimin e Njësisë së Ekzistencës.[2]

Shah Velijullah Dehleviu (v. 1762) – E pranoi madhështinë e tij, duke thënë se fjalët e tij janë të thella dhe shpesh të mbështetura në Kuran dhe Sunet, por kërkojnë kuptim të hollë. Shprehjet e tij për Ibën Arabiun përmenden në "*Huxh xhet Allah al-Baligha*". Ai e pranon vlerën e fjalëve të tij, por paralajmëron se ato kërkojnë kuptim të thellë.[3]

Imam Neveviu (v. 1277) – Nuk dha gjykim të prerë për Ibën Arabiun. Ai tha se gjykimi mbi të dhe shkrimet e tij i takon Allahut, por këshilloi që masat të mos merren me shkrimet e tij për të shmangur keqkuptimet.

Shejh Abdulhalim Mahmud (ish-shejh i Al-Azhar, Egjipt, v. 1978) – Ishte vetë një sufij i njohur. Ai tha se Ibën Arabiu është "një det i diturisë dhe shpirtërisë islame", dhe se "*Vahdetu'l-Vuxhud*" nuk është kufër, por një shpjegim i varësisë absolute të krijesave nga Allahu.[4]

Sufij bashkëkohorë (p.sh. tarikati Mevlevi, Shadhili, Tixhani etj.) – E shohin si një mënyrë për të përjetuar dashurinë ndaj Allahut dhe për të ecur në "shtegun e brendshëm". Ata argumentojnë se kritikat shpesh vijnë nga lexime të shpejta ose jashtë kontekstit.

KRITIKËT DHE KUNDËRSHTARËT

Disa dijetarë të Sheriatit e kanë kritikuar rëndë, duke e akuzuar për teprime, paqartësi dhe për ide që i afrohen panteizmit (barazimit të Zotit me krijesën). Ata e kanë konsideruar të rrezikshme filozofinë e Ibën Arabiut dhe kanë paralajmëruar kundër leximit të librave të tij.

Ibën Tejmijje (v. 1328) – E kritikoi rëndë, duke e akuzuar për panteizëm: "Ai flet me fjalë që janë kufër i hapur, edhe pse mund të ketë pasur qëllim të mirë." Ai i këshilloi myslimanët të qëndrojnë larg librave të tij. Kritikat e tij gjenden në disa prej veprave: "*Majmu' al-Fatava*", vëll. 2 dhe 11. Në këto, ai e akuzon Ibën Arabiun për shprehje që ngjajnë me kufër dhe për përzierje të së vërtetës me gabimin.[5]

Ibën Haxher el Askalani (v. 1449) – Në "*Lisan al-Mizan*", (vëll. 4.), ai përmend kritika ndaj tij, duke thënë se disa prej shprehjeve të Ibën Arabiut janë "shumë të rrezikshme në akide"[6]. Ai citon edhe qëndrime të dijetarëve të tjerë mbi të, duke i quajtur shumë të rrezikshme disa shprehje në "*Fusus el Hikam*".[7]

Burhaneddin el Bikai (v. 1480) – Shkroi një vepër të posaçme kundër "*Fusus el Hikam*", me titull "*Tanbih al-Ghabi ila Takfir Ibn Arabi*", duke e akuzuar për shpikje të rrezikshme. Në këtë libër, ai e akuzon Ibën Arabiun për mësime të papajtueshme me Islamin.[8]

Muhamed Nasiruddin al Albani (v. 1999) – E kritikonte fort sufizmin filozofik dhe Ibën Arabiun. Thoshte se "*Vahdetu'l-Vuxhud*" është një risi e rrezikshme që bie ndesh me teuhidin.[9]

Shejh Ibën Bazi (v. 1999, Arabia Saudite) – Ish-myfti i përgjithshëm i Arabisë Saudite. Ai ka thënë se shumë shprehje të Ibën Arabiut janë kufër i hapur dhe paralajmëroi myslimanët të qëndrojnë larg librave të tij.[10]

Shejh Salih el Feyzan (Arabia Saudite) – Shumë kritik ndaj sufizmit metafizik. Thoshte se "*Vahdetu'l-Vuxhud*" është panteizëm i maskuar dhe nuk ka lidhje me Islamin e pastër.[11]

QASJET E KUJDESSHME

Ka dijetarë që nuk e kanë mohuar madhështinë e mendimit të tij, por kanë këshilluar që shkrimet e tij të lexohen vetëm nga njerëz të thelluar në dijet islame, pasi gjuhën e tij mistike mund ta keqkuptojnë masat.

Imam Neveviu (v. 1277) – Nuk dha gjykim të prerë për Ibën Arabiun. Ai tha se gjykimi mbi të dhe shkrimet e tij i takon Allahut, por këshilloi që masat të mos merren me shkrimet e tij për të shmangur keqkuptimet. Shprehja e tij që nuk jep gjykim përfundimtar është transmetuar nga disa biografë, si në "*Al-Durar al-Kamina*" të Ibën Haxherit dhe në burime të tjera të biografive sufij. Ai është shprehur se nuk ka të drejtë kushdo të gjykojë mbi të; çështjen e tij ia lëmë Allahut.[12]

Takiuddin es Subki (v. 1355) – Shprehu respekt për të, por tha se disa nga librat e tij përmbajnë gjëra që nuk duhet lexuar nga kushdo. Komentet e tij gjenden në "*Tabaqat al-Shafi'iyya al-Kubra*", vëll. 8. Ai thotë se Ibën Arabiu është

një dijetar i madh, por disa nga librat e tij nuk duhen lexuar nga masat.[13]

Shejh Ramadan al Buti (v. 2013, Siri) – I mbrojti sufitë dhe tha se shprehjet e tyre duhet të lexohen si gjuhë metaforike, jo të drejtpërdrejta. Ai shpjegonte se "*Vahdetu'l-Vuxhud*" nuk barazon Allahun me krijesat, por thekson se gjithçka ekziston përmes Tij.[14]

Disa profesorë bashkëkohore të studimeve islame (në Turqi, Marok, Bosnje, madje edhe në Perëndim) e trajtojnë Ibën Arabiun si figurë filozofike dhe poetike, pa dhënë gjykim fetar të prerë.

Ata thonë se vepra e tij është një letërsi mistike, që pasqyron një mënyrë për të kuptuar marrëdhënien njeri-Zot, por nuk është domosdoshmërisht "akide" për masat.

STUDIME MODERNE DHE AKADEMIKE

Henry Corbin (1903-1978) – Filozof francez, themelues i shkollës së studimeve të imagjinatës sufike. Në librin "*Creative Imagination in the Sufism of Ibn 'Arabi*" (1969), Corbin thotë: "Bota e imagjinatës tek Ibën Arabiu nuk është iluzion apo fantazi, por një realitet ontologjik i ndërmjetëm, një *mundus imaginalis*, ku shfaqen format shpirtërore dhe ku njeriu përjeton vizionin e të padukshmes." Ai e konsideron Ibën Arabiun si "një filozof të pejgamberëve": "Në Ibën Arabiun ne gjejmë një filozofi profetike, e cila nuk është spekulative në kuptimin racionalist, por një hermeneutikë e shpalljes hyjnore."[15]

William Chittick (1943 –) – Është një ndër studiuesit më të mëdhenj bashkëkohorë të Ibën Arabiut. Chittick ka një vlerësim shumë të lartë dhe pozitiv për Ibën Arabiun, duke e konsideruar një nga mendimtarët më të thellë dhe më të keqkuptuar të historisë islame. Ai e interpreton Ibën Arabiun si një mendimtar sistematik, teologjikisht ortodoks në kuptimin e traditës sufike, dhe thelbësor për historinë e mendimit islam, duke kundërshtuar leximet reduktuese ose polemike të veprës së tij.

Chittick e konsideron Ibën Arabiun si një nga figurat më të rëndësishme të historisë së mendimit islam. "Ibën Arabiu është një nga mendimtarët më të mëdhenj myslimanë dhe, pa dyshim, sufiu më me ndikim në histori."[16] Ai thekson se veprat e Ibën Arabiut përbëjnë një sistem të plotë metafizik, jo reflektime fragmentare mistike. Ai e kundërshton fort idenë se Ibën Arabiu predikonte "panteizëm" dhe pohonte se interpretimi i tij si panteist është metodologjikisht i pasaktë. "Ta quash Ibën Arabiun panteist do të thotë të keqkuptosh plotësisht atë që ai nënkupton me termin qenie' (*vujud*)."[17]

Sipas Chittick, doktrina e tij e njohur si "*Vahdat al-Vujud*" (Njësia e Qenies) shpesh është keqinterpretuar. Nuk do të thotë se "Zoti është gjithçka", por se vetëm Zoti ka Qenie të vërtetë, ndërsa krijimi ekziston si shfaqje e Tij. Ai argumenton se "*Vahdat al-Vujud*" duhet kuptuar si ontologji teocentrike, ku Qenia absolute i përket vetëm Zotit, ndërsa bota ka një ekzistencë të varur dhe relative. "Qenia i përket vetëm Zotit, ndërsa kozmosi e zotëron ekzistencën vetëm në mënyrë metaforike."[18]

Ai thekson se gjuha simbolike dhe metaforike e Ibën Arabiut kërkon lexim të kujdesshëm, jo gjykim sipërfaqësor dhe se gjuha simbolike që ai përdor është pjesë e diskursit klasik sufik, jo devijim doktrinar. "Gjuha e Ibën Arabiut është simbolike, jo sepse është e paqartë, por sepse vetë realiteti nuk mund të kuptohet në mënyrë fjalë për fjalë."[19]

"Gjuha e Ibën Arabiut është simbolike, jo sepse është e paqartë, por sepse vetë realiteti nuk mund të kuptohet në mënyrë fjalë për fjalë."

Sipas Chittick, Ibën Arabiu ndihmon për të kuptuar dimensionin e brendshëm (*batin*) të Islamit dhe rolin e njohjes shpirtërore (*ma'rifa*) krahas ligjit fetar. Ai thekson se Ibën Arabiu përdor një hermeneutikë shumë-shtresore, ku njohja racionale plotësohet nga njohja intuitive (*ma'rifa*). Për këtë arsye, tekstet e tij kërkojnë një qasje interpretative që merr parasysh dimensionin metaforik dhe imagjinal të gjuhës.

Pra, sipas William Chittick, Ibën Arabi është një gjeni shpirtëror dhe intelektual, i keqkuptuar nga kritikët, dhe një figurë kyçe për të kuptuar thellësinë filozofike dhe mistike të Islamit.

Annemarie Schimmel (1922-2003) – Në veprën *Dimensionet mistike të Islamit*, Schimmel paraqet një vlerësim akademik shumë të ekuilibruar dhe thellësisht pozitiv për Ibën Arabiun, duke e vendosur atë në një pozitë ndërmjet filozofisë racionale dhe përvojës mistike, pa e reduktuar në asnjërën prej tyre.

Schimmel argumenton se Ibën Arabiu nuk është filozof në kuptimin aristotelian, por as mistik emocional apo irracional. "Ibën Arabiu nuk është filozof në kuptimin racionalist të fjalës, por një mistik vizionar, mendimi i të cilit ka një thellësi spekulative të jashtëzakonshme."[20] Ajo e sheh atë si figurë "ndërmjetëse" mes filozofisë dhe misticizmit. Ai përfaqëson një formë unike të mendimit metafizik mistik, ku përvoja shpirtërore shprehet përmes një gjuhe konceptuale shumë të sofistikuar. Për Schimmel, madhështia e Ibën Arabiut qëndron pikërisht në këtë bashkim të mendimit spekulativ me përvojën mistike.

Schimmel paralajmëron se Ibën Arabiu nuk mund të kuptohet saktë vetëm me mjete filozofike apo racionale. "Sistemi i Ibën Arabiut nuk mund të kuptohet si filozofi në kuptimin teknik, sepse ai buron nga përvoja mistike dhe jo nga arsyetimi logjik."[21] Ajo thekson se shumë keqkuptime (sidomos rreth *vahdat al-vujud*) vijnë nga përpjekja për ta lexuar atë si sistem filozofik të mbyllur. Sipas saj, gjuha e Ibën Arabiut është simbolike, vizionare dhe poetike, e lidhur drejtpërdrejt me përvojën shpirtërore.

Schimmel i kushton vëmendje të veçantë imagjinatës krijuese (*'alam al-khayal*), duke e parë atë si çelës për ta kuptuar botën shpirtërore të Ibën Arabiut. Ajo e konsideron simbolizmin e tij si mjet njohjeje, jo thjesht zbukurim letrar. "Gjuha e Ibën Arabiut është thellësisht simbolike: ajo synon të shprehë përvoja të realitetit hyjnor që nuk mund të kapen nga gjuha konceptuale."[22] Kjo e afron Ibën Arabiun me traditat e mëdha mistike botërore, pa e nxjerrë jashtë kornizës islame.

Ndryshe nga qasjet polemike, Schimmel e paraqet *vahdat al-vujud* si një vizion mistik të realitetit, jo një doktrinë filozofike të ngurtë, dhe as një formë panteizmi. "Doktrina e ashtuquajtur e 'njësisë së qenies' nuk është një sistem filozofik, por shprehje e përvojës mistike të unitetit të realitetit."[23] Ajo thekson se ky koncept duhet kuptuar nga brenda përvojës mistike, jo si formulë abstrakte. Për Schimmel, Ibën Arabiu përfaqëson kulmin e zhvillimit intelektual dhe shpirtëror të sufizmit klasik, duke ushtruar ndikim të jashtëzakonshëm në mistikën islame, letërsinë persiane dhe atë osmane, si dhe në mendimin fetar të mëvonshëm. "Me Ibën Arabiun, mendimi sufist arrin një kulm të rrallë, ku përvoja shpirtërore dhe reflektimi metafizik bashkohen në mënyrë të pandashme."[24]

Pra, Annemarie Schimmel e sheh Ibën Arabiun si një mendimtar mistik me thellësi filozofike, i cili nuk mund të klasifikohet ngushtë si filozof apo si mistik, por duhet kuptuar si një figurë që bashkon përvojën shpirtërore me reflektimin metafizik. Ajo mbron një lexim hermeneutik, simbolik dhe historikisht të ndjeshëm të veprës së tij.[25]

PËRFUNDIMI

Një mysliman i zakonshëm mund të lexojë për Ibën Arabiun dhe idetë e tij, mund të respektojë dijeninë dhe urtësinë e tij, por nuk duhet ta ndjekë verbërisht apo ta marrë çdo shprehje si të pakundërshtueshme. Ai duhet ta ruajë neutralitetin dhe nuk duhet të gjykojë nëse Ibën Arabiu ka qenë i drejtë ose jo në thellësinë mistike. Gjykimi mbi dijetarët e mëdhenj shpirtërorë i takon vetëm Allahut.

---

1 Al-Suyuṭi, Jalal al-Din, Tanbih al-Ghabi bi-Tabri'at Ibn 'Arabi, Cairo: Dar al-'Ilm wa al-Thaqafa, 1995.

2 Al-Jili, ʿAbd al-Karim, *Al-Insan al-Kamil fi Ma'rifat al-Awakhir wa al-Awa'il,* Dar al-Kutub al-ʿIlmiyya, 1997.

3 Shah Waliullah Dehlawi, *Ḥujjat Allah al-Baligha — The Conclusive Argument from God,* Beirut, Liban — Editor Seyyed Sabq, Daabacaad Dar al-Jayl, 1762.

4 Maḥmud, ʿAbd al-Ḥalim, *Al-Tafkir al-falsafi fi al-Islam,* Cairo: Maktabat al-Anjlo al-Miṣriyya, 1964.

5 Taqi ad-Din Ibn Tejmijja, *Majmuʿ al-Fatawa (The Great Compilation of Fatawa)* – Beirut, Liban: Dar al-Kotob al-ʿIlmiyah, 2000.

6 Ibn Hajar al-Asqalani*, Lisan al-Mizan*, vëll. 4. Bejrut: Mu'assasat al-A'lami lil-Maṭbuʿat, 1971.

7 *Fusus el-Hikam* ("Thelbet e Urtësive") është një libër i shkurtër i Ibn Arabiut, por me ndikim shumë të fuqishëm.

8 Burhan al-Din al-Bikai, *Masra al-Tasawwuf aw Tanbih al-Ghabi ila Takfīr Ibn ʿArabi*, Cairo, 1953.

9 AlAlbani, Muhammad Nasiruddin, *tab alTawḥid: Risalat Kalimat alIkhlaṣ wa Taḥqiq Maʿnaha*.Riyad: Dar alQasim LilNashr wa alTawziʿ, 2019.

10 Ibn Baz, Abd alAziz, *Baʿḍ Mukhalafat alṢufiyya wa Bayan Ḥal Ibn ʿArabi*, Fetva e publikuar në faqen zyrtare të fetvave të ibnbaz.org.sa, Arabia Saudite.

11 AlFawzan, Ṣaliḥ ibn Fawzan, *AqidatutTawhid: The Creed of Monotheism,* Riyad: Dar Makkah International Publishing, 2012.

12 Nawawi, Yahya ibn Sharaf, *Riyaḍ aṣṢaliḥin,* Damascus: alMaktaba alʿArabiyya, 2009.

13 AlSubki, Taj alDin Abd alWahhab ibn Ali, *Ṭabaqat alShafiʿiyya alKubra,* edited by Maḥmud Muḥammad alṬanaḥi and Abd al-Fattaḥ Muḥammad alḤilw. Cairo: Dar alKutub alIlmiyya, 1992.

14 AlButi, Muhammad Said Ramadan, *AlHikam alAta'iyya: Sharḥ waTahlil,* Damask / Beirut: Dar alFikr alMuʿaṣir, 2000.

15 Henry Corbin – *Creative Imagination in the Sufism of Ibn Arabi,* Princeton University Press, 1969, f.46.

16 William Chittick – *The Sufi Path of Knowledge: Ibn al-Arabi's Metaphysics of Imagination*, SUNY Press, 1989, f. 3.

17 Po aty, f. 79.

18 Po aty, f. 90.

19 William C. Chittick, *Imaginal Worlds: Ibn al-ʿArabi and the Problem of Religious Diversity,* State University of New York Press, 1994, f. 7.

20 Annemarie Schimmel, *Mystical Dimensions of Islam*, Chapel Hill: University of North Carolina Press, 1975, f. 263

21 Schimmel, f. 264-265.

22 Schimmel, f. 266.

23 Schimmel, f. 268.

24 Schimmel. f. 270.

25 Vepra të tjera të rëndësishme në lidhje me Ibën Arabiun kanë shkruar edhe studiuesit bashkëkohorë: Claude Addas – *Quest for the Red Sulphur: The Life of Ibn 'Arabi,* Islamic Texts Society, 1993; dhe Michel Chodkiewicz – *Seal of the Saints: Prophethood and Sainthood in the Doctrine of Ibn 'Arabi,* Islamic Texts Society, 1993.

Ezani – thirje universale në poezitë e Mehmet Akif Ersojit – Pejanit

Dr. Selim Selimi

Mehmet Akif Ersoji[1] lindi në një periudhë të vështirë ekonomike, politike dhe kulturore për shoqërinë, Perandorinë Osmane dhe qytetërimin, të cilit i përkiste edhe ai. Duke qenë një person aktiv dhe i ndjeshëm ndaj problemeve të shoqërisë, padyshim që këto elemente do të ndikojnë thellësisht në jetesën, në formimin intelektual, për pasojë dhe në poezinë e tij.

Para se ta trajtojmë ezanin te poezitë e Mehmet Akif Ersojit, le të hedhim një sy mbi shkrimet e tij. Ai ka nisur të shkruajë që në moshën dymbëdhjetë vjeçare dhe poezitë e tij janë botuar në revista të ndryshme, që kur ai ishte në shkollë. Një pjesë e mirë e shkrimeve të tij u botuan në revista të ndryshme si "*Resimli Gazete*", "*Serveti Fünun*", e që nuk janë brenda Safahatit (Fletët). Mendimet e tij politike kryesisht janë në formën e shkrimeve, kritikave, apo dhe përkthimeve të ndryshme, të botuara në revistat "*Sırat-ı Müstakim*" dhe "*Sebilü'r-Reşad*" në të cilat ka qenë aktiv.[2] Vepra më kryesore e tij "*Safahati*" përbëhet nga shtatë libra të botuara veç kur ishte ai gjallë dhe të përmbledhura në një vëllim të vetëm pas vdekjes së tij.[3] Përveç anës poetike, Mehmet Akif Ersoji, ka qenë shumë frytdhënës edhe në shumë fusha të tjera duke lënë pas një korpus të larmishëm shkrime.[4] Po të vihet re familja e Mehmet Akifit[5] është një shembull tipik i shoqërisë osmane; babai i tij vjen nga perëndimi Peja e Kosovës, nëna nga lindja Buharaja, që jetojnë në metropolin e botës, në Stamboll. Këtë aspekt e thekson dhe njëri ndër poetët më të mëdhenj turq Sezai Karakoç, i cili shprehet që, si në anën biologjike, ashtu dhe në atë intelektuale, Mehmet Akif Ersoji përbën një sintezë mes Lindjes dhe Perëndimit.

Po të vihet re familja e Mehmet Akifit është një shembull tipik i shoqërisë osmane; babai i tij vjen nga perëndimi Peja e Kosovës, nëna nga lindja Buharaja, që jetojnë në metropolin e botës, në Stamboll.

Ai kishte mbaruar shkollën e veterinarisë, por gjatë jetës së tij, përveç shkrimit do të ushtrojë punë e detyra të ndryshme si: mësues i gjuhës turke, punonjës i shtetit, mësues letërsie, deputet, pjesëmarrës në luftë, drejtues fetar, shkrues, pjesëmarrës dhe drejtues në organizata të ndryshme etj.. Ai ka udhëtuar si



i ngarkuar nga shteti në vende të ndryshme të botës, si: Gjermani, Egjipt, Liban, Arabi, Shqipëri etj..[6]

Tematika e shkrimeve të tij është e lidhur ngushtë me sistemin e mendimit të tij dhe me problematikat e shoqërisë. Pikërisht këtu fshihet dhe një lidhje emocionale mes lexuesit shqiptar dhe Mehmet Akif Ersojit. Ai e shpreh në këtë mënyrë shqetësimin për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej atdheu në përgjithësi e Shqipëria në veçanti.

Üç beyinsiz kafanın derdine, üç milyon halk ...

*"Për shkak të hallit të tre të patruve, një popull tre milion***ë,**

Pa shih si grihet! Ngrihu, baba (ati im) nga varri ku po pushon!

Të gjallët s'vrapuan në ndihmë, të paktën ti u shko…

Shqipëria digjet… Dhe, kësaj radhe, për tmerr!"[7]

Po në librin e katërt të "*Safahatit*" ai jep shembullin e shqiptarëve për tragjedinë që përjetonte shoqëria e kohës së tij:

"Ndërsa keni për shembull shqiptarët, ç'është ende,

Kjo politikë e ngatërruar, kjo çështje pa kuptim?

Më duket se biri juaj nuk e njeh rrugën kah kalon…

*Përz***ëjeni***, më në fund, hajdutin që ju udhëzon!*

Dëgjomëni mua që po, jam shqiptar….

S'kam tjetër ç'them… Vendi im i mjerë!…"[8]

"Ndërsa keni për shembull shqiptarët, ç'është ende,

Kjo politikë e ngatërruar, kjo çështje pa kuptim?

Më duket se biri juaj nuk e njeh rrugën kah kalon…

Përzëjeni, më në fund, hajdutin që ju udhëzon!

Dëgjomëni mua që po, jam shqiptar….

S'kam tjetër ç'them… Vendi im i mjerë!…"

Sa i përket ezanit, në poezitë e Mehmet Akifit në dimensionin universal, në kulturën myslimane ka një vend të rëndësishëm ku u trajtua si temë në letërsi turke, duke u bërë objekt i gjinisë letrare. Sidomos pas Tanzimatit, ezani në letërsinë turke u bë një nga burimet më të rëndësishme të frymëzimit për shumë shkrimtarë dhe poetë, ndër ta përmendim: Mehmet Akifit, Jahya Kemalit, Ziya Gökalp, Arif Nihat Asya, Necip Fazıl, etj.. Kjo thirrje ndikoi në mënyra të ndryshme në botën shpirtërore dhe mendore të këtyre poetëve.[9] Ndërsa sipas dy poetët më të njohur (fuqishëm) të shekullit XX, Mehmet Akifi Ersojit (pejani) dhe Jahja Kemal Bejatli (shkupjani), ezani nuk llogaritej vetëm një ritual fetar, mirëpo te këta dy poetë, në të njëjtën kohë është bërë një fenomen kombëtar, por edhe një simbol i pavarësisë.

Përgjatë katërmbëdhjetë shekujve të historisë islame ezani është i rëndësishëm në kulturën e popujve myslimane. Ezani nuk është vetëm një thirrje për adhurim, mirëpo edhe një thirrje fetare dhe kombëtare, është tingulli më konciz i muzikës, këndohet në mekame të ndryshme në përputhje me shpirtin e myslimanëve dhe ai ka ndikuar në botën shpirtërore të shumë njerëzve. Ezani është dhe ka qenë temë e shumë zhanreve letrare, një nga burimet frymëzues të poetëve, shkrimtarëve në letërsinë turke e më gjerë.

Mendimet e poetëve dhe shkrimtarëve turk për ezanin, në përgjithësi kanë një qasje pozitive dhe asnjëri prej tyre nuk mbeti indiferent, nuk e injoroi ezanin.[10] Poetët si: Mehmet Akifi e shkroi poezinë "*Ezanlar*", Jahja Kemal "*Ezani Muhamed*", ndërsa Ahmet Hashim "*Musliman saati*", Mithat Cemal Kuntay "*Bir Ezan Sesi*", Aka Gündüz "*Ezan Vakitleri*", si dhe Arif Nihat Asya "*Dua*". Në poezitë e këtyre shihet qartë një ndikim i ezanit në mënyra të ndryshme edhe në botët shpirtërore të tyre (poetëve).[11] Mirëpo në mesin e këtyre poetëve, Mehmet Akifi, ezanit dhe Islamit i jep një rëndësi dhe vend të veçantë. Në "*Himnin e Pavarësisë*" thuhet:

"Ruhumun senden, İlâhî, şudur ancak emeli:[12]

"Vetëm për një gjë të lutet shpirti im, o Zot, me shpresë:

Në gjoks të këtij tempulli dora e huaj mos të prekë!

Këto ezane me dëshmitë e tyre në themel të fesë,

Mbi tokën e atdheut tim të jetojnë përjetë!"

Mehmet Akifi, në poemën "*Ezanlar*" (ezanët), përmend se, në rruzullin tokësor, nuk ka kohë pa ezan.[13] E gjithë koha dhe vendi i ezanit është zëri më i fortë që dominon në univers së madhëruari Zotin. Për shkak të dallimeve në kohën e lindjes së diellit, nuk ka kohë pa ezan në botë. Në poemën "*Ezanlar*" gjithashtu thuhet:

Ezanlar

Duke u lartësuar nga toka, Zotin ve Vetëm kërkon qiejve,

Të mos e shtangë të mahnitur ndërgjegjen një thirrje.

"Allahu Ekber!" ç 'apoteozë hyjnore e trondit shpirtin...

Është shpallje e së Vërtetës, tepër nëse e rënkon gjithësinë?...

Nuk kalon çast pa u reflektuar emri yt dimensioneve,

O Zot, ç'bretërim madhështor, çsundim absolut i qetë!

Ezanët, këndimet, apoteozat janë respekt për atë sundim...

Jo, ti je shpirti i mëshirës, zërat nga Ti lusin drejtësi;

A do të jepje mundësi ankese po të mos tregoje drejtësi?

Sipas Akifit, ezani tregon madhështinë e Allahut. Ezani i drekës-ikindisë, freskon zemrat e lodhura nga nxitimi për të siguruar jetesën. Ezani i mbrëmjes dhe i natës është dhuratë e Allahut për botën e heshtur dhe të errët. Ezani i kënduar nga minaret i ngjason apo është si suri i Israfilit, rinovon zemrat dhe i sjell vitalitet universit:

Në poezinë "*Hakkin Sesleri*" (Zërat e hakut të vërtetave), poeti përshkruan mizoritë e kryera gjatë luftërave ballkanike.

Ezanlar sustu... Çanlar inletip durmakta afaki. (ufuklari)

Yazık: Şark'ın semasından Hilal'in geçti işrakı! [14](parlama zamani)

"Ezanët heshtën ... kambanat i gjëmuan horizontet tej e tej!

Aj me sa keq, lindja e hënës kaloi nga qielli i Lindjes për atje!"

Në poezinë "Fatih Kürsüsünden"[15](Nga kursia e Fatihut (xhamia)", (hatipi) predikuesi me këshillat e tij mundohej të shërojë plagët e botës islame me myzhdenë e tingullit "Allahu Ekber" në ezan.

Yarınca kubbeyi ''Allahu ekber"! ikrarı, ...

"Kur zërat "Allahu Ekber" duke e çarë kubenë u ngritën lart,

U zbraz për tokë si shiu të fshehtat e hakut.[16]

Kjo xhami katër minaresh që s'kishte ngjarë,

Që i shkëlqente dielli i artit në hënën e re."

Në poezinë "Umar mıydın? (A keni menduar?), përmend shtypjen (zullumin) e komunistëve në Rusi dhe se si ata e ndaluan ezanin dhe adhurimin e Zotit xh.sh..

Ai me dëshpërim thotë:

Umar mıydın ki: Mabedler, ibadetler yetim olsun

Ezanlar arkasından ağlasın bir nesl-i me'yusun[17]

"A mendoje se faltoret kanë për të mbetur jetimë,

Se një brez i pashpresë do të qajë pas ezanëve ?

Nuk mund të duartrokas shtypjen (zullumin),

Nuk mund ta dua kurrë shtypësin,

Nuk mund t'u kthehem e të mallkoj për kënaqësinë e njërit të kaluarën."

Ajo çka mund ta kënaq secilin shqiptar, e veçanërisht intelektualin, është fakti se Mehmet Akif Ersoji në Turqi sot konsiderohet patriot, poet, njeri i devotshëm, por mbi të gjitha vlerë kombëtare turke. Mirëpo, në secilën biografi të tij qartë potencohet origjina e tij etnike (shqiptar).

Po t'i hedhim një sy dhe të shohim të gjithë shqiptarët në Perandorinë Osmane dhe ndikimin që kanë pasur ata, padyshim që njëri prej tyre me tepër që ka bërë emër është Mehmet Akif Ersoji. Ai njihej si i aftë në shumë fusha, si besimtar i mirë, dijetar, akademik, poet, shkrimtar, politikan, pedagog, deputet etj.. Vështirë se mund të gjendet një njeri me ndikim kaq të madh në mendjen e turqve në shekullin XX, aq sa janë ndikuar nga idetë e Mehmet Akif Ersoji. Për atë edhe e quajnë "*Vatan Şairi*" – Poet i Atdheut, "*Milli Şair*" – Poeti Kombëtar.

---

1 Ersoy, Mehmet Akif, Safahat, AkvaryumYayınevi, İstanbul 2006, s. XIII; Për të dhëna më të detajuara rreth jetës, shkrimeve dhe veprimtarisë së Mehmet Akif Ersojit shiko dhe përkthimin shqip të "Safahatit": Ersoj, Mehmet Akif, Fletët, Përkth. Mithat Hoxha, Logos-A, Shkup, 2006.

2 Erol, Murat, "Sath-ı Vatan ya da Mehmet Akıf Ersoy'un Makaleleri", Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:182.

3 Okay, M. Orhan, Düzdağ, M. Ertuğrul, "Mehmet Akif Ersoy Maddesi", TDV Islam Ansiklopedisi, C. XXVIII, Ankara, s. 433.

4 Okay, Düzdağ, s. 436.

5 Ersoy, Mehmet Akif, Safahat, AkvaryumYayınevi, İstanbul 2006, s. XIII; Për të dhëna më të detajuara rreth jetës, shkrimeve dhe veprimtarisë së Mehmet Akif Ersojit shiko dhe përkthimin shqip të "Safahatit": Ersoj, Mehmet Akif, Fletët, Përkth. Mithat Hoxha, Logos-A, Shkup, 2006, 66.

6 Për të dhëna më të detajuara rreth jetës së Mehmet Akifit shiko: Kara, Mustafa, İstiklalimizin Bülbülü Mehmet Akif Ersoy, Özal Matbaası, İstanbul 2012:11-39.

7 Ersoj, f. 281.

8 Ersoj, f. 284.

9 Özdenören, Rasim, "Müslüman Bir Düşünür Olarak Mehmet Akif'in Çelişkileri", Karakter Abidesi ve Bir Çığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008:73.

10 (Orhan Veli, "Ezan", *Yaprak*, 15 Temmuz 1950).

11 Mithat Cemal, *Mehmet Âkif*, Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, Ankara 1990, s. 345.

12 Mehmet Âkif Ersoy, *Safahat*, 6. bs., (hzl. M. Ertuğrul Düzdağ), Çağrı Yayınları, İstanbul, 2008, s. 91.

13 Age. S. 184.

14 Age. S. 252.

15 Ayçil, Ali, "Dördüncü Kitap (Fatih Kürsüsünde) İçin Dolaylı Bir Şerh", Karakter Abidesi ve BirÇığlık Olarak Mehmet Akif Özel Sayısı, Hece Dergisi, Sy. 133, Ankara 2008.

16 Age. S. 287.

17 Age. S. 476.

Personalitete të njohura të kohës moderne, të cilët përqafuan Islamin

Jasir Memaj

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë vetëm Allahut, Krijuesit të gjithësisë! Përshëndetjet dhe selamet tona ia drejtojmë më të zgjedhurit të Allahut, Muhamedit a.s., familjes dhe shokëve të tij dhe të gjithë atyre që e pasojnë rrugën e ndritshme islame deri në Ditën e Gjykimit.

Sot, të gjithë mund ta shohim dhe të biem në ujdi për të vërtetat që na tregon Allahu xh.sh. nëpërmjet Kuranit të Madhërishëm. Si shkak i këtyre të vërtetave po shtohet çdoherë numri i myslimanëve kudo nëpër botë. Që prej se është shfaqur feja islame, ajo ka treguar një ndikim të rëndësishëm në jetën shpirtërore, shoqërore dhe kulturore në jetën njerëzore.

Në këtë periudhë të kohës bashkëkohore moderne, Islami vazhdon të tërheqë afër vetes zemrat e shumë njerëzve, vëmendjen e tyre qofshin nga vende, kultura apo profesione të ndryshme, duke përfshirë personalitete të njohura bashkëkohore të fushave të ndryshme, si: shkenca, sportet, filozofia, mjekësia, arti dhe politika. Përqafimi i Islamit nga këto personalitete të njohura përbën një temë me rëndësi të veçantë, pasi lidhet me faktorë të ndryshëm fetarë, shoqërorë, intelektualë dhe kulturorë, që ndikojnë në procesin e konvertimit në fenë islame.

Ky punim synon të trajtojë disa nga personalitetet moderne të shekullit XXI, që kanë përqafuar Islamin, duke marrë parasysh arsyet, rrethanat dhe ndikimin e këtij vendimi në jetën dhe veprimtarinë e tyre publike.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në kuptimin dhe paraqitjen e motivimeve personale dhe faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e besimit fetar në shoqërinë bashkëkohore moderne, duke kontribuar në literatura të ndryshme si p.sh., në dialogun ndërfetar, identitetin fetar dhe transformimin shpirtëror. Përmes një qasje përshkruese, punimi synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi këtë fenomen dhe rëndësinë e tij në studimet bashkëkohore fetare.

NË FUSHËN E MJEKËSISË

Dr. Henry Klassen është ndihmës profesor në Institutin e Syrit "*Gavin Herbert*", Shkolla e Mjekësisë UC Irvine. Ai është hetuesi kryesor i një bashkëpunimi shumë universitar, që studion rindërtimin e retinës duke përdorur qeliza staminale.[1]

Hulumtimi afatgjatë i dr. Klassen përqendrohet në përdorimin e strategjive rigjeneruese për t'i trajtuar sëmundjet e retinës, nervit optik dhe epitelit të pigmentuar të retinës, shtresës së qelizave të pigmentuara pranë retinës që ushqen qelizat vizuale të retinës. Dr. Klassen dhe ekipi i tij po studiojnë mënyra për të rigjeneruar qelizat përmes transplantimit të qelizave staminale dhe inxhinierisë së indeve. Ekipi i tij po heton gjithashtu mjete për ta mbrojtur retinën dhe nervin optik nga dëmtimi.

Dr. Henry Klassen përfundoi stazhin e tij mjekësor në Spitalin e Kembrixhit, një degë e Shkollës Mjekësore të Harvardit, dhe specializimin në oftalmologji në Qendrën e Syrit "*Yale*". Ai mori doktoratën e tij në neuroshkencë në Universitetin e Pitsburgut.

Më pas, ai përfundoi një bursë të kombinuar në Londër, e cila përfshinte retinë mjekësore me prof. Alan Bird në Spitalin e Syrit "*Moorfields*" dhe kërkime me prof. Ray Lund në

Institutin e Oftalmologjisë. Pas bursës, ai ishte drejtor i Kërkimeve të Qelizave Staminale në Spitalin e Fëmijëve të Qarkut Orange, e më pas u transferua në Institutin e Kërkimeve të Syrit të Singaporit, përpara se të rekrutohej në Departamentin e Oftalmologjisë në Universitetin e Kalifornisë, Irvine, ku tani është drejtor i Programit të Rigjenerimit të Qelizave Staminale dhe Retinës.[2]

Profesori Henry Klassen u konvertua në Islam dhe u emërua Abdul Haq, duke simbolizuar përkushtimin e tij ndaj të vërtetës dhe dijes.[3]

Udhëtimi i tij drejt Islamit pasqyron një lidhje më të thellë me besimin dhe një ndjenjë të re qëllimi. I frymëzuar nga qëndrueshmëria e popullit të Gazës, profesor Klassen, i njohur për punën e tij inovative në kërkimin e qelizave staminale dhe rindërtimin e retinës, iu nënshtrua një transformimi të thellë shpirtëror.

SHKENCAT HAPËSINORE

Dr. Atsushi Kamal Okuda, një shkencëtar i njohur japonez, është bërë një figurë e shquar në botën islame. Udhëtimi i tij nga ateizmi në Islam qëndron si një dëshmi e fuqishme e aftësisë transformuese të Kuranit për t'i prekur edhe mendjet më skeptike.

I lindur në Japoni, një vend i njohur për përparimet e tij teknologjike dhe shoqërinë kryesisht laike, dr. Okuda, u rrit në një mjedis ku feja luante një rol minimal. Duke shkëlqyer në fizikë, biologji dhe kozmologji, ai ia kushtoi jetën e tij zbulimit të mistereve të universit përmes shkencës. Megjithatë, pavarësisht arritjeve të tij, ai ndjeu një boshllëk të brendshëm. Teksa shkenca shpjegonte fenomenet natyrore, ajo dështoi t'u përgjigjej pyetjeve të thella ekzistenciale: Cili është qëllimi i jetës? Pse u krijuam? Ku qëndron e vërteta përfundimtare?

I shtyrë nga kurioziteti dhe jo nga besimi, dr. Okuda, filloi të eksploronte tekste fetare. Takimi i tij i parë me Kuranin shënoi një pikë kthese. Fillimisht skeptik, ai iu afrua tekstit me një shikim shkencor, duke kërkuar koherencë dhe logjikë. Për habinë e tij, ai zbuloi se Kurani ishte në përputhje me njohuritë shkencore moderne në mënyra të jashtëzakonshme. Vargjet e tij mbi krijimin e universit dhe zhvillimin e jetës kishin përputhje të thellë me kuptimin e tij shkencor.[4]

I shtyrë nga kurioziteti dhe jo nga besimi, dr. Okuda, filloi të eksploronte tekste fetare. Takimi i tij i parë me Kuranin shënoi një pikë kthese. Fillimisht skeptik, ai iu afrua tekstit me një shikim shkencor, duke kërkuar koherencë dhe logjikë.

Shpesh dëgjojmë nga ata që janë antifetarë pohimin se shkenca është e tëra çfarë u nevojitet dhe se Zoti dhe feja janë thjesht një mit dhe nuk mbështeten në prova.

Para Islamit, dr. Okuda, e shpjegoi jetën e tij si imorale dhe me mungesë njohurish për qëllimin e vërtetë të jetës. Ai tha: "Para Islamit, jeta ime ishte barbare. Shumë barbare! Injorante. Nuk e dija të vërtetën!"

Ai nisi një udhëtim në kërkim të së vërtetës, duke luftuar një betejë të gjatë akademike me fetë e ndryshme, derisa arriti në Islam dhe vendosi ta studionte atë siç duhet.

Gjatë vitit të gjashtë të kolegjit të tij, ai tregoi një interes të zjarrtë për legjislacionin islam. Një ditë, derisa ishte duke ecur, ai hasi në një punim kërkimor ku sytë e tij skanuan mbi një ajet, një varg nga Kurani që i ndryshoi jetën përgjithmonë.[5]

Ajeti ishte rreth asaj se si Allahu e krijoi njerëzimin nga rëra, balta dhe pluhuri. Një nga ajetet që flet për këtë është në suren e 15-të, ajeti i 26-të, ku Allahu thotë: *"Ne krijuam njeriun nga balta e argjilit, të zi e të prishur (me erë të keqe)? (të formuar-të trajtuar-mesnun)."*[6]

Ndërsa vazhdonte kërkimet e tij mbi Islamin, ai vendosi të shpërngulej në Alepo të Sirisë për të vazhduar studimet dhe madje për të mësuar arabisht. Gëzimi dhe lehtësimi i tij që u bë mysliman ishte një bekim si asnjë tjetër në jetën e tij. Ai tha: "Në atë moment, u konvertova në Islam. Besoj se kjo është dhurata më e madhe nga Allahu në jetën time!"

Ai theksoi edhe ajetin e 30-të të sures El Enbija: *"A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt dhe toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?"*[7]

Ai gjeti paralele të jashtëzakonshme midis këtij ajeti, teorisë së Big Bengut dhe kuptimit shkencor të ujit si bazë e jetës.[8]

Sot, dr. Okuda, është një frymëzim. Ai është një model jo vetëm për myslimanët japonezë, por për njerëzit në mbarë botën, si dhe për atë

që duhet bërë pasi të kesh gjetur të vërtetën për veten. Ai punon shumë për të ndarë dhuratën e Islamit me të tjerët.[9]

UDHËHEQËS SHPIRTËROR

Ibrahim Richmond, dikur i njohur si Abraham Richmond dhe një ish-prift i krishterë në Afrikën e Jugut, kohët e fundit ka përqafuar besimin islam dhe ka filluar një udhëtim të jashtëzakonshëm duke marrë pjesë në pelegrinazhin e tij të parë të haxhit, pasi ka marrë një ftesë nga Mbreti Saudit. Për gati 15 vjet, Richmond ia kushtoi jetën e tij priftërisë së krishterë. Megjithatë, një moment përcaktues në formën e një ëndrre të gjallë e ka ridrejtuar trajektoren e jetës së tij në një drejtim të paparashikuar.[10]

Të dielën, autoritetet saudite postuan një video tjetër të Richmondit në Twitter, në të cilën ai ndau përvojën që e çoi drejt pranimit të Islamit. Richmond pa se po "flinte në kishë në një dhomë shumë të vogël." Ai kujton: "Pastaj dëgjova një zë hyjnor, duke më thënë: thuaju burrave tu të veshin të bardha!" Në ditët në vijim, Richmond, e sheh këtë ëndërr vazhdimisht. "Çdoherë zëri bëhej më i fortë." Më pas, Richmond shkoi në kishë dhe u tregoi ndjekësve të tij për ëndrrën.[11]

Kulmi i udhëtimit të Richmond u shpalos para një kongregacioni prej afërsisht 2,500 deri në 2,600 anëtarësh, ndërsa ata recituan së bashku Shahadetin, duke dëshmuar publikisht kalimin e tyre në Islam. Kjo ngjarje vendimtare e forcoi kuptimin e Richmond për rëndësinë e ëndrrës dhe shënoi fillimin e rrugës së tij të ripërtërirë.

Ai, për ardhjen në pelegrinazh, tha: "Kur u ftova për herë të parë për ta kryer haxhin, nuk isha i sigurt. Mendova se nuk mund të shkoja. Por tani, jam këtu, duke ndjekur hapat e Pejgamberit Muhamed dhe miliona njerëz nga populli im do t'i ndjekin këto hapa për të parë dritën."[12]

Richmond foli për angazhimin e tij të palëkundur ndaj besimit të tij të rigjetur dhe vendosmërinë e tij për të ndjekur mësimet e Islamit, të frymëzuara nga jeta e Pejgamberit Muhamed dhe mësimet e Kuranit.

Dëshmia e tij nënvizoi unitetin dhe bukurinë që gjeti në Islam, ndërsa ndau lutje për një botë që përqafon mesazhin e paqes së fesë.[13]

PËRFUNDIMI

Nga analiza e realizuar në këtë punim rezulton se përqafimi i Islamit nga personalitete të njohura moderne përbën një fenomen kompleks, që lidhet me faktorë shpirtërorë, intelektualë, shoqërorë dhe kulturorë. Studimi tregon se ky proces i konvertimit (përqafimit) fetar nuk është një veprim i rastësishëm, por një proces me ndërgjegje të plotë, që shpesh lidhet me kërkimin e kuptimit të jetës së kësaj bote, identitetit shpirtëror dhe bindjes personale.

Nga kjo mund të evidentojmë se personalitetet e njohura që përqafuan Islamin kanë qenë të ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si reflektimi mbi besimin, ndikimi shoqëror, kontaktet me kultura të tjera dhe studimi i drejtpërdrejtë i mësimeve islame. Ky vendim ndikoi në formimin e identitetit të tyre dhe në veprimtarinë e tyre publike, duke ndikuar edhe në perceptimin e shoqërisë ndaj Islamit dhe dialogut ndërfetar.

Në përfundim, mund të themi se ky studim i personaliteteve moderne, që kanë përqafuar Islamin paraqet një fushë të rëndësishme kërkimi në studimet fetare dhe sociologjike, duke hapur rrugë për hulumtime të mëtejshme mbi motivet e konvertimit fetar, ndikimin e tij në shoqërinë bashkëkohore dhe rëndësinë e dialogut ndërfetar në botën bashkëkohore.

---

1 https://discoveryeye.org/henry-j-klassen-m-d-ph-d/
2 https://stemcell.uci.edu/People/Faculty/Introduce/henry_klassen.php
3 https://en.islamonweb.net/after-shaun-king-and-dr-henry-klassen-american-rapper-lil-jon-accepts-islam
4 https://www.islamicity.org/105648/japanese-scientist-converted-to-islam-from-one-quran-verse/
5 https://muslimcouncil.org.hk/the-inspiring-story-of-a-japanese-scientist-embraced-islam-due-to-one-verse/
6 Sherif Ahmeti, Përkthim me komentim i Kuranit Fisnik, shtb. Kompleksi i mbretit Fehd për shtypjen e Kuranit Fisnik. Medine, 1993.
7 Po aty,
8 https://en.abna24.com/news/1731067/Japanese-Scientist-Embraces-Islam-After-Finding-Inspiration-in
9 https://muslimcouncil.org.hk/the-inspiring-story-of-a-japanese-scientist-embraced-islam-due-to-one-verse/
10 https://ilkha.com/english/latest/south-african-priest-embraces-islam-after-dream-347323
11 https://www.islamestic.com/ibrahim-richmond-a-christian-priest-who-reverted-to-islam-performs-hajj-on-kings-invitation/
12 https://www.islamestic.com/ibrahim-richmond-a-christian-priest-who-reverted-to-islam-performs-hajj-on-kings-invitation/
13 https://ilkha.com/english/latest/south-african-priest-embraces-islam-after-dream-347323

Ndërlidhja ndërmjet hapësirës gjeografike dhe përhapjes së fesë islame – analizë shkencore

Faik Krasniqi

HYRJE

Ndërlidhja ndërmjet hapësirës gjeografike dhe përhapjes së fesë islame përbën një fushë studimi, ku shkencat shoqërore dhe ato natyrore takohen për të shpjeguar dinamika komplekse historike, kulturore dhe demografike. Gjeografia fetare, si disiplinë brenda gjeografisë kulturore, synon të analizojë rolin e hapësirës dhe mjedisit në formësimin e besimeve, në shpërndarjen e tyre dhe në krijimin e peizazheve fetare, që mbartin kuptime simbolike për komunitetet njerëzore.

Islami, si një nga fetë më të përhapura në botë, paraqet një rast të veçantë studimi në këtë kontekst. Shpërndarja e fesë nga një bërthamë fillestare në Gadishullin Arabik në shekullin VII, drejt tri kontinenteve brenda disa dekadave, e bën Islamin një fenomen të shpjegueshëm jo vetëm nga perspektiva teologjike, por edhe nga ajo gjeografike dhe historike. Rrugët tregtare, lëvizjet migratore, kontaktet ndërkulturore dhe faktorët politikë kanë qenë elemente kyçe, që kanë ndikuar në mënyrën dhe ritmin e përhapjes së Islamit.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë lidhjen ndërmjet hapësirës gjeografike dhe përhapjes së fesë islame, duke u fokusuar në faktorët hapësinorë, që kanë mundësuar shtrirjen e saj në rajone të ndryshme të botës. Përmes këtij këndvështrimi, punimi synon të theksojë se gjeografia nuk ka qenë thjesht një sfond pasiv, por një aktor aktiv në historinë e Islamit dhe në krijimin e hartës bashkëkohore të besimeve fetare.

Shpërndarja e fesë nga një bërthamë fillestare në Gadishullin Arabik në shekullin VII, drejt tri kontinenteve brenda disa dekadave, e bën Islamin një fenomen të shpjegueshëm jo vetëm nga perspektiva teologjike, por edhe nga ajo gjeografike dhe historike.

BAZAT TEORIKE TË GJEOGRAFISË FETARE

Gjeografia fetare është një nëndisiplinë e gjeografisë kulturore, që merret me studimin e marrëdhënies mes fesë dhe hapësirës.[1] Që nga gjysma e dytë e shekullit XX, studiuesit kanë theksuar se feja nuk është vetëm një fenomen shpirtëror apo dogmatik, por edhe një realitet hapësinor, i cili mund të matet, të vizualizohet dhe të analizohet. Ajo ndikon në mënyrën si njerëzit e organizojnë jetën e tyre në territor, si ndërtojnë qendrat e shenjta, si formojnë kufij kulturorë dhe si krijojnë identitete kolektive të lidhura me hapësirën.[2] Në këtë kuptim, gjeografia fetare ka tri shtylla themelore:

Shpërndarja hapësinore e besimeve: ku studimi fokusohet te mënyra se si komunitetet fetare janë të përhapura në hapësira të caktuara dhe pse disa rajone kanë përqendrim të lartë të një feje.

Peizazhi fetar: ku analiza merret me shenjat materiale dhe simbolike që feja lë mbi hapësirën, si xhamitë, kishat, manastiret, varrezat, monumentet e shenjta apo edhe toponimet me origjinë fetare.

Ndikimi i fesë mbi organizimin territorial dhe social: ku shqyrtohet mënyra se si feja ndikon në strukturën e qyteteve, në lidhjet tregtare, në migracion, si dhe në marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike e kulturore.[3]

Feja, përmes përhapjes së saj, krijon një hartë shpirtërore, që shpesh nuk përputhet plotësisht me hartën politike apo ekonomike. Ky dallim është i dukshëm sidomos tek Islami, i cili u përhap në territore shumë të ndryshme gjeografikish, nga shkretëtirat arabe deri në pyjet tropikale të Azisë Juglindore, duke krijuar një diversitet hapësinor unik.

Kjo qasje teorike na ndihmon të kuptojmë se përhapja e Islamit nuk ishte një proces linear, por një fenomen që ndërthuri faktorë natyrorë, ekonomikë dhe kulturorë, duke prodhuar modele të ndryshme të shpërndarjes në hapësira të ndryshme.

HAPËSIRA GJEOGRAFIKE DHE PËRHAPJA E FESË ISLAME NË HISTORI

Historia e Islamit është një shembull unik i ndërveprimit mes hapësirës dhe besimit fetar. Përhapja e tij nga një qendër e vogël në Gadishullin Arabik drejt tri kontinenteve brenda një periudhe të shkurtër historike, tregon fuqinë e faktorëve gjeografikë në formësimin e diskursit gjeografik, politik, historik dhe fetar.

Islami lindi në Mekë dhe Medinë, dy qytete të vendosura në një nyje të rëndësishme tregtare dhe pelegrinazhi. Pozita gjeografike e Gadishullit Arabik, si urë lidhëse midis Azisë, Afrikës dhe Mesdheut, e bëri atë një territor strategjik për përhapjen e ideve dhe besimeve të reja. Brenda pak dekadash pas vdekjes së Pejgamberit Muhamed a.s. (në vitin 632), Islami u shtri në tërë Arabinë.[4]

Pas konsolidimit në Arabi, Islami u përhap me shpejtësi përmes ekspansionit politik dhe ushtarak. Ai depërtoi në Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut, Persi dhe deri në Gadishullin Iberik në Perëndim, si dhe në Azinë Qendrore në Lindje. Rrugët tregtare dhe rrjetet urbane ishin elemente vendimtare që mundësuan këtë shtrirje. Qytete si Damasku, Bagdadi dhe Kordoba u shndërruan në qendra të fuqishme të dijes, kulturës dhe fesë islame.

Në këtë periudhë, Islami fitoi një karakter universal. Përveç përhapjes përmes pushtimeve, ai u përhap edhe përmes tregtisë, sidomos në Afrikën nën-Sahariane dhe Azinë Juglindore. Karvanët e Saharës, rrugët detare të Oqeanit Indian dhe lidhjet tregtare me Indinë dhe Kinën, u bënë faktorë gjeografikë, që mundësuan përhapjen paqësore të Islamit.[5] Në të njëjtën kohë, në Ballkan, përmes zgjerimit të Perandorisë Osmane, Islami u bë pjesë e rëndësishme e identitetit rajonal.

Në epokën moderne, Islami vazhdoi të përhapej përmes migrimit dhe globalizimit. Shpërndarja e tij nuk kufizohej më vetëm në territoret klasike, por depërtoi edhe në Amerikë, Evropën Perëndimore dhe Australi. Migracioni ekonomik dhe politik i myslimanëve gjatë shek. XIX–XX krijoi komunitete të reja islame në hapësira të ndryshme, duke ndryshuar hartën fetare botërore.[6] Sot, Islami është feja e dytë më e madhe në botë, me një shpërndarje gjeografike që prek pothuajse çdo kontinent.

Ky evolucion historik dëshmon se hapësira gjeografike, me faktorët e saj natyrorë, ekonomikë dhe politikë, ka qenë gjithmonë një determinant i fuqishëm në përhapjen e fesë islame.

FAKTORËT GJEOGRAFIKË QË NDIKUAN NË PËRHAPJEN E ISLAMIT

Përhapja e Islamit nuk ishte vetëm rezultat i ideve fetare dhe misionit shpirtëror, por edhe i kushteve gjeografike që e lehtësuan ose e ngadalësuan këtë proces. Faktorët gjeografikë kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e rrjeteve të komunikimit, në mënyrën e organizimit të shoqërisë dhe në krijimin e qendrave të fuqishme kulturore dhe fetare. Disa prej këtyre faktorëve kryesorë janë:

Pozita strategjike e Gadishullit Arabik: Arabia ndodhet në një nyje gjeografike mes Azisë, Afrikës dhe në përgjithësi me ndërlidhjen e saj me Evropën. Ky pozicion i dha Islamit mundësinë të depërtojë shpejt në drejtim të veriut, jugut dhe perëndimit, duke ndjekur rrugët ekzistuese të tregtisë dhe të migrimit.[7]

Rrugët tregtare dhe komunikimi: Rrugët e mëdha karvanore që lidhin Arabinë me Mesdheun, Persinë dhe Afrikën e Veriut, si dhe rrugët detare në Oqeanin Indian, krijuan një infrastrukturë natyrore për përhapjen e Islamit. Përmes këtyre rrugëve, përveç mallrave, qarkullonin edhe ide, kultura dhe besime.

Qendrat urbane dhe portet: Qytetet si Meka, Medina, Bagdadi, Damasku, Kajro, Kordoba, Delhi dhe më vonë Stambolli, u bënë qendra të rëndësishme të Islamit. Ato ishin pika takimi të tregtarëve, dijetarëve dhe pelegrinëve, duke shërbyer si vatra të përhapjes së besimit.

Në fillim të shekullit XXI, Islami është feja e dytë më e madhe në botë pas Krishterimit, me mbi 1.9 miliardë pasues, që përfaqësojnë rreth 25% të popullsisë globale.

Kushtet natyrore dhe mjedisore: Shkretëtirat e gjera të Arabisë i dhanë Islamit një karakter unik mbrojtjeje dhe izolimi fillestar, por njëkohësisht e detyruan të lidhej fort me rrugët tregtare. Po ashtu, lumenjtë si Tigri e Eufrati, dhe më vonë Nili, ndihmuan në krijimin e qendrave të lulëzuara islame.

Migrimet dhe kontaktet ndërkulturore: Migrimet e brendshme të arabëve, si dhe kontaktet me popuj të tjerë (persët, bizantinët, turqit, berberët, indianët), i dhanë Islamit një karakter transkulturor dhe e përhapën atë në territore shumë të ndryshme.

Haxhi si faktor gjeografik unik: Riti i haxhit, që lidhet me Mekën si qendër shpirtërore, krijoi një rrjet global lëvizjesh njerëzore. Pelegrinët që ktheheshin nga Meka sillnin me vete jo vetëm përvojën fetare, por edhe praktikat, dijen dhe kulturën islame në vendet e tyre të origjinës.

Këta faktorë tregojnë se përhapja e Islamit nuk mund të kuptohet pa marrë parasysh dimensionin gjeografik. Hapësira, terreni, rrugët dhe qendrat urbane kanë qenë aktorë të padukshëm, por vendimtarë, në shtrirjen e kësaj feje në botë.

HARTA BASHKËKOHORE E ISLAMIT

Në fillim të shekullit XXI, Islami është feja e dytë më e madhe në botë pas Krishterimit, me mbi 1.9 miliardë pasues, që përfaqësojnë rreth 25% të popullsisë globale. Shpërndarja gjeografike e myslimanëve pasqyron një diversitet të madh kulturor dhe hapësinor, duke e bërë Islamin një fe globale me prani në pothuajse çdo kontinent.

Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore: Ky rajon njihet si djepi i Islamit. Pothuajse të gjitha shtetet e tij kanë shumicë myslimane, duke përfshirë Arabinë Saudite, Egjiptin, Irakun, Sirinë, dhe Marokun. Islami këtu shërben jo vetëm si fe, por edhe si element kyç i identitetit kombëtar dhe kulturor.[8]

Afrika nën-Sahariane: Përhapja e Islamit në këtë rajon lidhet ngushtë me rrugët tregtare të Saharës dhe kontaktet historike me botën arabe. Sot, shtete si Nigeria, Mali, Senegali dhe Somalia kanë shumicë ose prani të madhe myslimane.[9] Islami në këtë hapësirë bashkëjeton me besime tradicionale afrikane dhe krishterimin.

Azia Jugore: Azia Jugore është rajoni me numrin më të madh të myslimanëve në botë. India, Pakistani dhe Bangladeshi përbëjnë

qendra të mëdha të Islamit. Vetëm Bangladeshi dhe Pakistani së bashku kanë mbi 400 milionë myslimanë. Islami në këtë rajon është i larmishëm, me ndikime të shumta kulturore dhe politike.

Azia Juglindore: Përmes rrugëve detare tregtare, Islami u përhap në Malajzi, Indonezi dhe Filipine. Indonezia sot është vendi me popullsinë më të madhe myslimane në botë, me mbi 230 milionë banorë. Kjo tregon rëndësinë e faktorëve gjeografikë detarë në përhapjen e Islamit.

Evropa dhe Ballkani: Islami u përhap në Evropë kryesisht përmes Perandorisë Osmane. Në Ballkan, vende si Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë prani të konsiderueshme myslimane. Migracioni i shekullit XX ka rritur praninë islame edhe në Evropën Perëndimore, sidomos në Francë, Gjermani dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Amerika dhe Australia: Në këto kontinente, Islami është kryesisht rezultat i migracionit modern. Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja kanë komunitete islame gjithnjë në rritje, që lidhen me migracionin nga Lindja e Mesme, Afrika dhe Azia. Edhe Australia ka një prani të konsiderueshme myslimane, kryesisht nga migracioni i fundit.[10]

Në hartën bashkëkohore, Islami nuk është i kufizuar vetëm në territoret e tij historike, por ka fituar një dimension të ri global. Migracioni, urbanizimi dhe globalizimi kanë krijuar një shpërndarje transnacionale të Islamit, duke e bërë atë një fe me ndikim të thellë në arenën ndërkombëtare.

PËRFUNDIM

Nga analiza e bërë, shihet qartë se hapësira gjeografike ka qenë një element vendimtar në përhapjen e fesë islame, duke përcaktuar ritmin, drejtimet dhe mënyrat e zgjerimit të saj. Faktorët natyrorë si pozita strategjike e Gadishullit Arabik, rrugët tregtare, klima dhe burimet ujore kanë krijuar kushte të favorshme që Islami të kalojë përtej kufijve të origjinës së tij. Po ashtu, elementët shoqërorë dhe kulturorë, të ndërthurur me mjedisin natyror, kanë mundësuar integrimin e kësaj feje në hapësira të ndryshme, nga Azia Jugore deri në Ballkan dhe Afrikë.

Në të njëjtën kohë, Islami nuk ka qenë vetëm një fe që është përshtatur me gjeografinë, por edhe një faktor transformues i saj. Ai ka ndikuar në zhvillimin e qyteteve, në ndërtimin e qendrave të dijes dhe tregtisë, në krijimin e një rrjeti komunikimi ndërmjet hapësirave të gjera dhe në integrimin e shoqërive të ndryshme në një botë më të gjerë islame. Ky ndikim reciprok tregon se feja dhe hapësira janë të lidhura ngushtë dhe se kuptimi i një feje nuk mund të jetë i plotë pa pasur parasysh dimensionin gjeografik të saj.

Pra, përhapja e Islamit është një proces që shpjegohet jo vetëm nga aspekti shpirtëror dhe doktrinar, por edhe nga



raporti i vazhdueshëm me mjedisin ku ai është shtrirë. Studimi i këtij raporti na ndihmon të kuptojmë më mirë jo vetëm historinë e Islamit, por edhe rolin që hapësira gjeografike luan në zhvillimin dhe transformimin e fenomeneve fetare në përgjithësi.

1 Lily Kong, “Geography and Religion: Trends and Prospects”, Progress in Human Geography 14, no. 3 (1990): 355.
2 Kong, Geography, f. 356.
3 Lily Kong, “Religious Schools: For Spirit, (f)or Nation”, Dialogues in Human Geography 5, no. 3 (2015): 243.
4 Albert Hourani, A History of the Arab Peoples (Cambridge, MA: Belknap Press of Harvard University Press, 1991), f. 54.
5 Hourani, A History of the Arab Peoples, f. 222.
6 Kong, Geography, f. 321.
7 Hourani, A History of the Arab Peoples, f. 132.
8 Hourani, A History of the Arab Peoples, f. 122.
9 A Country Study: Somalia from The Library of Congress, Marrë nga: https://lcweb2.loc.gov/cgi
10 USA Religion, Marrë nga: https://www.usreligioncensus.org/node/1639

Adem Jashari në tekstet shkollore të historisë në Kosovë

Dr. Nuridin Ahmeti

HYRJE

Nëse hulumtojmë me përkushtim në materiale dhe dokumente arkivore, të cilat ruhen në institucionet përkatëse në Kosovë, por edhe më gjerë, vërejmë se lidhur me mënyrën se si prezantohen, apo duhet të prezantohen, ngjarje të caktuara të vendit tonë në tekstet shkollore, gjithmonë ka pasur debate.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1960, në Prishtinë u botua teksti i parë shkollor në gjuhën shqipe me titull: *"Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare"*, në të cilin nxënësit shqiptarë në Kosovë do të mësonin për të kaluarën tonë nga antikiteti deri në periudhën më të re. Autorë të këtij teksti ishin Ali Hadri dhe Milan Perkaj. Për kohën kur u botua, ky tekst u ka shërbyer mjaft mirë nxënësve. Nga viti 1960 deri në vitin 1966, nxënësit shqiptarë u shërbyen me këtë tekst.

Pas vitit 1966, vetë Ali Hadri mendonte për planet dhe programet e historisë nacionale shqiptare dhe, rrjedhimisht, se edhe ky tekst duhej plotësuar (Rilindja, 28–29–30 nëntor 1966, Prishtinë, f. 13). Nga viti 1967, kohë pas kohe, janë organizuar tryeza në Prishtinë lidhur me plan-programet e historisë nacionale shqiptare, siç quhej atëherë, ku ishin të përfshirë punonjës shkencorë, arsimtarë dhe pedagogë, të cilët jepnin mendimin e tyre profesional.

Debati lidhur me përpilimin e teksteve shkollore të historisë në Kosovë vazhdoi deri në vitet '90 dhe më pas. As periudha pas vitit 1999 nuk kaloi pa debate në këtë drejtim në vendin tonë. Përkundrazi, pas vitit 1999, debatet u intensifikuan. Janë bërë hulumtime, janë botuar libra nga autorë të ndryshëm, janë organizuar tryeza, si dhe janë publikuar artikuj në gazeta e revista etj..

Pjesë e këtyre diskutimeve pas vitit 1999 ka qenë edhe çështja nëse dhe në çfarë mase është prezantuar Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në tekstet tona shkollore të historisë. Megjithatë, fokusi ynë në këtë trajtim është mënyra se si prezantohet komandanti historik Adem Jashari, masakra e 5–7 marsit 1998 ndaj familjes Jashari, e kryer nga forcat paramilitare dhe ushtarake serbe, si dhe qëndresa heroike e kësaj familjeje.

ADEM JASHARI, KOMANDANT I PËRGJITHSHËM I UÇK-SË

"Lufta e UÇK-së në periudhën 1998–1999, ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi janë temat që parashihen në plan-programin mësimor për nxënësit e klasës së 9-të. Por ekspertët dhe nxënësit shprehen kritikë për mospasqyrimin

Lufta e UÇK-së në periudhën 1998–1999, ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi janë temat që parashihen në plan-programin mësimor për nxënësit e klasës së 9-të.



e plotë të ngjarjeve që kanë ndodhur në Kosovë dhe rreth saj gjatë kësaj periudhe, si dhe për pasaktësi në të dhënat e prezantuara." (*Koha ditore*, 14 prill 2025, Prishtinë, f. 3).

Ky është vetëm njëri nga artikujt e botuar në shtypin e Kosovës lidhur me trajtimin e Luftës së UÇK-së, e rrjedhimisht edhe të figurës së Adem Jasharit, në tekstet e historisë. Në Kosovë, nxënësit mësojnë historinë përmes teksteve shkollore që nga klasa e 5-të. Teksti i historisë për këtë klasë përfshin historinë shqiptare nga antikiteti deri te shpallja e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Në njësinë mësimore nr. 53, me titull "Çlirimi i Kosovës", ndër ilustrimet e përfshira është vendosur edhe fotografia e Adem Jasharit, me mbishkrimin poshtë saj: "Komandanti legjendar Adem Jashari" (shih: F. Rexhepi – F. Demaj, *Historia 5*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2020, f. 105). Në këtë fotografi, Adem Jashari paraqitet me plis të bardhë në kokë, me veshje ushtarake, i armatosur dhe i mbështjellë me brez fishekësh.

Sipas kurrikulës në fuqi në Kosovë, komandanti historik Adem Jashari përmendet edhe në tekstin e historisë për klasën e -9të. Në njësinë nr. 50, "Lufta e UÇK-së, ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i Kosovës", ndër të tjera shkruhet: "Lufta çlirimtare e Kosovës u intensifikua dhe mori hov, sidomos pas luftës heroike të familjes Jashari në Prekaz, më 5–7 mars 1998. Shaban Jashari me të dy bijtë e tij, Hamzën e Ademin, si dhe me gra, nipa e mbesa, bënë heroizëm të paparë, duke u përballur e luftuar me ushtrinë dhe policinë serbe, e cila ishte e pajisur me armatimin më modern dhe të sofistikuar të kohës. Kjo luftë, e udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, u bë shembull i qëndresës dhe frymëzim për një popull të tërë për liri e pavarësi" (shih: F. Rexhepi, *Historia 9*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2020, f. 168–169).

Duke qenë i përshtatur me moshën e nxënësve, teksti i historisë i klasës së 9-të ofron më shumë informacion për rolin e Adem Jasharit dhe të familjes së tij në këtë luftë. Njësia mësimore është e ilustruar me fotografi të Adem Jasharit me uniformë ushtarake dhe me armë në dorë.

Duhet theksuar se teksti i historisë i përpiluar nga autorët Bezeraj, Kreka dhe Dugolli, në njësinë mësimore "Lufta e UÇK-së, hyrja e KFOR-it dhe çlirimi i Kosovës", që nga rreshtat hyrës i kushton rëndësi figurës historike të Adem Jasharit si drejtues i një grupi rekrutësh në vitin 1990, të cilët kryenin stërvitje ushtarake në Shqipëri, e deri te rënia e tij heroike. Kjo njësi është e ilustruar me fotografi të Adem Jasharit dhe të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz (shih: S. Bezeraj – A. Kreka – B. Dugolli, *Histori 9*, Albas, Tiranë, 2022, f. 143–144).

Teksti i historisë për klasën e 12-të figurën e Adem Jasharit e trajton në njësinë mësimore "Lufta Çlirimtare e Kosovës dhe betejat kryesore (1997–1999)". Për dallim nga tekstet e klasave të tjera, në këtë tekst hasim edhe nëntitullin "Lufta e Jasharajve dhe zgjerimi i saj", ku trajtohet në mënyrë më të zgjeruar përmasa e kësaj lufte (shih: Z. Kastrati – B. Paci, *Histori 12*, Albas, Tiranë, 2021, f. 190–192).

Marrë në përgjithësi, në tekstet e lartcekura mund të lexohet qartë se komandanti Adem Jashari prezantohet si një figurë historike që përfaqëson kthesën dramatike të një populli, i cili, pas dekadash represioni, zgjodhi rezistencën e armatosur si mjet të fundit për mbijetesë politike. Rënia e tij

dhe e familjes Jashari në Prekaz, në mars të vitit 1998, nuk ishte vetëm një ngjarje tragjike, por edhe një moment mobilizues që ndryshoi rrjedhën e historisë së Kosovës.

PËRFUNDIMI

Duke i shqyrtuar tekstet shkollore të historisë në Kosovë, kurrikulat dhe plan-programet mësimore, mendojmë se Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e rrjedhimisht edhe rolit të komandantit historik Adem Jashari dhe sakrificës së familjes së tij, duhet t'u lihet një hapësirë më e bollshme nga përpiluesit e kurrikulave. Krahasuar me kontributin dhe përmasat historike të kësaj figure dhe familjes së tij, trajtimi aktual nuk duket të jetë në përpjesëtim të drejtë.

Mundësitë kurrikulare janë të kufizuara. Tekstet e historisë ku trajtohet figura e Adem Jasharit dhe familjes së tij, sipas kurrikulës aktuale, janë ato të klasës së 5-të, 9-të, 10-të dhe 12-të. Në të gjitha tekstet ku flitet për këtë komandant, ai ilustrohet edhe me fotografi. Në legjendën poshtë fotografisë zakonisht shkruhet: "Komandanti legjendar Adem Jashari", por hasim edhe formulimin: "Adem Jashari, komandant i përgjithshëm i UÇK-së", i cili, sipas mendimit tonë, është më përmbajtjesor (shih: S. Bezeraj – A. Kreka – B. Dugolli, *Histori 9*, Albas, Tiranë, 2022, f. 144).

Duhet theksuar se mënyra se si e shkruajmë historinë e Adem Jasharit flet shumë për mënyrën se si e shohim veten si shoqëri.

Karakteristikë e librave të historisë të përgatitur nga autorët Bezeraj, Kreka-Dugolli (klasa e 9-të) dhe Kastrati-Paci (klasa e 12-të) është se kopertinat e tyre janë ilustruar edhe me bustin e Adem Jasharit.

Shqetësimi im kryesor mbetet renditja e njësive mësimore në tekstet ku trajtohet figura e komandantit historik Adem Jashari. Duke u bazuar në renditjen kronologjike të ngjarjeve, siç janë zakonisht të përpiluara tekstet tona, njësia për Luftën e UÇK-së, e rrjedhimisht edhe ajo për Adem Jasharin, vendoset ndër të fundit. Kjo renditje e shton rrezikun që nxënësve të mos u shpjegohet fare kjo pjesë në shkolla nga profesorët e historisë, pasi janë të rrallë ata që arrijnë ta realizojnë plan-programin mësimor në tërësi. Si zakonisht, njësitë e fundit mësimore mbeten pa u trajtuar nga arsimtarët e lëndës, që në këtë rast janë të historisë.

Në fund, duhet theksuar se mënyra se si e shkruajmë historinë e Adem Jasharit flet shumë për mënyrën se si e shohim veten si shoqëri. Ta trajtosh atë me dinjitet, përgjegjësi dhe thellësi do të thotë të ndërtosh një kulturë historike që nuk frikësohet nga e vërteta dhe nuk e banalizon sakrificën. Adem Jashari nuk i përket vetëm së kaluarës; ai është pjesë e debatit tonë të vazhdueshëm për lirinë, shtetin dhe përgjegjësinë ndaj historisë.

Çfarë ka ndodhur kur është botuar përkthimi i parë i Kuranit në Evropë?

Ta botosh përkthimin e Kuranit dhe ta vësh në dispozicion në Evropën Perëndimore ishte e rrezikshme në shekullin XVI, sepse Kurani kishte fuqi për t'i "ngatërruar dhe mashtruar" besimtarët e krishterë. Kështu, të paktën, konsideronin këshilltarët protestantë të qytetit të Bazelit, në vitin 1542, kur për pak kohë ata e burgosën pronarin e një shtypshkronje lokale, sepse njoftoi se po planifikonte ta botonte përkthim latinisht të librit të shenjtë mysliman (përkthimi i parë i Kuranit ishte bërë qysh në vitin 1143, në Spanjë, por kishte mbetur i fshehur, për nevojat e brendshme të kishës, plot 400 vjet, deri në vitin 1543).

Reformatori protestant Martin Luther, kishte ndërhyrë dhe e kishte shpëtuar projektin. Si rezultat i kësaj, në vitin 1543, Kurani u vu në dispozicion për intelektualët evropianë, të cilët, kryesisht, e kanë studiuar për ta kuptuar më mirë, me qëllim që ta luftojnë Islamin. Megjithatë, ka pasur edhe të tjerë, të cilët leximin e tyre të Kuranit e kanë përdorur për ta ekzaminuar doktrinën e krishterë. Dijetari i gjithanshëm Katalonas dhe teologu Michael Servetus (i njohur edhe si Miguel

Gjatë renesancës evropiane, autorë të shumtë, Muhamedin e kanë paraqitur si hero antiklerikal; disa Islamin e kanë parë si formë të pastër të monoteizmit të afërt me deizmin filozofik, kurse Kuranin si një lavdithurje racionale për Krijuesin.

Servet, Miguel de Villanueva), i ka shfrytëzuar argumentet e shumta kuranore në traktatin e tij antitrinitar (kritika e dogmës së trinisë), *Christianismi restitutio* (1553), në të cilin, Muhamedin e quan reformator të vërtetë, i cili ka predikuar kthimin e monoteizmit të pastër, të cilin teologët e krishterë e kanë shtrembëruar dhe rrënuar duke e shpikur “doktrinën perverse dhe të paarsyeshme të trinitetit”. Pas publikimit të kësaj ideje, inkuizicioni katolik e dënoi Servetosin si heretik dhe në fund e dogji me librat e tij në Gjenevën e Kalvinit.

EPOKA E ILUMINIZMIT EVROPIAN

Gjatë renesancës evropiane, autorë të shumtë, Muhamedin e kanë paraqitur si hero antiklerikal; disa Islamin e kanë parë si formë të pastër të monoteizmit të afërt me deizmin filozofik, kurse Kuranin si një lavdithurje racionale për Krijuesin. Në vitin 1734, George Sale, publikoi një përkthim të ri në gjuhën angleze. Krahas përkthimit, ai e shkroi edhe hyrjen e tij, në të cilën e idealizon Pejgamberin si ikonathyes, reformator antiklerikal, i cili refuzoi besimet “paragjykuese” dhe praktikat e të krishterëve të hershëm – kultin e shenjtorëve, të relikteve të shenjta – dhe hoqi fuqinë e klerit të korruptuar dhe grabitqar. Përkthimi i Kuranit nga Sale është lexuar shumë dhe mjaft është vlerësuar në Angli. Për shumë nga ata që e lexuan, Muhamedi u bë simbol i republikanizmit antiklerikal. Ai, gjithashtu, ishte shumë me influencë edhe jashtë Anglisë. Themeluesi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Thomas Jefferson, e bleu një kopje të këtij përkthimi në librari në Williamsburg, Virgjinia, në vitin 1765, i cili e ndihmoi atë për ta kuptuar deizmin filozofik, i cili i tejkaloi kufijtë konfesional. (Kopja e Jeffersonit tani gjendet në Bibliotekën e Kongresit dhe është përdorur për betimin e përfaqësuesve myslimanë në Kongres, duke filluar me Keitha Ellison në vitin 2007).

Në Gjermani, romantiku Johann Wolfgang von Goethe, e lexoi përkthimin e Sales, i cili ndikoi tek ai që ta zhvillojë perceptimin e tij për Muhamedin si një poet i frymëzuar dhe profet arketip.

Në Francë, Voltaire, gjithashtu, thekson se me admirim e kishte lexuar përkthimin e Kuranit nga Sale. Në historinë e tij botërore “*Essai sur les mœurs et l'esprit des nations*” (1756), ai e paraqet Muhamedin si reformator i frymëzuar, i cili i shfuqizoi praktikat paragjykuese dhe e çrrënjosi fuqinë e klerit të korruptuar.

Në fund të shekullit XVIII, Edward Gibbon, një vig anglez (vigët ishin fraksion, e pastaj parti politike në parlamentet e Anglisë, Skocisë, Britanisë së Madhe dhe Mbretërisë së Bashkuar) (ishte lexues i flaktë i Sale-s dhe Volterit), e prezantoi Pejgamberin në mënyrë të mrekullueshme në veprën “*The History of the Decline and Fall of the Roman Empire*” (1776-1789): “Besimi i Mahometit është i pa dyshimtë apo pa paqartësi, kurse Kurani është dëshmi e lavdishme për njëshmërinë e Zotit. Profeti i Mekës e refuzoi adhurimin e idhujve dhe burrave, yjeve dhe planetëve, në parimin racional se çdo gjë që ngrihet duhet të bien, se ajo që ka lindur duhet të vdesë, se çdo gjë është që prishet duhet të prishet dhe të shkatërrohet. Sa për “autorin e universit”, ai me entuziazmin e tij racional e ka pranuar dhe e ka adhuruar qenien e pakufizuar dhe të përjetshme, pa formë apo vend, pa probleme apo krahasime, i udhëzuar në mendimet tona më të fshehta, i cili ekziston sipas domosdoshmërisë së natyrës

së vet, dhe përsosmëria morale dhe intelektuale e të cilit buron nga vetja e tij. Çdo teist filozofik mund ta pranojë këtë besim muhamedan: besim, i cili, ndoshta, është ekselent për kuptimin tonë aktual."

NAPOLEONI DHE PEJGAMBERI

Megjithatë, Napoleon Bonaparta, ishte ai i cili me padurim u interesua që të njohë më shumë për Pejgamberin pas leximit të përkthimit frëngjisht të Kuranit, të cilin e bëri Claude-Etienne Savary në vitin 1783. Savary, përkthimin e tij e shkroi në Egjipt. Atje, i rrethuar nga muzika në gjuhën arabe, ai vendosi ta përcjellë bukurinë e tekstit arab në frëngjisht. Sikurse edhe Sale, Savary shkroi një hyrje të gjatë për përkthimin e tij të Kuranit, në të cilën Muhamedin e paraqiti si një njeri të madh dhe të jashtëzakonshëm, një gjeni në fushën e betejës, një njeri, i cili diti se si ta frymëzojë besnikërinë mesin e ndjekësve të tij. Napoleoni e lexoi këtë përkthim në një anije, e cila e çoi në Egjipt në vitin 1798. I frymëzuar portretizimin e Savary-s për Pejgamberin si një gjeneral dhe ligjvënës të shkëlqyer, Napoleoni dëshironte të bëhej Muhamedi i ri dhe shpresonte se ulemaja në Kajro, atë dhe ushtarët e tij francezë do t'i pranojnë si miq të Islamit, të cilët erdhën për ta çliruar Egjiptin nga tirania osmane. Ai madje pretendoi se ardhja e tij në Egjipt ishte e paralajmëruar në Kuran. Nën ndikimin e shkrimeve të iluminizmit, Napoleoni kishte vizion të idealizuar të Islamit si monoteizëm të pastër. Sigurisht, të kuptuarit e tij të Islamit ishte i ndryshëm nga të kuptuarit e ulemave të Kajros, gjë që pjesërisht është shkaktar i dështimit të ekspeditës së tij egjiptiane.

Por Napoleoni nuk është i vetmi që vetveten e ka parë si një Muhamed të ri. Goethe me entuziazëm ka njoftoi se perandori ishte "Muhamed der Welt" (Muhamedi botëror), kurse shkrimtarin francez Victor Hugo, e kanë portretizuar si "Mahomet d'occiden" (Muhamedi i Perëndimit).

Vetë Napoleoni, në fund të jetës së tij, si i dëbuar në Shën Helenë, duke menduar për humbjen e tij, ka shkruar për Muhamedin dhe e ka mbrojtur trashëgiminë e tij si një "njeri i madh, i cili e ndryshoi rrjedhën e historisë". Në sytë e Napoleonit, Muhamedi si pushtues, ligjvënës, udhëheqës bindës dhe karizmatik, ishte edhe vetë Napoleoni, por Napoleoni, i cili ishte shumë më i suksesshëm, dhe sigurisht kurrë i dëbuar në një ishull të ftohtë dhe me erë në Atlantikun e Jugut.

Adolph Weinman, skulptor amerikan i lindur në Gjermani, në punimin e tij që ka bërë në vitin 1935, Muhamedin e ka paraqitur në dhomën kryesore të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara, ku Pejgamberi e zënë vendin e tij në mesin e 18 ligjvënësve.

SHEKULLI XX

Ideja për Muhamedin si një nga ligjvënësit më të mëdhenj në botë ka mbetur aktuale edhe në shekullin XX. Adolph Weinman, skulptor amerikan i lindur në Gjermani, në punimin e tij që ka bërë në vitin 1935, Muhamedin e ka paraqitur në dhomën kryesore të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara, ku Pejgamberi e zënë vendin e tij në mesin e 18 ligjvënësve.

Grupe të ndryshme të krishtera evropiane u kanë bërë thirrje kishave të tyre që ta pranojnë rolin e veçantë të Muhamedit si pejgamber i myslimanëve. Për ekspertët katolikë mbi Islamin, si Louis Massingon ose Hans Küng, ose për ekspertin skocez protestant mbi Islamin William Montgomery Watt, një njohje e tillë është mënyra më e mirë për ta nxitur një dialog paqësor, konstruktiv ndërmjet të krishterëve dhe myslimanëve. Ky lloj dialogu vazhdon edhe sot, por kryesisht është mbytur zhurmën e konfliktit, të cilin e krijojnë politikanët ekstremë të krahut të djathtë në Evropë dhe vende të tjera, të cilët e demonizojnë Muhamedin për ta justifikuar politikën e tyre antimyslimane. Politikani holandez Geert Wilders e quan terrorist, pedofil dhe psikopat.

Burimi: https://aeon.co; http://saff.ba// http://saff.ba/procitajte-sta-se-dogodilo-kada-je-objavljen-prvi-prijevod-kurana-u-evropi/

Përktheu: Miftar Ajdini

Lufta civile amerikane (1861-1865)

Msc. Drin Aliu

Lufta civile amerikane (1861-1865), është një ndër ngjarjet më të rëndësishme për popullin amerikan pas shpalljes së Pavarësisë (4 korrik 1776). Populli amerikan, pasi arriti me mjaft mund të shkëputej me sukses nga Anglia, vazhdoi rrugën e tij të konsolidimit dhe të shtetëformimit. Gjatë sundimit të presidentit historik të Amerikës Xhorxh Washingtonit (1789-1797), me hapa shumë të shpejtë filloi konsolidimi i shtetit të ri. Populli amerikan me shumë vullnet ishte i bashkuar dhe i unifikuar në shumë çështje. Gjatë kësaj periudhe të shtetëformimit një gjë shumë e rëndësishme, e cila i kontribuoi shumë paqes dhe bashk**ë**punimit mes vete të popullit amerikan është se nuk u cenuan në asnjë rast të vetëm interesat e familjeve të mëdha, sepse në të kundërtën do të ndërpritej procesi i shpejt i shtetëformimit dhe do të kishte për**ç**arje.

Duke pasur parasysh zhvillimet e kohës në Amerikë, që nga formimi i shtetit të ri, amerikanët përkrahën sistemin demokratik të qeverisjes. Me kalimin e kohës, qëllimi i elitës demokratike amerikane ishte që demokracia të shtrihej dhe të implementohej në çdo sferë të jetë, por ky synim ishte shumë i vështirë për t'u jetësuar dhe u shoqërua me pasoja të shumta, siç do t'i shtjellojmë në vijim. Duke pasuar parasysh përbërjen demografike të popullsisë në Amerikë, siç dihet Kontinenti Amerikan pas zbulimeve të mëdha gjeografike u mbipopullua me skllevër të sjellë nga Afrika, të cilët përdoreshin për punë të rënda fizike. Kjo gjë i konvenonte familjeve të mëdha aristokrate, të cilët i shfrytëzonin këta skllevër që nga lindja e tyre e deri në vdekje. Siç dihet skllevërit nuk gëzonin asnjë të drejtë, ata keqtrajtoheshin nga pronarët e tyre, madje edhe vriteshin pa dhënë përgjegjësi para shtetit. Me një fjalë, puna e mundimshme e skllevërve-zezakë ishte shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik në Amerikën e asaj kohe. Sipas burimeve historike, mes shekujve XVI-XIX, në Amerikë u sollën me dhunë nga Afrika rreth 12 milion skllevër.

Amerika gjatë kësaj kohe i ngjasonte shumë shtetit skllavopronar-mesjetar. Zezakët punonin pa pagesë si skllevër në plantacionet e duhanit, pambukut, orizit etj., ata punonin edhe në miniera në kushte shumë të rënda pa gëzuar asnjë të drejtë. Duke pasuar parasysh hapësirën e madhe gjeografike të Amerikës, gjendja e këtyre skllevërve ndryshonte shumë nga Veriu në Jug. Nëse ju referohemi burimeve historike, del që në fillim të shekulli XIX, përkatësisht nga viti 1810 e tutje, në Amerikën Veriore filloi një qasje më ndryshe në trajtimin e skllevërve në aspektin pozitiv, gjë që dallonte shumë me Amerikën Jugore. **Në** Amerikën Veriore, deri në vitin 1810, tre të katërtat e popullsisë me ngjyrë ishin çliruar nga skllavëria. Në Veri filloi të zhvillohej sistemi kapitalist, përmes së cilit skllevërit filluan të përfilleshin sadopak. Nga njerëzit demokratik u bënë përpjekje që të hartoheshin ligje, të cilat do t'u jepnin liri skllevërve. Për dallim nga Veriu, në Jug ishte një gjendje kaotike, skllevërit ende shtypeshin dhe trajtoheshin më keq sesa kafshët kjo për faktin se, për amerikanët e asaj kohe, më i respektuar dhe më me vlerë ishte një kali apo qen, sesa një skllav-zezak. Baza kryesore e zhvillimit ekonomik në Amerikën Jugore ishin skllevërit-zezakë, pa të cilit ekonomia ishte e pa imagjinuar.

Duke pasuar parasysh dallimet e mëdha ndërmjet Veriut dhe Jugut, si në aspektet politike, ashtu edhe në ato ekonomike, filluan që të tensionoheshin raportet Veri-Jug. Në dekadat e para të shek. XIX, Amerika Veriore shënoi një progres të theksuar pothuajse në çdo sferë të jetës. Në veri të SHBA-së u ndërtuan vendbanime të reja, rrugë, rrjeti i

hekurudhave u zgjerua etj.. Ndërsa në pjesën jugore vazhdoi sistemi i vjetër dhe i dominuar nga pronarët e mëdhenj, të cilët e kontrollonin ekonomin dhe i shtypnin skllevërit, të cilët nuk gëzonin asnjë të drejtë. Jugu, duke i përdoruar zezakët për punë pa pagesë, e zhvilloi shumë ekonominë, për arsye se nuk paguante krahun e punës sepse të gjitha punët i kryenin zezakët. Për këtë arsye, Jugu i bënte konkurrencë të madhe Veriut në tregti, sepse i kishte çmimet më të lira.

Gjatë kësaj kohe mungonte tregu i lirë dhe doganat unike, nuk kishte çmime të qëndrueshme të produkteve, me një fjalë nuk kishte ekuilibër në ekonominë e tregut. Duke pasur parasysh situatën politike në prag të luftës, mund të themi se arsyet e luftës civile ishin: politike, ekonomike dhe sociale. Politike për faktin se mungonte unifikimi i popullit amerikan, si dhe legjitimiteti nuk ishte i shpërndarë në të gjitha pjesët njësoj. Ekonomike sepse nuk ishte një ekonomi e qëndrueshme dhe sociale sepse nuk kishte të drejta të barabarta për të gjithë banorët në ShBA.

Me ardhjen në pushtet të presidentit historik të Amerikës, *Abraham Likoln (1861-1865)*, situata në vend u tensionua edhe më shumë mes Veriut dhe Jugut. Abraham Likoln konsiderohet si ndër presidentët më të suksesshëm në historinë e Amerikës, i cili drejtoi vendin në situatën më të vështirë pas Pavarësisë së ShBA-së. Likolni ishte njeri shumë i dijshëm dhe i matur, ai u bashkua me Partin**ë** Republikane, e cila ishte kundër skllavërisë dhe pro të drejtave të zezakëve. Abraham Likolni ishte për një shtet të lirë, në të cilin çdo individ do të kishte të drejtat e tij. Këto qëndrime të tij u kundërshtuan nga Jugu. Elita politike dhe ekonomike e shteteve jugore dëshironin të jetonin me sistemin e vjetër (skllavopronar) dhe ishte kundër ndryshimeve dhe kundër të drejtave të zezakëve.

Shtetet jugore t**ë** **S**hBA-së në përgjithësi, gjatë sundimit të Abraham Likolnit **në veç**anti, nuk përfillnin institucionet e qeverisëse që drejtoheshin kryesisht nga shtetet veriore, madje ato synonin që të shkëputeshin nga Veriu dhe të formonin një shtet të pavarur. Kështu edhe ndodhi, m**ë** 20 dhjetor 1860, *Karolina e Jugut* deklaroi se u shkëput nga Amerika Veriore, bashkë me të u shkëputën edhe *Misisipi, Florida, Xhorxha dhe Teksasi*. Këto shtete formuan të ashtuquajturën *Konfederatën*, "president" të saj zgjodhën *Xheferson Dejvis-in*. Ndarja e vendit në dy pjesë ishte e papranueshme nga Veriu. Konfederata menjëherë hartoi një kushtetutë, e cila i ngjasonte pjesërisht kushtetutës së Veriut, por kishte dallime esenciale të mëdha, sidomos në trajtimin e skllevërve, të cilëve kjo kushtetutë nuk u jepte asnjë të drejtë. Duke analizuar gjendjen kaotike në vend, Abraham Likolni, si njeri i zgjuar dhe i rrethuar nga një elitë e shquar intelektualësh, u munduan që këtë çështje ta zgjidhte me diplomaci, por diplomacia ishte e pasuksesshme, sepse Jugu nuk hiqte dorë nga Konfederata e tyre. Si rezultat i situatës dhe pamundësive që kjo çështje të zgjidhej me paqe, nuk mbeti asgjë tjetër përveç luftës.

Lufta filloi në grykën e Portit Çarlston, aty ku gjendej fortesa *Samtër* e drejtuar nga majori *Robert Anderson*. Fortesa Samtër u rrethua nga ushtria e Konfederatës më 11 prill 1861 në drejtimin gjeneralit *Beauregrand* me rreth 6000 ushtarë. *Beauregrand* i kërkoi majorit R.Anderson që ta lironte fortesën pa luftë. Majori R.Anderson dhe ushtarët e tij nuk pranuan ta dorëzonin fortesën as pas një ultimatumi, i cili kërkonte që fortesa të lirohet deri ne orën 4:00 të mëngjesit. Pas orë 4:30 të mëngjesit të datës 12 prill 1861, gjeneralit *Beauregrand* dha urdhër që fortesa të sulmohet me topa, me këtë akt filloi Lufta civile amerikane. Në fortesën e Samtërës

u bë një rezistencë heroike nga ushtria e Unionit, por pasi që u gjendën të rrethuar më 13 prill 1861, ushtria e Unionit e dorëzoi fortesën e Satës.

Lufta civile amerikane u zhvillua mes Veriut (Unionit) nën udhëheqjen e presidentit Abraham Likoln dhe Jugut (Konfederatës) nën udhëheqjen e Xheferson Dejvis. Kjo luftë ishte shumë e komplikuar, madje më e komplikuar sesa lufta për pavarësi, kjo për faktin se në këtë luftë ishte vështirë ta dallohej kundërshtari, prandaj luftërat civile gjithmonë gjatë historisë kanë qenë shumë të rënda në secilin shtet që kanë ndodhur.

Lufta civile ishte shumë e rëndë. Me fillimin e luftës, shteti i Amerikës u gjet në bllokada të shumta ekonomike, tregtare, financiare etj.. Luftimet ishin të ashpra nga të dyja palët dhe njëkohësisht ishin shumë të dhimbshme, sepse mes vete po luftonte një popull i tërë, me prejardhje, gjuhë, fe, kulturë dhe territor të përbashkët. Lajmi për fillimin e luftës arriti shumë shpejt në gjithë botën.

Kjo luftë u zhvillua me shumë episode të dhimbshme për popullin amerikan. Ndër betejat më të ashpra të luftës civile, të cilat u shoqëruan me humbje të mëdha njerëzore dhe materiale ishin: Beteja e Getisbërburgut në korrik 1863, në të cilën u vranë 3000 ushtarë të Unionit dhe 4000 ushtarë të Konfederatës. Betejat për fortesën e Henrit dhe Donelsos, të cilat i fitoi Unioni. Beteja për qytetin e Vicksbergut, të cilën e fitoi përsëri Unioni etj.. Gjatë luftës, Veriu përdori shumë strategji. Duke pasur parasysh zhvillimin më të madh, Veriu përdori shumë rrjetin e dendur hekurudhor, që i mundësoi të furnizohej më lehtësi me armatime dhe mallra. Një avantazh tjetër për Veriun ishte se shumë zezakë, për ta fituar lirinë ju bashkëngjitën Unionit në luftë kundër Jugut.

Kur trajtohet lufta civile amerikane gjithsesi duhen përmendur dy gjeneralë shumë të rëndësishëm, gjeneralin *Ulise Grant,* i cili drejtonte ushtrinë e Unionit dhe gjenerali *Robert Li,* që drejtonte Konfederatën. Të dy këta ushtarak drejtuan luftimet e luftës civile.

Lufta civile ishte shumë e rëndë, ajo përfundoi pas 4 vjetëve me fitoren e Unionit-shteteve veriore të udhëhequra nga presidenti Abraham Likoln. Gjatë luftës civile humbën jetën rreth 600 mijë njerëz. Kjo luftë u shoqërua me shumë humbje të mëdha njerëzore dhe materiale. Lufta përfundoi me shumë dëme në gjithë vendin. Një kontribut të madh në këtë luftë e dha presidenti Abraham Likoln, i cili punoi shumë për unifikimin edhe bashkimin e vendit, po ashtu luftoi dhe për lirinë dhe të drejtat e zezakëve. Krejt një fund duhet t'i përmendim rezultatet e luftës, krahas dëmeve kjo luftë solli: bashkimin politik të vendit, zhdukjen e skllavërisë, por jo edhe racizmin, zhvillimin ekonomik, revolucionin industrial, markantilizmin etj..

Rezultatet e luftës, krahas dëmeve kjo luftë solli: bashkimin politik të vendit, zhdukjen e skllavërisë, por jo edhe racizmin, zhvillimin ekonomik, revolucionin industrial, markantilizmin etj..

Udhëpërshkrimi i Evlija Çelebiut në Kosovë - 1660

Ma. Fatlum Nika

HYRJE

Evlija Çelebiu është një nga udhëtarët dhe kronistët më të famshëm të periudhës osmane, i njohur për vëllimin e tij monumental "*Seyahatname*" (Libri i udhëtimeve), i cili përbëhet nga përshkrime të detajuara historike, kulturore dhe gjeografike të vendeve të ndryshme që ai vizitoi gjatë shekullit XVII. Tema e këtij studimi përqendrohet në udhëtimin e Evlija Çelebiut në Kosovë në vitin 1660, gjatë sundimit të Sultan Mehmetit të Katërt. Ky udhëtim përbën një burim të rëndësishëm historik jo vetëm për lëvizjet e vetë udhëtarit, por edhe për njohjen e qyteteve, strukturave shoqërore dhe aspekteve kulturore të rajonit të Kosovës në këtë periudhë. Përmes përshkrimeve origjinale të Çelebiut, bëhet e mundur identifikimi i objekteve të ndryshme historike si kala, xhamitë, hanet, si dhe jetës së përditshme të banorëve të asaj kohe.

PËRSHKRIM I PERSONALITETIT TË EVLIJA ÇELEBIUT

Evlija Çelebi lindi në vitin 1611 dhe vdiq në vitin 1682. Ai jetoi gjatë sundimit të Sulltan Ahmetit I, Sulltan Mustafait I, Sulltan Osmanit II, Sulltan Muratit IV, Sulltan Ibrahimit I dhe Sulltan Mehmetit IV. Pikërisht në kohën e Sulltan Mehmetit të Katërt u realizua udhëtimi i Evlija Çelebiut në Kosovë, pra në vitin 1660.[1] Evlija Çelebiu ishte një udhëtar që vizitoi vende të ndryshme të botës dhe i përshkroi ato në kontekstin historik, letrar dhe kulturor. Ai i filloi udhëtimet e tij në Anadoll gjatë sundimit të Muratit IV dhe për rreth 40 vjet udhëtoi në vende të ndryshme të botës. Për këtë arsye, ai njihet edhe si një eksplorues. Vendet që vizitoi i regjistroi në ditarin e tij të udhëtimit, të cilin e quajti "Seyahatname", që do të thotë libër udhëtimesh.[2]

Evlija Çelebiu ishte një personalitet karizmatik dhe kjo ndikoi në formimin e tij si udhëtar.[3] Arsyeja e udhëtimeve të tij lidhej edhe me përkushtimin e tij shpirtëror ndaj Islamit dhe njohjeve të vendeve të ndryshme në botë.[4] Evlija Çelebiu ishte një njeri i arsimuar, ai përfundoi Medresenë e Shejhylislam Hâmid Efendiut dhe më pas u edukua në Enderun[5] nga dijetarët perandorakë, ku u përfshi në grupin e spahinjve.[6] Kjo e afroi atë me Sulltan Muratin e Katërt dhe e bëri pjesëmarrës në disa prej fushatave ushtarake të tij, si atë të Revanit në vitin 1635 dhe Bagdadit në vitin 1638.[7]

Pjesëmarrja e tij në këto fushata përbën një burim të rëndësishëm historik, pasi ai përshkroi në mënyrë të detajuar rrethimet e Revanit dhe Bagdadit.[8] Pas pushtimit të Bagdadit dhe kthimit në Stamboll, ai filloi të shkruante librin e tij të udhëtimeve. Që nga kjo periudhë, Evlija Çelebiu nisi udhëtime të reja në vende të ndryshme, përfshirë Ballkanin dhe Evropën. Këto udhëtime u përmblodhën në dhjetë vëllime, ndërsa vëllimet 5-8, përfshijnë udhëtimet e Evlijas në territoret shqiptare.[9] Udhëtimi i tij i parë u realizua në vitin 1640 në qytetin e Bursës dhe më pas udhëtimet e Evlijas në pjesë të ndryshme të Evropës dhe Azisë vazhduan edhe më tutje.[10]

UDHËTIMI I EVLIJA ÇELEBIUT NË KOSOVË DHE PËRSHKRIMI I TIJ PËR KOSOVËN

Gjatë udhëtimeve që Evlija Çelebiu realizoi ndërmjet viteve 1640–1676, në ditarin e tij u përfshi edhe Kosova. Sipas veprës së tij “Seyahatname”, të cilën e shkroi në Kajro, Evlija Çelebiu vizitoi Kosovën në vitin 1660, me rastin e vendosjes së Melek Ahmet Pashës në Sofje.[11] Ky udhëtim u zhvillua gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit IV. Gjatë këtij udhëtimi, ai përshkroi qytetet Zveçan, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë dhe Kaçanik, përpara se të vazhdonte drejt qytetit të Shkupit.[12]

Gjatë udhëtimit të tij, Evlija Çelebiu, përshkroi qytetet dhe kontekstin e tyre historik.[13] Kur arriti në qytetin e Mitrovicës, ai shkruan: “Prej andej (duke iu referuar Novi Pazarit), arritëm te kalaja e lartë e Mitrovicës. Ky qytet u çlirua personalisht nga Gazi Hüdavendigari, Sulltan Murati I, i biri i Orhan Gazit.” Me këtë përshkrim, Evlija Çelebiu fillon paraqitjen e kalasë dhe qytetit të Mitrovicës, duke u ndalur kryesisht te historia e tij. Fillimisht ai trajton periudhën paraosmane dhe më pas kalon te historia osmane, duke theksuar se qyteti u morr nga Sulltan Murati I, veçanërisht në vitin 1389, gjatë Betejës së Kosovës. Në këtë kontekst ai shprehet: “Gjatë Betejës së Kosovës, Sulltan Murati vrau me shpatë 700.000 qafirë.”[14]

Në këtë rast, Evlija Çelebiu, për ta madhëruar figurën e Sulltan Muratit I, përdor modelin klasik të kronikave mesjetare duke e ekzagjeruar numrin e pjesëmarrësve dhe të të vrarëve. Më pas ai rrëfen edhe versionet e vrasjes së Sulltan Muratit I, analizon pozicionin e tij në Fushën e Kosovës dhe, duke u mbështetur në rrëfime të ndryshme, paraqet dy versione të kësaj ngjarjeje. Sipas tij: “Ndërsa Murati po shkonte drejt fushëbetejës, ndërkohë që trupat e ushtarëve dëshmorë po mblidheshin buzë lumit Llap, një njeri fatkeq nga radhët e ushtarëve të pabesë, i quajtur Koblaki, u ngrit dhe e vrau atë. Sipas një versioni tjetër, vrasja ndodhi pas betejës, kur i njëjti person u shtir si lajmëtar, iu afrua sulltanit për t’i puthur dorën dhe më pas nxori hanxharin dhe e vrau.”[15]

Në këtë mënyrë, Evlija Çelebiu, përshkruan vdekjen e Sulltan Muratit I dhe e përmend vrasësin me emrin Koblaki.[16] Emri Koblak i referohet Millosh Kopiliqit, megjithatë autori Agon Krasniqi, i referohet si Koblak në punimin e tij. Pas bisedave me banorët e Mitrovicës, ai interesohet për kalanë dhe, për shkak të vrasjes së Sulltan Muratit I, e cilëson atë si

një "kala e pafat". Në përshkrimin gjeografik, Evlija Çelebiu, thekson se kalaja ndodhet në pjesën perëndimore të Fushës së Kosovës dhe ka vetëm një portë. Përveç kalasë, ai përshkruan edhe kontekstin gjeografik të qytetit: "Në rrëzë të kalasë rrjedh një lumë… ky lumë buron nga malet e Ipekut (Pejës), në Shqipëri, bashkohet me lumin Llap dhe më pas derdhet në Moravë. Në këto anë kjo kala njihet si Mitrovica e Kosovës. Ekziston edhe një kala tjetër me emrin Mitrovica e Sremit, por ajo është e shkatërruar."[17] Me këtë përshkrim përfundon edhe paraqitja e qytetit të Mitrovicës nga Evlija Çelebiu.

Në rajonin e Mitrovicës, Evlija Çelebiu, përmend edhe qytetin e Zveçanit. Gjatë qëndrimit të tij në Zveçan, ai na dhuron informacione të rëndësishme nga aspekti shoqëror.[18] Ai përmend teqenë bektashiane të Mustafa Babës, duke theksuar se aty njerëzit mund të kalonin natën në rast nevoje, ashtu siç kishte vepruar edhe vetë. Këtë vend e kishte vizituar bashkë me Melek Ahmet Pashën.[19] Pasha kishte therur kurban dhe mishin e kishte shpërndarë ndër të varfër. Sipas Evlijas, Zveçani ishte pika kufitare ku përfundonte Ejaleti i Bosnjës. Përveç teqesë, ai përmend edhe Xhaminë e Zveçanit, ku "pasha bëri dy sexhde". Sipas tij, në vitin 1660 Zveçani kishte 300 shtëpi me çati me tjegulla, një xhami, një han, një hamam dhe disa dyqane. Gjithashtu, aty ndodheshin edhe dy qendra të administratës osmane.[20]

Pas vizitës në Zveçan, Evlija Çelebiu, udhëtoi për shtatë orë dhe arriti në qytetin e Vushtrrisë, të cilin e përshkruan si "qytet të rrethuar me mure". Si zakonisht, ai fillimisht ndalet te aspekti historik dhe thekson se "qyteti u çlirua personalisht nga Gazi Hüdavendigari në vitin 1389".[21] Nga aspekti administrativ, ai thekson se qyteti kishte funksion sanxhaku dhe ishte i ndarë në zeamete dhe timare. Qyteti kishte një bej, një çeribaş (udhëheqës i një fisi) dhe një kapedan, ndërsa ushtria përbëhej nga 4.000 ushtarë të armatosur. Ai përmend gjithashtu myftiun, nakibüleşrafin (kryetarin e grupit) dhe një kadi me rrogë 150 akçe. Po ashtu, aty gjendeshin edhe "rojtari i spahinjve, një komandant i jeniçerëve, një mbikëqyrës pazari, një mbledhës taksash, një nëpunës tatimor, personalitete të njohura dhe njerëz të rëndësishëm". Nga aspekti shoqëror, Evlija Çelebiu thekson se qyteti përbëhej nga 2.000 shtëpi.[22]

Kur arriti në Prishtinë, ai përmend kontekstin historik të qytetit dhe thekson se "kalaja e Prishtinës është ndërtuar nga mbretërit serbë", ndërsa qyteti "u çlirua nga Sulltan Murati I".

Ai përmend edhe lagjet: Mahalla e Dëshmorëve, Mahalla e Alej-bej-zadesë, Mahalla e Vjetër, Mahalla e Epërme dhe Mahalla e Poshtme. Pranë pazarit ndodhej Xhamia e Vjetër, ndërsa xhamitë e tjera gjendeshin në fshatra. Qyteti kishte gjithashtu një medrese, një teqe, një shkollë dhe disa hane. Evlija Çelebiu përmend edhe hamamin e Vushtrrisë. Duke përshkruar banorët, ai shkruan: "Banorët e Vushtrrisë janë rumelianë. Shumica nuk flasin boshnjakisht, por flasin shqip dhe turqisht."[23]

Pas vizitës në Vushtrri, Evlija Çelebiu u drejtua për në Fushën e Kosovës, vendin ku në vitin 1389 u zhvillua Beteja e Kosovës. Gjatë kësaj vizite, ai vizitoi tyrben e Sulltan Muratit I, për të cilën thotë se "është ndërtuar nga Bajaziti Yıldırım". Ai vëren se gjendja e tyrbes ishte në gjendje jo të mirë dhe e ndotur. "Pasha osman (duke iu referuar Melek Ahmet Pashës) dhuroi dy kese groshë dhe thirri rajën (pastruesin) për ta pastruar tyrben". Evlija Çelebiu, së bashku me Melek Pashën, ngriti një mur rreth saj, mbolli 500 pemë dhe hapi një pus. Kështu, duke u kujdesur për tyrben e sulltanit, e shndërruan atë në një vend të vizitueshëm. Pas kësaj, Evlija Çelebiu vazhdoi udhëtimin drejt Prishtinës.[24]

Kur arriti në Prishtinë, ai përmend kontekstin historik të qytetit dhe thekson se "kalaja e Prishtinës është ndërtuar nga mbretërit serbë", ndërsa qyteti "u çlirua nga Sulltan Murati I". Duke folur për aspektin administrativ, ai thekson se qyteti drejtohej nga një sanxhakbej dhe kishte një kadi me rrogë 150 akçe. Po ashtu, përmend një administrator, një komandant jeniçerësh dhe personalitete të rëndësishme. Nga aspekti gjeografik, ai e vendos Prishtinën në verilindje të Fushës së Kosovës. Nga aspekti shoqëror, Evlija Çelebi përmend se qyteti kishte 2.060 shtëpi (njëkatëshe dhe dykatëshe), gjashtë xhami, një medrese, një shkollë hadithi, një shkollë fillore, teqe, çezme dhe burime publike uji. Ai thekson se në qytet ndodheshin edhe 11 hane, si dhe Hamami i Sulltan Mehmet Fatihut dhe Hamami i Vjetër. Qyteti kishte 300 dyqane,

ku, sipas tij, mund të gjendej çdo gjë. Evlija Çelebiu përmend gjithashtu bukurinë e vajzave dhe djemve të Prishtinës.[25]

Pas vizitës në Prishtinë, Evlija Çelebi udhëtoi drejt fshatit Dobratin, për të cilin thotë se kishte 500 shtëpi, dhe më pas vazhdoi për në Kaçanik. Ai shpjegon se emri Kaçanik rrjedh nga fjala "kaçanlar" (ikësit), pasi disa hajdutë kishin bastisur Shkupin dhe më pas ishin arratisur, por u kapën dhe u vranë në Kaçanik. Ai përmend se pranë lumit Lepenc ndodhej një kala, e ndërtuar nga Sinan Pasha. Sipas tij, "në kala ndodhej një rojtar, një garnizon prej 50 ushtarësh, dy topa dhe një portë. Brenda kishte 40–50 shtëpi për strehimin e ushtarëve, por nuk kishte ndërtesa publike. Jashtë mureve ndodheshin edhe 100 shtëpi të tjera, të gjitha me çati me tjegulla dhe me kopshte." Ai përmend gjithashtu një xhami, një teqe bektashiane, një shkollë fillore dhe një han të madh. Sipas tij, "nuk ka pazar, sepse Shkupi është afër".[26] Për këtë arsye, banorët e këtij vendi i bënin pazaret në Shkup.

Më pas, Evlija Çelebiu vizitoi edhe qytetin e Shkupit. Duke përshkruar Kalanë e Shkupit, ai thekson se "ajo është dykatëshe, e fortë, solide dhe e sigurt, me porta dhe mure të ndërtuara prej guri të ndritshëm, e lartë dhe në formë pesëkëndore".[27] Po ashtu, ai përmend dy medresetë, xhamitë, pazarin dhe dyqanet e qytetit.[28]

Pas vitit 1660, veçanërisht në vitin 1662, Evlija Çelebiu udhëtoi në territoret shqiptare,[29] duke përmendur edhe vendbanime që sot ndodhen brenda kufijve të Kosovës, si Malisheva dhe Gjakova. Fillimisht ai kaloi nëpër Malishevë dhe udhëtoi drejt Tiranës. Gjatë kthimit nga Shqipëria, u ndal në Gjakovë, ku përshkroi malet e Gjakovës dhe ndarjen administrative të qytetit, duke theksuar se ai i përkiste Sanxhakut të Dukagjinit. Fillimisht vizitoi Dukagjinin dhe më pas u ndal në Gjakovë. Në Sanxhakun e Dukagjinit ai përmend Kalanë e Re.[30] Pas vizitës në Dukagjin, ai ndalet në fshatin **Spas**, për të cilin shkruan: "Prej andej u nisëm dhe arritëm në fshatin Spas. Edhe ky i përket Sanxhakut të Dukagjinit. Ka 1.000 shtëpi, 1.000 pushkatarë shqiptarë të zgjedhur, një xhami me xhemat, një han dhe 5–10 dyqane, duke formuar një qytet të vogël."[31]

Pas Spasit, Evlija Çelebiu kaloi në Gjakovë, për të cilën përmend dy Gjakova: Gjakovën e Sanxhakut të Dukagjinit dhe Gjakovën e Sanxhakut të Pozhegës. Sipas tij, Gjakova ishte "një qytet me 2.000 shtëpi, të gjitha prej guri, me çati dhe kopshte, i zhvilluar dhe tërheqës. Drejtohej nga një bej dhe kishte një kadi me rrogë 150 akçe. Ndërtesat publike ishin të shtrira në një hapësirë të gjerë. Ndër to kishte xhami të mëdha e të zbukuruara, disa dergaha, disa hane me çati plumbi të pajisura me ushqime dhe municione, një hamam të këndshëm dhe rreth 300 dyqane si fole bilbilash. Për shkak të klimës së butë, djemtë e rinj janë shumë të bukur.[32]

Në këtë mënyrë, Evlija Çelebiu e përshkruan qytetin e Gjakovës pas vizitës së tij në vitin 1662 dhe kështu përfundon udhëtimi i Evlija Çelebiut në Kosovë.

---

1 Mücteba Ilgürel, "Evliya Çelebi", Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 11, Istanbul: Diyanet Yayın Vakıfları, 1995, f.529.

2 Nuran Tezcan, "Evliya Çelebi Seyehatnamesi'nin Hammer-Purgstall Tarafından Bilim Dünyasına Tanıtılması Hakkında", *Osmanlı Araştırmaları / The Journal of Ottoman Studies*, Sayı 34 (2009), f.16.

3 Ilgürel*, "Evliya* Çelebi*"*, f.530.

4 Abdula, S. (Ed.). (2025). Agon Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660". In *4th International Balkan Studies Congress Proceedings: Vol. Proceedings 04* (pp. 271). Idefe Publications. https://doi.org/10.5331/

5 Enderun: Shërbimi i brendshëm perandorak, brenda pallatit Topkapi në Stamboll.

6 Spahi-sipahi-spahinjët: kalorësit osman.

7 Ziya Yilmazer, *"Murad IV"*, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 31, Ankara: Diyanet Yayın Vakıfları, 2020, f.189.

8 Nuri ***Ö****zcan, "Murad IV"*, Diyanet Islam Ansiklopedisi, cilt 31, Ankara: Diyanet Yayın Vakıfları, 2020, f.193.

9 Ülkü Çelik Şavk, *Sorularla Evliya Çelebi: insanlık tarihine yön veren 20 kişiden biri*, (Ankara: Hacettepe Üniversitesi, 2011), f.102.

10 Tezcan, "Evliya Çelebi, f.203

11 Evliya Çelebi, *Evliya* Çelebi *Seyahatnamesi cilt 7*, Istanbul: *Yapi Kredi Yayinlari, 2002), f.* 59.

12 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.11*

13 Mark Krasniqi, *Kosova në udhëpërshkrimin e Evliya* Çelebiut, Gjurmime, f. 320.

14 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.13-14.*

15 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.15;* Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 276.

16 Referim për Millosh Kopiliqin. Në studimin e autorit Agon Krasniqi në librin e kongresit të studimeve ballkanike, studiuesi Agon Krasniqi ka nxjerurr në pah se një nga emrat e vrasësit të Muratit të parë ishte Koblaki, figura e njëjtë që sot i referohemi si Millosh Kopiliqi.

17 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.16*

18 Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 277.

19 Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 277.

20 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.17.*

21 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.17.*

22 Evliya Çelebi, *Evliya* Çelebi *Seyahatnamesi cilt 5*, Istanbul: *Yapi Kredi Yayinlari*, 2002), f. 42.

23 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.18.*

24 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.19.*

25 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.20.*

26 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.22.*

27 Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 279.

28 Mariya Leontiç, *Evliya* Çelebi'nin *Seyahatname'sinde Makedon* şehirleri *ve onlarin tasviri*, Bal Tam, 2013, f. 85.

29 Franz Babinger, E*wliya Tschelebi's Reisewege in Albanien, Aüfsatze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante 2*, 1955, f. 89.

30 Dankoff dhe Robert Elssie, *Evliya Çelebi, f.20.*

31 Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 280.

32 Krasniqi, "Evliya Çelebi'nin Kosova'daki Seyahati – 1660", f. 280.

"Xhamia në Gjermon të Zgatarit – një gur i ri në mozaikun fetar të Opojës"

Ramadan Shkodra

Opoja njihet për një trashëgimi të pasur fetare, e cila shtrihet ndër shekuj, që nga koha e valiut të njohur Mehmet Kuklibeut, i cili kishte vënë themelet e një sërë vakëfesh në Opojë dhe më gjerë. Kjo traditë e kultivimit të jetës fetare është ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi deri në ditët tona.

Të gjitha vendbanimet e kësaj treve kanë xhami të bukura, të cilat jo vetëm identifikojnë fshatrat e Opojës, por njëkohësisht dëshmojnë për përkushtimin fetar dhe kulturën shpirtërore të banorëve të saj.

Një ndër objektet më të reja të kultit është xhamia e ndërtuar para dy vitesh në fshatin Zgatar, në vendin e quajtur Fusha e Gjemronit. Ajo është ngritur nga ndërmarrësit dhe bashkëshortët haxhi Karanfil dhe Sadbere Ibishi, të cilët paraprakisht kishin investuar në këtë zonë në ndërtimin e një kompleksi kampingu turistik. Përballë këtij kompleksi ata ndërtuan edhe një xhami të vogël, por shumë të bukur, duke i dhënë kësaj hapësire një dimension të veçantë shpirtëror dhe kulturor.

Objekti i xhamisë ka një sipërfaqe rreth 40 metra katrorë (6.50 x 6.00 m), ndërsa minarja arrin një lartësi rreth 11 metra. Xhamia është ndërtuar me gur dhe me një stil arkitektonik që i ngjan xhamive tradicionale shqiptare. Edhe pse me përmasa modeste, ajo është realizuar me shumë përkushtim dhe shije estetike, duke u shndërruar në një objekt tërheqës me vlera të veçanta arkitektonike.

Sot kjo xhami është në funksion të besimtarëve që vizitojnë këtë trevë, duke shërbyer jo vetëm si vend për kryerjen e riteve fetare, por edhe si një pikë atraktive për vizitorët dhe

turistët, falë pamjes së saj dhe vendndodhjes në një zonë të bukur natyrore.

Treva e Opojës në përgjithësi shquhet për një mozaik të pasur xhamish me vlera historike dhe arkitektonike. Ndër më të njohurat është Xhamia e Kukli-Begut në Bresanë, e cila konsiderohet një ndër xhamitë më të vjetra në Kosovë dhe përfaqëson një trashëgimi të rëndësishme të periudhës së hershme të ndërtimit të objekteve fetare në këtë anë.

Po në Bresanë gjendet edhe Xhamia e re, e cila shquhet si një ndër xhamitë më të mëdha në Kosovë dhe e para në vend e ndërtuar me katër minare, duke u bërë një simbol i rëndësishëm arkitektonik dhe fetar për gjithë trevën e Opojës.

Ndërkohë, Xhamia në Buzez njihet për minaren e saj të gjatë dhe elegante, e cila i jep këtij objekti një pamje të veçantë dhe mjaft të bukur.

Në këtë mozaik të pasur tashmë bën pjesë edhe xhamia e ndërtuar në Fushën e Gjermonit në Zgatar, e cila për nga përmasat konsiderohet ndër më të voglat në Kosovë, ndoshta edhe në rajon. Pikërisht kjo veçanti, e kombinuar me realizimin e saj të kujdesshëm arkitektonik dhe vendndodhjen pranë një kompleksi turistik, e bën atë një objekt interesant dhe mjaft tërheqës.

> Treva e Opojës në përgjithësi shquhet për një mozaik të pasur xhamish me vlera historike dhe arkitektonike.

Tradita e ndërtimit të veprave fetare në Opojë vazhdon kështu nga koha e Kuklibeut e deri në ditët tona. Pas përfundimit të ndërtimit, ndërtuesit jo vetëm që përfunduan objektin, por dhuruan edhe truallin përreth dhe e vakëfuan atë në Bashkësinë Islame të Kosovës – Këshilli i Bashkësisë Islame në Dragash, një veprim që meriton vlerësim dhe shërben si shembull i mirë për të tjerët.

Nëse ju jepet rasti ta vizitoni këtë vend, padyshim se ia vlen, sepse aty ndërthuren bukuria e natyrës, tradita dhe përkushtimi ndaj besimit.

Kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus qëndroi për vizitë në Kosovë

Kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus, më 3 mars 2026, qëndroi për vizitë zyrtare në Kosovë. Ai fillimisht u prit në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij.

Myftiu Tërnava i uroi mirëseardhje dr. Arpagus-it, duke uruar për agjërim dhe ibadete të pranuara.

VIZITA NË KRYESINË E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, kryetari i DIJANET-it, prof. dr. Safi Arpagus, fillimisht u prit në takim zyrtar nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnava, potencoi bashkëpunimin e shkëlqyer vëllazëror ndërmjet dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe DIJANET-it, si dhe ndërmjet dy popujve, duke e cilësuar atë si një model të mirëkuptimit dhe solidaritetit të ndërsjellë. Myftiu Tërnava, shprehu falënderim të veçantë për mbështetjen që ka dhënë përgjatë viteve DIJANET-i në projekte të ndryshme, e më kulmorja e tyre tanimë ndërtimi i Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Ai po ashtu e falënderoi kryetarin dr. Arpagus për kontributin e DIJANET-it në restaurimin e disa xhamive dhe objekteve të tjera me rëndësi, si dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm, me theks të veçantë në fushën e mësim-besimit.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnava, edhe njëherë shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për realizimin e projekteve të përbashkëta në frymën vëllazërore, gjithnjë për të mirën e besimtarëve myslimanë, si dhe për forcimin e mëtejmë të lidhjeve institucionale.

Nga ana e tij, kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus, e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe për angazhimin e tij të palodhshëm dhënë për mirëqenien e besimtarëve myslimanë në Kosovë. Ai vlerësoi lart institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe rolin e Myftiut Tërnava për ruajtjen e traditës islame, si dhe për kultivimin e vlerave fetare. Kryetari Arpagus, shprehu gatishmërinë e institucionit që ai drejton për thellimin e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovë në fusha me interes për besimtarët myslimanë.

VIZITA E XHAMIVE TË VJETRA TË PRISHTINËS

Pas vizitës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus, i shoqëruar edhe nga delegacioni i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, vizitoi xhamitë e vjetra të kryeqytetit, Xhaminë "Sulltan Mehmet Fatih", Xhaminë "Jashar Pasha" dhe Xhaminë e Çarshisë.

Ai me këtë rast ju priu besimtarëve në namazin e drekës në Xhaminë "Sulltan Mehmet Fatih", ku më pas edhe mbajti një fjalim të shkurtër, gjatë së cilit uroi besimtarët myslimanë për muajin e bekuar Ramazan, si dhe përcolli selamet nga populli mik turk.

VIZITA NË PUNISHTEN E XHAMISË QENDRORE NË PRISHTINË

Xhamia Qendrore në Prishtinë, ishte ndalesa e radhës e kryetarit të DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus. Ai, së bashku edhe me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnava, panë nga afër punimet në ndërtimin e Xhamisë Qendrore, e cila financohet nga populli mik turk.

Kryetari Arpagus u shpreh tejet i kënaqur me ecurinë e punimeve, teksa Myftiu Tërnava, edhe njëherë shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për ndërtimin e kësaj xhamie.

IFTARI NË PRIZREN

Organizuar nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, në mbrëmje, në Prizren u shtrua edhe iftari, në të cilin, përpos mysafirëve të shumtë nga sfera politike, kulturore dhe fetare, morën pjesë edhe kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Safi Arpagus, i shoqëruar edhe nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava.

Në fjalimin e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnava, shprehu edhe njëherë falënderimet e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për popullin mik turk për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë për popullin e Kosovës në periudha të ndryshme. Ai tha se kjo përkrahje kulmoi me financimin e ndërtimit të Xhamisë Qendrore në Prishtinë.

Kryetari i DIJANET-it, dr. Safi Arpagus, në fjalën e tij përcolli selamet e popullit të Turqisë, me lutjet drejtuar Krijuesit për agjërim dhe ibadete të pranuara. Ai tha se sonte ndihet tejet i kënaqur që është së bashku me besimtarët nga Kosova në këtë iftar të përbashkët.

Fjalë rasti në këtë iftar mbajtën edhe ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Sabri Tung Angili, zv.kryeministri, z. Fikrim Damka dhe nënkryetarja e Kuvendit, znj. Emilie Rexhepi.

NAMAZI I TERAVIVE NË MAMUSHË

Pas iftarit të shtruar në Prizren, kryetari i DIJANET-it, dr. Safi Arpagus, i shoqëruar edhe nga delegacioni i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, vazhdoi vizitën e tij në Mamushë. Ai para besimtarëve të shumtë, mbajti një ligjëratë të shkurtër, ku më pas edhe iu priu atyre në namazin e teravive.

Përgatiti: Bajram Zeqiri

PRESIDENTJA E KOSOVËS, ZNJ. VJOSA OSMANI SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA

Më 18 mars 2026, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, për nder të muajit Ramazan, shtroi iftar për kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnava dhe delegacionin e tij.

Presidentja Osmani theksoi se zemërgjerësia që manifestohet këtë muaj është një kujtesë e fuqishme për rëndësinë e solidaritetit, të përulësisë dhe të përkushtimit ndaj njëritjetrit. Më tej, presidentja shprehu falënderimin e saj të thellë për kontributin e vazhdueshëm të BIK-ut, në kultivimin e vlerave të paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit ndërmjet qytetarëve tanë.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnava, falënderoi presidenten znj. Osmani, për shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të kontribuuar për mirëqenien e gjithë qytetarëve në vend.

KRYEMINISTRI KURTI SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA

Më 14 mars 2026, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, për nder të muajit Ramazan, shtroi iftar për Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij. Kryeministri Kurti duke shprehur respektin për devotshmërinë dhe vetëpërmbajtjen e agjëruesve gjatë Ramazanit, uroi që sakrifica e tyre të shpërblehet, si dhe solidariteti dhe ndjeshmëria ta forcojnë edhe më shumë besimin dhe mirëkuptimin ndërmjet njerëzve. Ai falënderoi Myftiun Tërnava dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për angazhimin dhe kontributin e tyre për shoqërinë dhe vendin.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, uroi kryeministrin për mandatin e ri, duke i dëshiruar suksese dhe punë të mira për vendin. Ata diskutuan për vazhdimin dhe thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, Z. BEDRI HAMZA, SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA

Më 11 mars 2026, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Bedri Hamza, shtroi iftar për Myftiun Naim ef. Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij.

Kryetari Hamza shprehu mirënjohje për rolin e rëndësishëm që Bashkësia Islame e Kosovës ka luajtur në ruajtjen e vlerave shpirtërore, solidaritetit dhe harmonisë në shoqërinë tonë. Ai theksoi se muaji Ramazan është kohë reflektimi, bashkimi dhe solidariteti, duke nënvizuar se këto vlera janë thelbësore për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të mirë.

Gjithashtu, ai falënderoi Myftiun Tërnava dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e tyre në promovimin e tolerancës fetare dhe ruajtjen e harmonisë ndërfetare, duke shprehur respektin e Partisë Demokratike të Kosovës për Bashkësinë Islame dhe për gjithë besimtarët myslimanë. Me këtë rast, ai uroi që muaji i shenjtë Ramazan të jetë muaj paqeje, solidariteti, mirëkuptimi dhe begatie për të gjithë.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnava falënderoi kryetarin Hamza dhe Partinë Demokratike të Kosovës për shtrimin e iftarit, duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kultivimin e traditave fetare dhe kombëtare.

KRYETARI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, Z. LUMIR ABDIXHIKU SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA

Më 17 mars 2026, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Lumir Abdixhiku, shtroi iftar për Myftiun Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij.

Me këtë rast, kryetari Abdixhiku uroi të gjithë besimtarët agjërues, me shpresën që përkushtimi, sakrifica dhe lutjet e tyre të jenë pranuar nga Krijuesi.

Ai theksoi se Ramazani është muaj reflektimi dhe përforcimi të vlerave që bashkojnë shoqërinë, si solidariteti, mirëkuptimi, toleranca dhe respekti i ndërsjellë, të cilat mbeten themel i bashkëjetesës dhe i një shoqërie të drejtë e harmonike.

Abdixhiku shtoi se qytetarët tanë kanë dëshmuar vazhdimisht kulturë të lartë humane e vëllazërore, duke qëndruar pranë njëri-tjetrit dhe duke ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë.

Myftiu Tërnava e falënderoi kryetarin Abdixhiku për shtrimin e këtij iftari tashmë tradicional.

MYFTIU TËRNAVA SHTROI IFTARIN TRADICIONAL PËR NDER TË NATËS SË BEDRIT

Më 7 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, shtroi iftar për udhëheqësit e Këshillave të Bashkësisë Islame, administratën dhe nëpunësit fetarë.

Ky organizim tradicional u mbajt në Medresenë “Alauddin”, në natën e Betejës së Bedrit, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë islame.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnava tha se Ramazani është muaj që bashkon besimtarët dhe sjell begati shpirtërore, ndërsa falënderoi të gjithë të angazhuarit për punën e tyre në të mirë të besimtarëve dhe Islamit. Ai theksoi se nga kjo ngjarje historike mund të nxirren mesazhe simbolike për qëndresën dhe besimin.

Ky iftar, i shtruar tash e disa vite nga Myftiu Tërnava, është shndërruar në një traditë që bashkon të gjithë në tryezën e iftarit dhe vlerëson angazhimin e secilit nëpunës.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME

Më 10 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnava, mori pjesë në iftarin e shtruar nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, ku ishin të pranishëm drejtuesit e institucionit, ish-dekanë, ish-profesorë, stafi akademik, studentë dhe mysafirë të tjerë.

Të pranishmit i përshëndeti dekani i Fakultetit, dr. Islam Hasani, i cili vlerësoi punën dhe angazhimin e profesorëve dhe studentëve.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnava përgëzoi drejtuesit e Fakultetit për organizimin e iftarit dhe theksoi rolin e rëndësishëm të këtij institucioni në edukimin fetar e akademik të brezave të rinj.

Ai vlerësoi kontributin e Fakultetit në formimin e kuadrove të dijes islame, si dhe përkushtimin e profesorëve e studentëve në ruajtjen e vlerave islame dhe forcimin e solidaritetit e bashkëpunimit.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTRIN NË QEVERINË E MALIT TË ZI, ERNAD SULJEVIĆ

Më 3 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal dhe të Investimeve dhe Bashkëpunimit me OJQ-të në Qeverinë e Malit të Zi, Ernad Suljević, të shoqëruar nga ambasadori Bernard Qoqaj dhe delegacioni përcjellës.

Gjatë takimit, Myftiu Tërnava e njohu ministrin Suljević me historikun e Bashkësisë Islame të Kosovës, rrugëtimin e saj institucional, sfidat dhe kontributin në ruajtjen e identitetit fetar e kombëtar.

Ai veçoi angazhimet e BIK-ut në arsimin fetar, veprimtarinë humanitare, botimet, ndërtimin dhe restaurimin e objekteve fetare, si dhe në promovimin e paqes, dialogut dhe bashkëjetesës ndërfetare.

Nga ana e tij, ministri Suljević vlerësoi rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame në jetën shoqërore, duke shprehur gatishmëri për bashkëpunim në projekte me interes të përbashkët.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM TË NGARKUARËN ME PUNË NË AMBASADËN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, ZNJ. ANU PRATTIPATI

Më 4 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në një takim të veçantë të ngarkuarën me punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, znj. Anu Prattipati.

Në takim u adresuan tema, si: roli dhe kontributi i Bashkësisë Islame të Kosovës në avancimin e të drejtave dhe lirive fetare në vend, si dhe angazhimi i saj i vazhdueshëm në promovimin e tolerancës, dialogut ndërfetar dhe bashkëjetesës në shoqërinë kosovare.

Myftiu Tërnava e falënderoi znj. Prattipati për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Kosovës dhe institucioneve të saj, duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame për të qenë faktor stabiliteti, paqeje dhe mirëkuptimi në vend. Myftiu Tërnava theksoi se Kosova është një shembull i harmonisë fetare, ku besimtarët e feve të ndryshme bashkëjetojnë në paqe dhe respekt.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIN E SHOQATËS “AL MUBARRAH INTERNATIONAL CHARITABLE ASSOCIATION”, Z. ABDULLAH AL KABI

Më 4 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim z. Abdullah al Kabi, përfaqësues i Shoqatës “Al Mubarrah International Charitable Association” nga Emiratet e Bashkuara Arabe, me të cilin bisedoi për bashkëpunimin dhe aktivitetet humanitare gjatë muajit Ramazan.

Gjatë takimit, Myftiu e falënderoi z. Al Kabi për mbështetjen dhe ndihmat e ofruara, duke vlerësuar solidaritetin dhe përkujdesjen ndaj familjeve në nevojë.

Ai theksoi se këto veprime humanitare janë në frymën e Ramazanit dhe forcojnë ndjenjën e vëllazërisë dhe përkrahjes mes besimtarëve.

Nga ana e tij, z. Al Kabi shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe thellimin e aktiviteteve bamirëse në të ardhmen.

SHOQATA HUMANITARE "SHËRBEHU" DHUROI 15.000 EURO PËR BLERJEN E LIBRAVE FETARË TË BOTUARA NGA BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS

Më 12 mars 2026, përfaqësuesi i Shoqatës Humanitare "Shërbehu" në Kosovë, z. Fatos Rexhepi, dhuroi një donacion në vlerë prej 15.000 euro për blerjen e librave fetarë të botuara nga Bashkësia Islame e Kosovës. Këta libra do të shpërndahen falas nëpër xhemate të ndryshme.

Myftiu Tërnava e falënderoi z. Rexhepi dhe shoqatën "Shërbehu" për këtë kontribut të çmuar, duke theksuar se mbështetja në fushën e librit dhe dijes është një investim i rëndësishëm për edukimin e shoqërisë dhe për forcimin e vlerave shpirtërore.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 12 mars 2026, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnava. Myftiu Tërnava fillimisht ju dëshiroi agjërim dhe ibadete të pranuara të gjithë anëtarëve dhe mbarë besimtarëve myslimanë.

Gjatë kësaj mbledhje, Kryesia shqyrtoi dhe miratoi raportin e Kryesisë për vitin 2025, shqyrtoi dhe miratoi pasqyrën financiare për vitin 2025, si dhe shqyrtoi dhe miratoi llogaritë përfundimtare të Këshillave të BI-së për vitin 2025.

Gjatë kësaj mbledhje po ashtu u diskutua edhe për përgatitjet e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila u caktua të mbahet më 28 mars 2026, si dhe u diskutuan lëndë të ndryshme nga kompetencat e Kryesisë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DELEGACIONIN NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E VAKËFEVE TË REPUBLIKËS SË TURQISË

Më 13 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim një delegacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Republikës së Turqisë, i përbërë nga Mehmet Ali Palalı, drejtor i Vakëfeve për rajonin e Şanlıurfës, Adem Bacanlı, drejtor i Vakëfeve për rajonin e Malatyas, si dhe Mehmet Batuhan Geçer, zyrtar nga Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë në këtë institucion.

Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, si dhe për mundësitë e thellimit të tij në të ardhmen.

Myftiu Tërnava shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që kjo drejtori i ka dhënë Kosovës, veçanërisht përmes projekteve dhe ndihmave në fushën fetare, humanitare dhe kulturore, me theks të veçantë në restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ai falënderoi posaçërisht edhe për pakot ushqimore dhe iftaret e shumta të organizuara gjatë muajit të bekuar Ramazan, duke theksuar ndikimin e rëndësishëm të këtyre projekteve në jetën fetare dhe shoqërore në vend.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e delegacionit turk shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe realizimin e projekteve të reja në shërbim të besimtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PRESIDENTIN E FONDACIONIT "DRITA", Z. ZEF GASHI

Më 16 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim presidentin e Fondacionit "Drita", z. Zef Gashi.

Gjatë takimit u diskutua organizimi i Tryezës së dialogut ndërfetar me temën "Bashkëjetesa ndërfetare ndër ne, virtyt hyjnor apo domosdoshmëri shoqërore?", e cila pritet të mbahet gjatë muajit prill. Kjo Tryezë organizohet nga Fondacioni "Drita", ndërsa nikoqire sivjet do të jetë Bashkësia Islame e Kosovës. Myftiu Tërnava shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për mbajtjen e kësaj Tryeze, duke theksuar parimet fetare për dialog dhe bashkëjetesë ndërfetare.

Në takim morën pjesë edhe grupet punuese nga të dyja palët, të cilat njoftuan për ecurinë e përgatitjeve për organizimin e kësaj Tryeze.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E FONDACIONIT TË GRUAS "SHEIKHA FATIMA BINT MUBARAK"



Më 19 mars 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim drejtoreshën e Fondacionit të Gruas "Sheikha Fatima bint Mubarak", znj. Miradije Salihu, si dhe koordinatorin e këtij fondacioni, z. Ibrahim Fadlalla.

Gjatë takimit u diskutua për aktivitetet dhe projektet që zhvillon ky fondacion, me theks të veçantë në mbështetjen e grave dhe familjeve në nevojë, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Myftiu Tërnava vlerësoi angazhimin dhe kontributin e Fondacionit në realizimin e projekteve humanitare dhe sociale, duke shprehur mirënjohje për ndihmën e vazhdueshme që ai ka ofruar.

Nga ana e saj, znj. Salihu falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm, duke theksuar gatishmërinë për thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit.

KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 28 mars 2026, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt, e cila u hap dhe u kryesua nga kryetari i Kuvendit, Ajni ef. Sinani.

Gjatë mbledhjes, anëtarët e Kuvendit diskutuan dhe miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, si dhe trajtuan çështje të tjera të ngritura nga anëtarët.

Myftiu Naim ef. Tërnava vlerësoi angazhimin institucional gjatë muajit Ramazan dhe në jetën fetare në përgjithësi. Ai veçoi aktivitetet humanitare të shoqatës "Bereqeti", përmes së cilës janë ndihmuar rreth 30 mijë familje, si dhe përmendi angazhimin e departamenteve të ndryshme, përfshirë Departamentin e Gruas.

Në kuadër të mbledhjes, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi raportin e punës së Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin 2025, raportin e Komisionit Financiar, si dhe pasqyrën e të hyrave dhe të dalave për vitin 2025.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SAMITIN E 10-TË TË KRYETARËVE TË BASHKËSIVE FETARE ISLAME TË SHTETEVE TË BALLKANIT

Më 31 mars 2026, nën organizimin e DIJANET-it të Turqisë, në Shkup, u mbajt Samiti i 10-të i kryetarëve të bashkësive islame fetare të shteteve të Ballkanit, në të cilën morën pjesë myftinjë, kryetarë dhe përfaqësues të institucioneve fetare nga vendet e Ballkanit. Nikoqire e këtij Samiti ishte Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në krye me reisin, Shaqir ef. Fetahu.

Tema boshte e këtij Samiti qe "Roli dhe ndikimi i bashkësive fetare në përforcimin e kulturës dhe bashkëjetesës në vendet e Ballkanit".

Në ceremoninë hapëse të këtij Samiti, morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore dhe fetare, të cilët u uruan mysafirëve mirëseardhje, si dhe përgëzuan organizatorët për organizimin e këtij Samiti, duke e vlerësuar atë si tejet të qëlluar dhe të nevojshëm për kohën.

I pranishëm nga Kosova në këtë Samit qe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i cili mbajti kumtesën e tij me titull "Roli integrues dhe transformues i bashkësive islame në Ballkan në promovimin e paqes së qëndrueshme, dialogut ndërfetar dhe kohezionit shoqëror".

Ai tha se ky Samit nuk është vetëm një hapësirë diskutimi, por një platformë strategjike për thellimin e dialogut, për shkëmbimin e përvojave institucionale, dhe për ndërtimin e një vizioni të përbashkët mbi sfidat dhe mundësitë që kemi përpara.

Myftiu Tërnava foli edhe për rolin dhe historikun e Ballkanit, duke thënë se ai përfaqëson një hapësirë unike gjeokulturore dhe historike, ku ndër shekuj janë ndërthurur sfida të mëdha, por edhe shumë përvoja të bashkëjetesës.

Duke folur për rolin e bashkësive islame të Ballkanit, ai tha se ato kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të veçantë në ndërtimin dhe ruajtjen e këtij ekuilibri delikat, ndërkulturor dhe ndërfetar. Në këtë mozaik të ndjeshëm dhe të pasur, bashkësitë islame kanë qenë dhe mbeten pjesë përbërëse e identitetit të tij historik, kulturor, fetar dhe etik.

Myftiu Tërnava, foli edhe rreth rolit që kanë dhënë shqiptarët në bashkëjetesën ndërmjet besimeve të ndryshme.

"Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e besimtarëve islam në Ballkanin Perëndimor i përkasin popullit shqiptar, vlen të theksohet se shqiptarët, historikisht i takojnë tri besimeve kryesore fetare. Në vazhdimësi, shqiptarët pa dallim besimi, kanë ndërtuar dhe ruajtur një traditë të qëndrueshme të bashkëjetesës ndërfetare. Kjo traditë është karakterizuar nga mungesa e konflikteve mbi baza fetare, nga respekti i ndërsjellë për përkatësinë shpirtërore të tjetrit, dhe nga një kulturë e konsoliduar harmonie dhe mirëkuptimi shoqëror" – pohoi ndër të tjera Myftiu Tërnava.

Myftiu Tërnava më pas tha se bashkësitë islame në Ballkan mund të jenë ura besimi, ura ndërmjet komuniteteve, ura ndërmjet traditës dhe modernitetit, ura ndërmjet identitetit fetar dhe përgjegjësisë qytetare, ura ndërmjet dallimeve-divergjencave dhe harmonisë.

"Ky mision, i rrënjosur thellë në traditën shpirtërore dhe institucionale, është mishëruar ndër shekuj nga institucionet tona, të cilat me përkushtim kanë kultivuar vlerat e drejtësisë, mëshirës, bashkëjetesës dhe përgjegjësisë shoqërore. Në këtë kuptim, angazhimi ynë i sotëm nuk është thjesht një përgjigje ndaj sfidave bashkëkohore, por një vijimësi organike e një trashëgimie të pasur dhe të qëndrueshme, e cila na obligon të veprojmë me vizion, urtësi dhe përgjegjësi në shërbim të së mirës së përbashkët" – tha ndër të tjera Myftiu Tërnava.

Myftiu Tërnava, në fund të fjalës së tij përmendi edhe qëllimet që duhet të kenë bashkësitë islame, ndër të cilat përmendi: ndërtimi i një kulture të qëndrueshme paqeje. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm mbi mungesën e luftës, por mbi praninë e besimit të ndërsjellë. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm në marrëveshje formale, por në edukim moral. Një paqe, që nuk mbështetet vetëm në heshtjen e tensioneve, por në shërimin e tyre përmes drejtësisë, respektit dhe urtësisë.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS SHTROI IFTAR NË BUJANOC

Më 4 mars 2026, organizuar nga Bashkësisë Islame e Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Bujanoc, u shtrua iftari tradicional për qytetarët e Bujanocit.

Në këtë iftar, përveç besimtarëve të shumtë, morën pjesë edhe kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kryetari i Këshillit të BI-së së Bujanocit, Sulejman ef. Fejzullahu, i ngarkuari me punë në Zyrën e Kosovës në Beograd, z. Jetish Jashari, udhëheqës të institucioneve, afaristë, mjekë, mësimdhënës, hoxhallarë etj..

Ky iftar, tashmë tradicional, shpreh përkushtimin ndaj unitetit, solidaritetit dhe vlerave shpirtërore, të cilat na bashkojnë gjatë gjithë muajit të bekuar Ramazan.

Pas iftarit, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, vizitoi Xhaminë e Mesme në Tërnoc, ku mbajti një ligjëratë dhe iu priu besimtarëve në namazin e teravive, ndërsa anëtari i Kryesisë së BI-së, Agim ef. Hyseni, vizitoi Xhaminë në Letovicë, si dhe Mustafë ef. Dallku, vizitoi Xhaminë e Struktarëve.

DELEGACIONI I KRYESISË SË BIK-UT U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARJA E PRESHEVËS, ZNJ. ARDITA SINANI

Më 9 mars 2026, një delegacion i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i përbërë nga kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në BIK, z. Ramadan Shkodra, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, dr. Islam Hasani, si dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Preshevës, Nexhmedin ef. Ademi, u pritën në takim nga kryetarja e Preshevës, znj. Ardita Sinani.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që ka Bashkësia Islame në ruajtjen e harmonisë shoqërore, promovimin e vlerave humane dhe forcimin e unitetit në komunitet.

Ky takim u zhvillua në një atmosferë vëllazërore në frymën e Ramazanit, gjithnjë duke reflektuar mbi vlerat e solidaritetit, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

NË PRESHEVË U SHTRUA IFTARI TRADICIONAL "SOFRA E RAMAZANIT"

Më 9 mars 2026, në Preshevë u shtrua iftari tradicional "Sofra e Ramazanit", i organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, me pjesëmarrjen e delegacionit të BIK-ut, përfaqësuesve të Këshillit të BI-së së Preshevës, institucioneve lokale, imamëve veteranë dhe besimtarëve të shumtë.

Të pranishmit i përshëndeti fillimisht kryetari i Këshillit, Nexhmedin ef. Ademi, i cili falënderoi mysafirët për pjesëmarrjen dhe vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të BIK-ut për organizimin fetar në Luginën e Preshevës.

Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, foli për bashkëpunimin e qëndrueshëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Luginës së Preshevës, si dhe për kontributin e brezave të imamëve në ruajtjen e identitetit fetar e kombëtar. Ai theksoi se mbështetja morale e materiale nga BIK-u ka qenë e vazhdueshme, duke përmendur edhe ndihmën në blerjen e vakëfeve për institucionet islame në Preshevë dhe Bujanoc.

SHOQATA "AL MUBARRAH INTERNATIONAL CHARITABLE ASSOCIATION" SHPËRNDAU PAKO USHQIMORE NË PRISHTINË

Më 4 mars 2026, Shoqata Humanitare Shoqata Humanitare "Bereqeti", në bashkëpunim me shoqatën bamirëse nga Emiratet e Bashkuara Arabe, "Al Mubarrah International Charitable Association", ka shpërndarë 100 pako ushqimore dhe nga 25 kilogramë miell për familjet në nevojë në Prishtinë.

Nga kjo nismë humanitare përfituan jetimë, invalidë dhe raste sociale, të cilët po përballen me vështirësi ekonomike. Në shpërndarje të këtyre pakove, i pranishëm qe edhe përfaqësuesi i shoqatës "Al Mubarrah International Charitable Association", z. Abdullah al Kabi.

DIJANET-I I TURQISË SHPËRNDAU PAKO USHQIMORE

Më 12 mars 2026, në përmbyllje të muajit të bekuar Ramazan, kur solidariteti, mëshira dhe ndihma për njëri-tjetrin marrin një domethënie të veçantë, Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti", në bashkëpunim me DIJANET-in e Turqisë, shpërndau 1200 pako ushqimore për familjet në nevojë në Kosovë.

Vetëm gjatë kësaj dite, në Prishtinë u shpërndanë 200 pako ushqimore për jetimët, rastet sociale dhe kategori të ndryshme të shoqërisë që kanë nevojë për mbështetje. Kjo ndihmë synon të lehtësojë gjendjen e familjeve përfituese dhe të sjellë gëzim në ditët e fundit të Ramazanit.

Ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Tunc Angılı, theksoi gatishmërinë e qeverisë dhe të popullit turk për të qëndruar pranë popullit të Kosovës edhe në këto ditë të bekuara të Ramazanit. Ai tha se vlerat e solidaritetit, bujarisë dhe përkrahjes së ndërsjellë janë virtyte të këtij muaji të shenjtë dhe dëshmi e miqësisë së fuqishme mes dy vendeve tona.

Nga ana tjetër, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, falënderoi qeverinë dhe popullin turk për përkrahjen e vazhdueshme, duke vlerësuar bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tyre për të ndihmuar familjet në nevojë në Kosovë.

Edhe Adelinë Sahiti nga Komuna e Prishtinës vlerësoi lart mbështetjen e Turqisë ndaj Kosovës, duke theksuar se kjo përkrahje nuk kufizohet vetëm në muajin Ramazan, por vazhdon edhe në forma të tjera bashkëpunimi dhe ndihme.

Po ashtu, gjatë muajit Ramazan, DIJANET-i i Turqisë vazhdoi edhe shtrimin e mbi njëmijë e pesëqind iftareve për besimtarët, duke forcuar frymën e bashkimit, afërsisë dhe solidaritetit.

KRYETARJA E KUVENDIT, ZNJ. ALBULENA HAXHIU SHTROI IFTAR PËR PËRFAQËSUESET E DEPARTAMENTIT TË GRUAS SË BIK-UT

Më 12 mars 2026, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu, shtroi një iftar për përfaqësueset e Departamentit të Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Gjatë këtij takimi u vlerësua roli dhe kontributi i grave në shoqëri, si dhe angazhimi i tyre në aktivitete edukative, sociale dhe fetare.

Në kuadër të iftarit, kryetarja Haxhiu, dhe udhëheqësja e Departamentit të Gruas znj. Vaxhide Podvorica Bunjaku, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe të angazhimit të grave në jetën shoqërore dhe institucionale.

VIZITA E DELEGACIONIT TË KRYESISË SË BIK-UT NË DIASPORË GJATË RAMAZANIT

Për nder të muajit të bekuar Ramazan, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës zhvilloi disa vizita zyrtare në diasporë gjatë muajve shkurt dhe mars 2026.

Nga 26 shkurti deri më 2 mars 2026, një delegacion i përbërë nga drejtori për Diasporë Ekrem ef. Simnica, kryeimami Vedat ef. Sahiti, Sulejman ef. Fejzullahu, Valon ef. Myrta, Rexhep ef. Qerkezi dhe Abedin ef. Sadriu qëndroi për vizitë në Zvicër. Gjatë kësaj vizite, delegacioni u shpërnda nëpër xhamitë shqiptare, ku u prit nga përfaqësuesit dhe xhematë të shumtë. Ata përcollën urimet e Ramazanit nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Myftiu Naim ef. Tërnava, si dhe mbajtën ligjërata mbi vlerat e këtij muaji.

Më 2 mars 2026, drejtori i Drejtorisë së Diasporës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga anëtari i Kryesisë së BIK-ut, Valon ef. Myrta, u prit në takim nga konsulli i Kosovës në Cyrih, z. Vigan Berisha. Gjatë takimit u bisedua për mundësinë e shtimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me qendrat shqiptare në Cyrih. Drejtori Simnica e falënderoi konsullin Berisha për pritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, një delegacion tjetër, i përbërë nga dekani i FSI-së, dr. Islam Hasani, dhe anëtari i Kryesisë së BIK-ut, Shkelzen Hoxha, vizitoi Norvegjinë dhe Suedinë. Ata u mirëpritën nga Sabri ef. Jonuzi në Oslo dhe nga imami Burhan ef. Mustafa në Suedi. Gjatë vizitave në xhamitë shqiptare, ata përcollën mesazhe islame për paqe, harmoni dhe afrim te Zoti, duke shprehur edhe mirënjohje për rolin e diasporës në ruajtjen e trashëgimisë fetare e kombëtare. Në kuadër të kësaj vizite u realizuan mbi 10 vizita në xhami.

Nga 11 deri më 16 mars 2026, një delegacion tjetër i Kryesisë së BIK-ut, i përbërë nga Ekrem ef. Simnica, Hetem ef. Sopjani, Muharrem ef. Tërnava, Fitim ef. Flugaj, Fitim ef. Gashi dhe Bahri ef. Sejdiu, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjermani. Delegacioni vizitoi Berlinin, Hamburgun, Hanoverin, Shtutgartin dhe Minhenin, ku u prit nga përfaqësues të xhamive shqiptare dhe xhematë të shumtë. Ata përcollën urimet e Ramazanit dhe mbajtën ligjërata mbi vlerën e dhjetë netëve të fundit të këtij muaji, duke falënderuar diasporën për mikpritjen dhe mbështetjen e vazhdueshme.

Ndërkohë, një delegacion tjetër i BIK-ut, i përbërë nga Orhan ef. Bislimaj dhe Nehat ef. Shehu, zhvilloi aktivitete në Austri, ku vizitoi qendrat islame shqiptare në bashkëpunim me Komunitetin Shqiptar të Bashkësisë Islame në Austri, të udhëhequr nga Vahidin Behluli.

Në total, gjatë këtyre vizitave u realizuan mbi 30 vizita në xhami në Zvicër, mbi 10 në Norvegji e Suedi, si dhe mbi 30 në Gjermani e 8 të tjera në Austri.

Në Kosovë u prit dhe u festua festa e Fitër Bajramit

Besimtarët myslimanë në Kosovë, të premten më 20 mars 2026, festuan festën e Fitër Bajramit, festë kjo që shënon përfundimin e muajit të bekuar Ramazan. Kjo festë vjen si një moment gëzimi, falënderimi dhe reflektimi pas një muaji përkushtimi, sakrifice dhe solidariteti.

Siç tashmë është bërë traditë, manifestimi qëndron kushtuar Fitër Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Ai filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, për të vazhduar më pas me ligjëratën tematike kushtuar kësaj feste, të cilën e mbajti kryemiami i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Ibrahim ef. Beqiri. Programi i festës së Fitër Bajramit u shoqërua edhe me këndimin e pjesëve nga Kurani fisnik dhe ilahive të ndryshme.

Pas kësaj, manifestimi vijoi me faljen e namazit të Fitër Bajramit, të cilit i priu kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ndërsa hytben e Fitër Bajramit, me mesazhin e kësaj feste, e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, i cili përcolli mesazhe paqeje, solidariteti dhe uniteti për të gjithë besimtarët dhe shoqërinë tonë.

Me theks të veçantë, Myftiu Tërnava, në hytben e Fitër Bajramit, u bëri thirrje liderëve politikë për unitet, duke nënvizuar se interesat e shtetit dhe të shoqërisë duhet të vihen gjithmonë në radhë të parë. Festa e Fitër Bajramit shënon jo vetëm fundin e agjërimit, por edhe forcimin e vlerave të bashkëjetesës, mëshirës dhe kujdesit për njëri-tjetrin.

PRITJA PËR URIME NË KRYESINË E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Me rastin e festës së Fitër Bajramit, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në krye me Myftiun e saj, Naim ef. Tërnavën, si tradicionalisht, hapi dyert e saj për të pritur mysafirë të shumtë, të cilët erdhën për të uruar Myftiun Tërnava dhe gjithë besimtarët myslimanë për këtë festë.

E para që erdhi për të uruar myslimanët për festën e Fitër Bajramit, qe presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e shoqëruar nga bashkëpunëtorët e saj, e më pas, Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Myftiun Tërnava, e uruan edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu, me bashkëpunëtorët e saj, kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, me bashkëpunëtorët e tij, ipeshkvi i Kishës Katolike, Dodë Gjergji, kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama, kryetari i PDK-së, z. Bedri Hamza, kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku, kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj, si dhe mysafirë të tjerë të shumtë.

URIMI I PRESIDENTES SË KOSOVËS, ZNJ. VJOSA OSMANI

Ju uroj të gjithë qytetarëve të Republikës sonë, me fat festën e Fitër Bajramit, duke uruar më të mirat për ta, duke shpresuar që Zoti i Madhërishëm t'i ketë pranuar lutjet dhe agjërimin e gjithsecilit, dhe duke shpresuar që kjo ditë, si gjithnjë përgjatë historisë sonë, të na bëjë të gjithëve bashkë, t'i hapë zemrat, t'i hapë dyert e secilit, ta rrisë solidaritetin dhe t'i rrisë vlerat njerëzore, të cilat gjithmonë na kanë bërë bashkë si popull, përfshirë në kohët më të rënda, kur pikërisht ky bashkim, pikërisht hapja e zemrave dhe dyerve, na ka ndihmuar që të tejkalojmë kohë shumë të rënda për shtetin dhe për kombin tonë.

Dua ta falënderoj Myftiun dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij anekënd Kosovës në Bashkësinë Islame të Kosovës për punën e jashtëzakonshme që e bëjnë përgjatë tërë vitit, por në veçanti përgjatë muajit të shenjtë të Ramazanit për të mbështetur familje në nevojë, për t'u siguruar që çdo familje ka begati, ka harmoni, ka mbështetje, ndien dorën e mbështetjes edhe në kohë të rënda.

Dua t'i falënderoj miqtë e aleatët tanë, të cilët shpesh, edhe nëpërmjet shtetit, edhe nëpërmjet Bashkësisë Islame, ndihmojnë familjet në Kosovë.

Dua t'i falënderoj qytetarët tanë zemërgjerë, përfshirë ata nga mërgata jonë, të cilët asnjëherë nuk e mbyllën zemrën, por gjithmonë e hapën atë duke ndihmuar çdo familje që ka nevojë, edhe sot të festojë, por ta ndiejë dorën e solidaritetit edhe përtej festës së Bajramit.

Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani

Edhe njëherë, e falënderoj Myftiun, edhe për bashkëpunimin shumë të mirë e të afërt që e kemi pasur përgjatë këtyre viteve që ka qenë dhe mbetet në interes të Republikës së Kosovës dhe fuqizimit të shtetit tonë, dhe për punën që e bëjnë, që jo vetëm gjatë muajit të Ramazanit dhe festës së sotme të Bajramit, por çdo ditë të vitit qytetarët tanë të ndihen të mbështetur dhe t'i ndiejnë vlerat më të larta njerëzore, siç është solidariteti.

Me fat festën e Fitër Bajramit dhe njëherë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe juve mediave që sot jeni në detyrë si gjithmonë.

URIMI I KRYETARES SË KUVENDIT, ZNJ. ALBULENA HAXHIU

Në këtë ditë të Fitër Bajramit, urova Myftiun Tërnava, si dhe bashkëpunëtorët e tij, sikurse edhe qytetarët e Republikës së Kosovës të besimit islam për festën që kurorëzon një muaj të sakrificës, një muaj të përkushtimit dhe po ashtu një muaj të durimit.

Natyrisht që për qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarët e besimit islam, festa e Fitër Bajramit është një festë shumë e rëndësishme, shumë domethënëse.

Muaji i shenjtë i Ramazanit na mëson durimin, na mëson mirësinë, ndërsa festa e Fitër Bajramit, na mëson se si këto vlera mirësie t'i ndajmë me të tjerët.

Vizita jonë sot këtu në Bashkësinë Islame të Kosovës, është edhe si shenjë respekti për punën, për kontributin që Bashkësia Islame e Kosovës ka bërë për shoqërinë tonë, për shtetin tonë, e sidomos në kultivimin e paqes në bashkëjetesën ndërfetare, në mirëkuptimin, që janë vlera shumë të rëndësishme për shoqërinë, por edhe për Republikën e Kosovës.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, znj. Albulena Haxhiu

Le të na shërbejë kjo festë e Fitër Bajramit si kujtesë, secili nga ne mund të japim shumëçka nga vetja, pikërisht që t'i lartësojmë këto vlera të shoqërisë sonë, dhe pikërisht në këtë mënyrë e forcojmë besimin, por po ashtu e ndërtojmë një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.Me fat Fitër Bajrami! Paqe, shëndet dhe begati për secilën familje!

URIMI I KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS, Z. ALBIN KURTI

Pas muajit të shenjtë të Ramazanit, erdhi Fitër Bajrami. Urime e për hair Bajrami i Madh të gjithë besimtarëve, të gjithë shqiptarëve. Një festë e gëzuar, e cila njëkohësisht na i përkujton vlerat e solidaritetit, të sakrificës, të ndihmës që duhet të japim për ata që kanë më pak, e që ndodhen në kushte më të vështira.

Si çdo vjet, edhe sivjet, si për çdo Bajram, vizitën e parë e bëjmë të Myftiu Naim Tërnava, te kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës, këtu në selinë e tyre në Prishtinë, për t'i falënderuar për angazhimin, punën, rolin, kontributin edhe aktual edhe historik.

Sivjet janë bërë tridhjetë vjet prej se unë njihem personalisht me Myftiun Naim Tërnava dhe unë, asnjëherë nuk e harroj kontributin e tij si udhëheqës i Medresesë "Alauddin", ku mbaheshin atëbotë aktivitete të shumta shoqërore dhe kombëtare në kuadër të rezistencës sonë.

Gjithashtu, sot kujtojmë edhe 37 hoxhallarë, imamë, shehidë, që ranë dëshmorë në luftën çlirimtare.

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti

E falënderoj Myftiun Tërnava për bashkëpunimin që kemi me programet e ndryshme për paqe sociale, për mirëqenie qytetare, me shoqatën "Bereqeti" dhe jo vetëm, dhe njëkohësisht shprehi zotimin tonë që do të bashkëpunojmë gjithnjë më ngushtë e më shumë edhe në të ardhmen.

Edhe një herë urime e gëzuar Fitër Bajrami!

URIMI I IPESHKVIT TË KISHËS KATOLIKE, DODË GJERGJI

Kam kënaqësinë që sot jam këtu në Bashkësinë Islame për të uruar kryemyftiun së bashku me bashkëpunëtorët e tij dhe gjithë besimtarët myslimanë për këtë festë të Fitër Bajramit. Është një moment i mirë që të gjithë së bashku të festojmë. Edhe ne sikur katolikë, jemi në kohën e Kreshmes, në kohën e agjërimit, në kohën e reflektimit, në kohën e lutjes, në kohën e përmirësimit të marrëdhënies sonë me Zotin dhe me njëri-tjetrin.

Kështu që shfrytëzoj rastin t'ju uroj të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë, pavarësisht besimit, katolik apo mysliman, ortodoks apo diçka tjetër. Ne të gjithë kemi paqen, në radhë të parë në zemrat tona, harmoninë dhe lumturinë në familjet tona, mirëkuptimin, paqen dhe rendin e vlerave dhe rregullave në shoqërinë tonë. Mbi të gjitha ju ftoj të gjithë të lutemi për paqe në botë, sepse bota asnjëherë s'ka qenë më e trazuar se sa në këto momente ku ne edhe agjërojmë, edhe festojmë së bashku.

Ipeshkvi i Kishës Katolike të Kosovës, z. Dodë Gjergji

Këndej nuk më mbetet asgjë tjetër, përveçse për të thënë atë që e ka thënë i madhi Fishta: Në të vërtet, ne festojmë Bajram e Pashkë, secili sipas mënyrës së vet, por shqiptarinë e kemi bashkë, dhe të ardhmen duhet ta ruajmë si të tillë. Urime!

URIMI I KRYETARIT TË PRISHTINËS, Z. PËRPARIM RAMA

Sot pata kënaqësinë këtu me ardh dhe me vizitu Myftiun Tërnava, me i urua muajin e shenjtë Ramazan, me ia bë për hair Bajramin, me i falënderua për punën e mrekullueshme që e bën Bashkësia Islame e Kosovës në kryeqytet dhe në gjithë Kosovën për shoqërinë tonë që gjithmonë punojnë për paqe, punojnë për bashkëpunim të mirëfilltë, punojnë për një të ardhme më të ndritshme të vendit tonë, prandaj i falënderova nga zemra. Faleminderit shumë për bashkëpunimin e mrekullueshëm që e kemi së bashku me kryeqytetin.

Uroj që të vazhdojmë edhe tutje, mirë e më mirë.

Urime, urime, të gjithë besimtarëve myslimanë!

Kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama

URIMI I KRYETARIT TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, Z. BEDRI HAMZA

Sot, si gjithherë, bashkë me kolegët nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, jemi në vizitë te Myftiu, me udhëheqësit e Bashkësisë Islame, për t'i uruar për Bajram, njëkohësisht, i urojmë edhe të gjithë besimtarët, duke u dëshiruar shëndet dhe të gjitha të mirat për ta dhe për familjet e tyre. Është muaji i solidaritetit. Populli ynë gjithmonë ka qenë solidarë, është dhe jam i bindur që ky solidaritet edhe në bazë të asaj që na tregon gjithmonë Myftiu, është duke u rritur dhe është tepër mirë që njerëzit në nevojë të përkrahen, ndihmohen, të ketë vizita mes neve, të reflektojmë energji pozitive, dhe ky pozitivitet të jetë në të gjitha institucionet, gjithmonë duke respektuar edhe Bashkësinë Islame, por edhe institucionet e shtetit. Urime për të gjithë besimtarët!

Kryetari i PDK-së, z. Bedri Hamza

URIMI I KRYETARIT TË LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, Z. LUMIR ABDIXHIKU

Sot, me bashkëpunëtorë, uruam Myftiun Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij dhe nëpërmjet tij gjithë komunitetin e besimit islam në Kosovë për festën e Fitër Bajramit. Lutjet dhe agjërimi i muajit të shenjtë të Ramazanit u pranoftë nga Krijuesi. Mbi të gjitha, në këtë periudhë, edhe përtej kësaj periudhe, t'i ruajmë, t'i kultivojmë dhe t'i mbrojmë këto vlera që rëndom i gjejmë gjatë gjithë muajit të shenjtë dhe gjatë festës së Bajramit. Pra, solidariteti ndaj njëri-tjetrit, mbështetja ndaj atyre që janë në nevojë, e unitetit sa më i madh i njerëzve të Republikës së Kosovës.

Zoti e bekoftë Kosovën, popullin tonë dhe familjet tona!

Me fat Bajrami!

Kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku

URIMI I KRYETARIT TË ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS, Z. RAMUSH HARADINAJ

Të dashur qytetarë të Kosovës, bashkëkombës shqiptarë kudo që jeni, edhe fizikisht me kolegët e Aleancës, kisha nderin të jem në selinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, t'i drejtohem Myftiut, z. Tërnava dhe të gjithëve këtu prezentë, me urimet më të mira, gëzuar festa e Fitër Bajramit me përkushtim, ashtu siç e ka karakterizuar edhe muaji i shenjë Ramazan, me unitet, pra që të jemi bashkë, po edhe solidariteti që t'i gjendemi njëri-tjetrit sa më bashkë, sa më solidarë është më mirë për të gjithë ne.

Faleminderit për krejt angazhimin dhe për mundin që bëni.

Gëzuar edhe njëherë!

Përgatiti: Bajram Zeqiri

Kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj

Bashkësia Islame e Kosovës

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame

Fakulteti i Studimeve Islame

SHML "Medreseja Alauddin"

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

MEDRESETË TE SHQIPTARËT

(HISTORI, TRASHËGIMI, KONTRIBUT)

Prishtinë, 29 tetor 2026

FTESË PËR PJESËMARRJE

Drejtuar studiuesve dhe hulumtuesve të fushave përkatëse që, përmes punimeve të tyre akademike, të trajtojnë medresetë, duke ndriçuar trashëgiminë e tyre institucionale, funksionin edukativ dhe ndikimin e tyre shoqëror në hapësirën shqiptare.

Qëllimi i Konferencës

Konferenca synon të analizojë në mënyrë shkencore dhe të argumentuar:

- zhvillimin historik të medreseve në hapësirën shqiptare;
- strukturën institucionale dhe programet mësimore në periudha të ndryshme historike;
- rolin e medreseve në formimin e elitave fetare dhe intelektuale;
- kontributin e tyre në ruajtjen e identitetit fetar, kombëtar, kulturor dhe arsimor.

Tezat boshte

1. Zhvillimi historik i medreseve në trevat shqiptare nga periudha osmane deri në gjysmën e parë të shekullit XX.
2. Roli i medreseve në përhapjen dhe ruajtjen e identitetit fetar, kombëtar, kulturor dhe arsimor te shqiptarët.
3. Roli i medreseve në zhvillimin e mendimit islam dhe formimin e elitave dhe intelektualëve fetarë dhe kombëtarë.
4. Organizimi institucional i medreseve dhe financimi përmes sistemit të vakëfeve.
5. Organizimi i sistemit arsimor dhe literatura mësimore në medresetë e trojeve shqiptare.
6. Myderrizët shqiptarë dhe kontributi i tyre fetar dhe kombëtar.
7. Tradita e ixhazetnameve në medresetë e trojeve shqiptare dhe roli i tyre.

Udhëzime për dërgimin e abstrakteve dhe punimeve

Abstrakti	250–300 fjalë, me 3–5 fjalë kyçe
Afati i fundit për dërgimin e abstrakteve	10 qershor 2026
Njoftimi për pranimin e abstrakteve	10 korrik 2026
Afati për dorëzimin e punimit të plotë	15 shtator 2026
Abstraktet dhe punimet e plota mund të dërgohen në e-mail adresat	instituti.ihsi@gmail.com dhe konferencamedresete@gmail.com

Kriteret reknike

- Punimi i plotë nuk duhet të kalojë 7000 fjalë.
- Fonti: Times New Roman, 12 pt.
- Hapësira ndërmjet rreshtave: 1.5.
- Referencat sipas stilit CHICAGO (edicioni i fundit).
- Punimi duhet të përmbajë këto elemente: titullin, emrin dhe mbiemrin e autorit, institucionin përkatës, gradën shkencore, abstraktin dhe fjalët kyçe në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjithashtu, punimi duhet të strukturohet me hyrje, përfundim dhe literaturë.

Mirë se vini me kontributet tuaja shkencore!